REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 18/21
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 28.01.2021
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, si dhe Vendimin e Kuvendit të Kuvendit Nr. 68/20, datës. 23.04.2020 për inicimin e procedurës për zhvillimin e studimit të efektit të pandemisë COVID-19, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datën **28 janar 2021** merr këtë:

# V E N D I M
# PËR APROVIM TË PLANIT PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

1. Me këtë vendim aprovohet Plani për rimëkëmbje ekonomike të Komunës së Vushtrrisë si rezultat i pandemisë COVID-19.

2. Obligohet Kryetari i Komunës – Qeveria Komunale që të ndërmerr masa për implementim të këtij plani në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet publike të nivelit qendror dhe organizmat tjerë vendorë dhe ndërkombëtar.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani për rimëkëmbje ekonomike i Komunës së Vushtrrisë si rezultat i pandemisë COVID-19.

4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**

KOMUNA VUSHTRRI

# PLANI I RIMËKËMBJES EKONOMIKE
# DHE
# PLANI I AKTIVITETEVE



Imlementuar nga HOLDING GROUP

Shtator 2020

# Përmbajtja

**1. HYRJE......5**

**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE......6**

**2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË RIMËKËMBJES EKONOMIKE......9**

**3. RIMËKËMBJA EKONOMIKE......10**

3.1. ZBUTJA E NDIKIMIT TË PANDEMISË......10
*3.1.1. Rialokimi i mjeteve buxhetore për krijimin e mundësive për përgjigje emergjente në pandemi 10*
*3.1.2. Përgjigje ndaj kërkesave emergjente të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë......11*
*3.1.3. Lirimet e përkohshme tatimore......12*
*3.1.4. Rishikimi i Buxhetit të Komunës për 2020......12*
*3.1.5. Subvencionimi i bizneseve të komunës......13*
*3.1.6. Planifikimi i Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 në harmoni me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike......13*
3.2. RIMËKËMBJA EKONOMIKE E KOMUNËS SË VUSHTRRISË......15
*3.2.1. Moratorium 4-vjeçar për ndalim të shpenzimeve kapitale dhe transferin e tyre në shpenzime për rimëkëmbje ekonomike......16*
*3.2.2. Masat financiare për rimëkëmjen ekonomike......17*

**4. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK KOMUNAL......21**

4.1. PROJEKTET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK KOMUNAL......21
*4.1.1. Ngrohtorja e qytetit......22*
*4.1.2. Impiant i ujërave të zeza......23*
*4.1.3. Projekti i gazifikimit të qytetit......24*
*4.1.4. Kredi e butë e Komunës për projekte të mëdha ekonomike/infrastrukturore......25*
*4.1.5. Zona Ekonomike në Banjskë......26*
*4.1.6. Ndërtimi i parkingjeve publike në Vushtrri......28*
*4.1.7. Parku rekreativ "Taraxha"......29*
*4.1.8. Turizmi malor në Zonën e Shalës......30*
*4.1.9. Liqeni akumulues në Sllakoc......31*
*4.1.10. Shfrytëzimi i resurseve minerare......32*
*4.1.11. Zhvillimi i kapaciteteve në energji të ripërtritshme......33*
*4.1.12. Tregu për prodhues vendor/lokal......34*
*6.1.13. Identifikimi i të papunëve sipas strukturës, kualifikimit dhe përcaktimi i nevojave të tyre për punësim 34*
4.2. QASJA PROGRAMORE PËR NDËRTIMIN E STRUKTURËS INSTITUCIONALE PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË QËNDRUESHËM.. .36
*4.2.1. Master Plan Zhvillimor të Komunës së Vushtrrisë......36*
*4.2.2. Vendosja e parimeve në menaxhimin e Buxhetit të Komunës......37*
*4.2.3. Aktivizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Grupit Lokal të Veprimit "Vicianarural"......38*
*4.2.4. Krijimi i Fondit për Zhvillim Ekonomik Komunal......39*
*4.2.5. Qendra e Biznesit......40*
*4.2.6. Qendra Komunale për Zhvillim Ekonomik......40*
*4.2.7. Këshilli për Zhvillim Ekonomik Lokal......41*
*4.2.8. Shërbime të përshtatshme online......42*
*4.2.9. Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues......42*

**5. PLANI I AKTIVITETEVE** .......... **44**
5.1. ZBUTJA E NDIKIMIT TË PANDEMISË .......... 44
5.2. PLANI I AKTIVITETEVE: RIMËKËMBJA EKONOMIKE .......... 46
5.3. PLANI I AKTIVITETEVE: ZHVILLIMI QËNDRUESHËM EKONOMIK LOKAL – PROJEKTET ZHVILLIMORE .......... 48
5.4. QASJA PROGRAMORE PËR ZHVILLIM EKONOMIK KOMUNAL .......... 50

## Lista e Tabelave


| Nr. | Tabela | Faqe |
|---|---|---|
| *Tabela 1* | *Rialokimi i mjeteve buxhetore për përgjigje ndaj kërkesave emergjente* | 11 |
| *Tabela 2* | *Sigurimi i kërkesave dhe nevojave elementare të qytetarëve (barëra dhe ushqim).* | 11 |
| *Tabela 3* | *Lirimet e përkohshme tatimore* | 12 |
| *Tabela 4* | *Rishikimi i buxhetit* | 13 |
| *Tabela 5* | *Subvencionimi i bizneseve mikro dhe bizneseve të vogla.* | 13 |
| *Tabela 6* | *Ndryshimet e buxhetit sipas moratoriumit* | 16 |
| *Tabela 7* | *Masat e mbështetjes financiare* | 20 |

# 1. Hyrje

Duke u bazuar në hulumtim kriza pritet të ketë ndikime të mëdha sociale dhe ekonomike, pasi industria e shërbimeve dhe tregtia janë goditur ndjeshëm. Institucionet qendrore kanë ndërmarrë masa për të mbështetur bizneset, përfshirë propozimin e një pakoje të stimulimit fiskal për të mbështetur rimëkëmbjen e sektorëve privat dhe publik nga kriza. Ndërsa kriza shpërndahet dhe varësisht nga kohëzgjatja e saj, implikimet sociale dhe ekonomike do të jenë domethënëse. Ndikimi do të varet nga rritja e papunësisë, varfëria e thelluar, humbja e të ardhurave, pasiguria e vendeve të punës, pabarazitë specifike të industrive, deri te ngecja në arsim dhe ngecja në përpjekjet për të zvogëluar hendekun gjinor në Kosovë. Sfidat do të jenë veçanërisht të rënda për familjet në nevojë, të cilat jetojnë me burime të ardhurash të përditshme. Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 është i rëndësishëm për të kuptuar shtrirjen dhe dallimin e ndikimeve sistemike të krizës, ndikimin e tij në grupet e varfra e të cenueshme si dhe në ekonominë lokale të Komunës së Vushtrrisë.

Nga hulumtimi i sektorit të biznesit shihet qartë që bizneset aktive në Komunën e Vushtrrisë janë zvogëluar me 15% dhe kjo e dhënë është indikatori kryesor që biznesi privat ka rënie të konsiderueshme e cila është reflektuar edhe në të punësuar, edhe pse nga të dhënat e hulumtimit shihet që punësimi ka shënuar rritje, por që nga Administrata Tatimore e Kosovës konsiderohet që numri i rritur i të punësuarve është si pasojë e Masës 13 të Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike, e cila ka ndikuar në deklarimin e punëtorve të rinjë.

Me kërkesë të Komunës së Vushtrrisë, grupi punës i "M Holding", krahas hulumtimit i ka nxjerrë edhe disa rekomandime emergjente si aktivitete të rimëkëmbjes ekonomike për vitin 2020, në mënyrë që Komuna e Vushtrrisë të jetë sadopak në hap edhe për këtë vit. Bazuar në këto rekomandime Komuna e Vushtrrisë ka ndërmarrë një sërë veprimesh të cilat kanë ndikuar që efekti i pandemisë në sektorin e bujqësisë të zbutet. Një ndikim i zbutjes së efektit të pandemisë nga masat/aktivitetet e rekomanduara për Komunën e Vushtrrisë dhe nga Plani i Rimëkëmbjes Ekonomike është arritur edhe në rritjen e punësimit, ku si rezultat është shtuar numri i të punësuarve për 382 punonjës.

Në këtë dokument do të rekomandohen programet, projektet dhe aktivitetet të cilat Komuna e Vushtrrisë pajtohet që do t'i ndërmarrë në periudha kohore në mëyrë që zbutja e ndikimit të pandemisë dhe rimëkëbja ekonomike të mbërrijë rezultatet e pritura në nivel sa më të lartë. Bazuar në aktivitete do të hartohet edhe plani i aktiviteteve i cili do të përmbajë të dhënat bazike për aktivtetin, përgjegjësitë, veprimet që do të ndërmerren dhe kohën më e mirë të fillimit dhe përfundimit të aktivitetit.

Me qëllim të implementimit sa më të lehtë, aktivitetet dhe projektet do të ndahen në periudha kohore, duke u harmonizuar sa më shumë me Planin e Rimëkëmbjes Ekonomike të Qeverisë së Kosovës dhe karakterit anual të Buxhetit të Republikës së Kosovës, respektivisht Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë.

# Përmbledhje Ekzekutive

Plani i Rimëkëmbjes Ekonomike të Komunës së Vushtrrisë shpreh qëllimin dhe objektivat e organeve qeverisëse të komunës për rimëkëmbjen ekonomike në dhe pas pandemisë, duke përfshirë edhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës për periudhën pesë vjeçare, i cili është hartuar duke u bazuar në rezultatet e gjetura të hulumtimit dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Vushtrrisë.
Ky plan paraqet objektiva të cilat janë sfiduese për qeverisjen komunale dhe si të tilla kanë të parapara veprime dhe aktivitete të cilat kërkojnë edhe aprovimin e organeve të Qeverisë së Kosovës. Megjithatë, duke qenë në periudhë të pandemisë, këto aprovime nuk duhet të jenë shqetësim për Qeverinë e Kosovës, por do të jetë plan që jep rezultate konkrete dhe që krijon një precedent për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik komunal, të bazuar në vetëqeverisje lokale dhe përgjegjësitë komunale.

Plani është i ndarë në dy objektiva:

**Objektivi i parë** është zbutja e ndikimit të pandemisë dhe rimëkëmbja ekonomike e determinuar nga aktivitete të shtrira në periudhën kohore 2020 dhe 2021, por që masat e ndërmarra në vitin 2021 do të përsëriten për pesë vitet e ardhshme.
Veprimet kryesore në 2020 kanë të bëjnë me masat emergjente të ndërmarra nga komuna si: ndryshimet buxhetore, lehtësirat tatimore, grantet e dhëna për biznese lokale dhe subvencionimi i pagave të punëtorëve. Këto janë veprime për të zbutur ndikimin e efekteve negative të pandemisë.
Në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë janë propozuar masat mbështetëse financiare për biznese dhe qytetarë të cilat gjithashtu do të përsëriten për pesë vite të ardhshme.
Këto masa do të fillojnë me vendosjen e Moratoriumit të propozuar nga Kryetari i Komunës dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal dhe Ministria e Financave. Komuna e Vushtrrisë ka ndarë për tre vitete e ardhshme (2021-2023) 600.000 euro subvencione, por të cilat nuk janë të mjaftueshme për rimëkëmbje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Prandaj moratoriumi do të bëjë ndalimin e investimeve në projekte kapitale, kryesisht në asfalt, dhe t'i transferojë në kategorinë e shpenzimeve "Subvencioni dhe Transfere", në vlerë prej 3.65 milionë euro, të destinuara për masat e mbështetjes financiare dhe projektet për zhvillim të qëndrueshëm komunal. Masat që do të financohen nga fondi i motatoriumit janë:
– Injektimi i 30 milionë eurove në ekonominë lokale në 4 vitet e ardhshme përmes projektit të mbulimit të normës së interesit në kredi;
– 25% zbritje të tatimit në pronë për një periudhë 4-vjeçare për qytetarët dhe bizneset brenda masës së lehtësimit të barrës tatimore të qytetarëve dhe bizneseve;

– Masa aktive të punësimit, ku për pesë vitet e ardhshme, 2000 të rinjë do të trajnohen me pagesë për tregun e punës në 5 vitet e ardhshme duke rritur punësimin;
– Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, rrjedhimisht duke nxitur zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore;
– Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike komunale;
– Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera jo-formale;
– Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi;
– Mbështetje për bashkatdhetarët përmes aktiviteteve të ndryshme promovuese;
– Racionalizimi për së paku 30% të shpenzimet nga kategoria "Mallra dhe Shërbime" për destinim për mbështetje indirekte financiare për bizneset në nevojë.

**Objektivi i dytë** është i determinuar nga projekte dhe programe të pa afatizuar që e mundësojnë funksionimin për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe projekte, implementimi i të cilave e kalon komunën në nivelin e një komune me qëndrueshmeri ekonomike dhe të zhvilluar. Aktivitetet programore janë të përqëndruara në qeverisje publike-private dhe funksionale si: Qendra e Biznesit, Këshilli për Zhvillim Ekonomik Komunal, Aktivizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Grupit Lokal të Veprimit "Vicianarural", ofrimi i shërbimeve online për qytetar e biznese dhe krijimi i Fondit për Zhvillim Ekonomik Komunal.
Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik si objektiv kryesor i planit, përveç aktiviteteve programore është e fokusuar edhe në projekte të cilat i krijojnë qëndrueshmëri ekonomike dhe punësim Komunës së Vushtrrisë. Këto projekte janë:
- Master Plan Zhvillimor për 5 vitet e ardhshme
- Ngrohtorja e Qytetit (gaz, biomasë, solare), që ndikon në efiçiencën e energjisë rreth 40% për qyetarët dhe bizneset;
- Impianti ujërave të zeza që përmirëson Lumin Silnica, ruan ambientin, shëndetin, ulë koston e trajtimeve mjekesore si rezultat i ujit të ndotur, nxit zhvillimin e turizimit prrgjatr Silnicës;
- Gazifikimi i qytetit dhe lokaliteteve të Vushtrrisë dhe bizneseve;
- Kredi e butë e për projekte të mëdha ekonomike/infrastrukturore;
- Zonë Ekonomike në Banjskë, në sipërfaqe prej 220ha për krijim të vendeve të punës;
- Ndërtimi i parkingjeve publike në komunë;
- Zhvilli i turizmit që përfshin Parkun Rekreacional "Taraxha", turizmi malor në zonën e Shalës, subvencionimin e krijimit të hapësirave akomoduese dhe hoteliere;
- Liqeni akumulues në Sllakoc;
- Plan për shfrytëzimin e resurseve minerare në Komunën e Vushtrrisë;
- Zhvillimi i kapaciteteve në energji të ripërtritshme;

- Zone e lirë taksuese 10-vjeçare në Banjskë dhe për secilën fermë në Vushtrri;
- Tregu për përkrahjen e prodhuesve vendorë;
- Përkrahje e pikave përpunuese të ushqimit gjysëm të gatshëm;
- Regjistrimi i punëkërkuesve sipas strukturës, kualifikimeve dhe nevoja të tyre për punësim;
- Analiza e strukturës së përfituesve të asistencës sociale;

Në mënyrë që qëllimi i këtij hulumtimi të jetësohet, ne do të bashkëpunojmë ngushtë me autoritetet lokale të Komunës së Vushtrrisë për t'i ndihmuar përmes rekomandimeve në zhvillimin e kapaciteteve lokale për krijimin e ambientit më të favorshëm për biznes, prandaj do të nxjerrim rekomandime të qëndruseshme për zhvillimin e aktivitete që e ndihmojnë promovimin e zhvillimit socio-ekonomik të Komunës së Vushtrrisë.

# 2. Qëllimi dhe Objektivat e Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike

Gjetjet e këtij raporti do të identifikojnë nevojat dhe e bëjnë të mundshme mbështetjen e synuar nga autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe partnerët e zhvillimit, për të zbutur ndikimin e krizës dhe për të rritur adaptueshmërinë e qytetarëve. Vlerësimi është dizajnuar për të mundësuar hartimin dhe vendosjen e masave reaguese për të zvogëluar ndikimin negativ për familjet dhe bizneset.

Komuna e ka shprehur qartë qëllimin e saj kur e ka planifikuar hulumtimin dhe planin e rimëkëmbjes ekonomike. Ky plan konsiderohet si pengesë e ndikimit të pandemisë nën ekonominë lokale. Megjithatë komuna e ka objektivizuar edhe mundësinë e rritjes ekonomike nëse ndikimi i pandemisë mund të pengohet.

Për të arritur me efikasitet të lartë qëllimin e këtij plani dhe që implementimi të japë rezultate produktive dhe të matshme, qëllimi do të objektivizohet duke u bazuar në periudha kohore si:

1. ***Rimëkëmbja ekonomike në periudhën (2020 dhe Masat 2021-2025); dhe***
2. ***Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik lokal dhe ndërtimit të strukturës funksionale për zhvillim ekonomik lokal në përiudhën (pesë vjeçare);***

Aktivitetet e rekomnaduara në këtë dokument janë dizanuar në mënyrë që implementimi i tyre të arrijë realizimin e qëllimit dhe rezultateve të pritura të cilat përmblidhen në:

- Zbutja e efektit të pandemisë në ekonominë lokale dhe gjendjen sociale të pupullatës së Komunës së Vushtrrisë;
- Të rikuperohet dëmi i shkaktuar në ekonominë lokale nga pandemia globale me efekt të gjithmbarëshëm;
- Rritja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të qeverisë lokale me sektorin privat dhe shoqërinë civile që rimëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik të arrij parametra të kënaqshëm;
- Ndërmarrja e suksesshme e aktiviteteve të rimëkëmbjes si veprime të harmonizuara me sektorin privat;
- Ndërtimi i strukturës organizative të komunës dhe institucioneve asociuese private për zhvillim të hovshëm ekonomik.

# 3. Riměkëmbja ekonomike

Masat e rimëkëmbjes ekonomike janë veprime konkrete të cilat komuna duhet t'i ndërmarrë në vitin 2020 dhe 2021. Këto masa janë kryesisht veprime të cilat kanë të bëjnë me:

1. zbutjen e ndikimit të pandemisë në vitin 2020; dhe
2. masat e rimëkëmbjes ekonomike 2020;

## 3.1. Zbutja e ndikimit të Pandemisë

Aktivitetet e objektivit të parë determinohen me masa dhe veprime konkrete emergjente. Këto aktivitete janë rezultat i rekomandimeve të cilat kanë dalë nga grupet punuese dhe takimet punuese me zyrtarët përgjegjës komunalë. Pasi që si të gjitha vendet, ashtu edhe Vushtrria është zënë në befasi nga pandemia globale si rezultat i COVID-19, është parë e domosdoshme që të ndërmerren veprime emergjente që të reagohet sa më shpejt në këtë periudhë. Andaj janë organizuar takime punuese që të vlerësohen veprimet të cilat mund të jenë përgjegjëse në situatë emergjente.

Objektivi i parë për zbutjen e ndikimit të pandemisë përcaktohet nga aktivitete të cilat janë të shtrira në periudhën kohore të këtij viti, prandaj disa nga aktivitetet e këtij objektivi vetëm janë implementuar me kohë në periudhën kohore 2020. Duke vlerësuar mundësitë buxhetore të Komunës së Vushtrrisë është rekomanduar që të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

### 3.1.1. Rialokimi i mjeteve buxhetore për krijimin e mundësive për përgjigje emergjente në pandemi

Periudha e parë e pandemisë është përshkruar nga ndikimi dhe kërkesa nga më të ndryshmet si pasojë e mungesës së një plani emergjent dhe panikut të shkaktuar nga pandemia globale. Prandaj është rekomanduar që të krijohen mundësi buxhetore për t'iu përgjigjur shpejt nevojave të qytetarëve dhe të bizneseve. Bazuar në buxhetin e këtij viti është vlersuar që mjetet buxhetore të rialokohen sipas transfereve në vijim.

*Tabela 1. Rialokimi i mjeteve buxhetore për përgjigje ndaj kërkesave emergjente*

| Rekomandimi | Përshkrimi i aktiviteteve | Vlera € |
|---|---|---|
| Rialokimin-transferimin e mjeteve financiare të komunës për përgjigje ndaj kërkesave emergjente | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 47826 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 30,000.00 Euro. | 30,000 |
| | Nga fondi (21), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 47826 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 20,000.00 Euro. | 20,000 |
| | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 90226 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 30,000.00 Euro. | 30,000 |
| | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 47838 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 10,000.00 Euro. | 10,000 |
| | Nga fondi (21), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 47838 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 40,000.00 Euro. | 40,000 |
| | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare nga Progami Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66425 në programin Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 49579 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 20,000.00 Euro. | 20,000 |
| | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare nga Progami Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66425 në programin Infrastruktura Publike me kod 18184 nga kategoria e Investimeve Kapitale me kod të projektit 41424 në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë 50,000.00 Euro. | 50,000 |
| | ***Transferohen në kategorinë Mallra dhe Shërbime, Total:*** | ***200,000*** |

### 3.1.2. Përgjigje ndaj kërkesave emergjente të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë

Duke qenë që faza e parë është përshkruar nga paniku dhe kërkesat emergjente është rekomanduar që fillimisht komuna të përgjigjet ndaj këtyre kërkesave në mënyrë që popullata të ndihet më e sigurt dhe mos të veprojë si pasojë e panikut. Për këtë qëllim është vlerësuar shumë e domosdoshme që të sigurohen qytetarët që komuna është e gatshme ndaj kërkesave të tyre për barna dhe ushqim nëse do të paraqitet nevoja.

*Tabela 2. Sigurimi i kërkesave dhe nevojave elementare të qytetarëve (barëra dhe ushqim).*

| Rekomandimi | Përshkrimi i aktiviteteve | Vlera |
|---|---|---|
| Finacimin e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 ***(nga kategoria Mallra dhe Shërbime)*** | Blerjen e mjeteve mbrojtëse, barnave dhe pajisjeve të nevojshme shëndetësore për punëtorët shëndetësorë, administratës së komunës, mjeteve dezinfektuese dhe çdo gjë tjetër që do të jetë e nevojshme për parandalim dhe mbrojtje të kësaj sëmundje. | € 200,000 |
| | Blerjen e pakove sociale (pako ushqimore dhe higjienike) për familjet në gjendje të rëndë sociale, në vlerë prej 50.00 Euro. | |

### 3.1.3. Lirimet e përkohshme tatimore

Pavarësisht që taksat komunale që janë determinuese të të hyrave vetanake të komunës, është vlerësuar që për periudha afatshkurtëra të konsiderohet ulja apo lirimi i plotë i qytetarëve nga taksa komunale. Nga hulumtimi janë nxjerrë kategoritë më të prekura dhe të cilat kanë kërkuar që përkohësisht të lirohen nga disa taksa komunale. Meqenëse tatimi në pronë është e hyra kryesore vetanake, është lënë që të veprohet më vonë, sipas nevojës dhe sipas rekomandimeve të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Finacave dhe Transfereve.

***Tabela 3. Lirimet e përkohshme tatimore***

<table>
<tr><th colspan="2">Rekomandimi</th><th>Vlera</th></tr>
<tr><td rowspan="8">Lehtësirat tatimore</td><td rowspan="2">Lirim nga pagesa e tarifës për çerdhen e fëmijëve</td><td>1. Me këtë vendim, lirohen nga pagesa e tarifës komunale për prindërit e Komunës së Vushtrrisë për shërbimet e edukimit për fëmijët e tyre të cilat ofrohen në Çerdhen e Fëmijëve "Foleja" në Vushtrri.</td></tr>
<tr><td>2. Lirimi nga pagesa bëhet prej datës 01.03.2020 deri në fillim të vitit të ri shkollor 2020 - 2021.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shtyrjen e afatit të pagesës së disa taksave komunale</td><td>1. Me këtë vendim lejohet shtyrja e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.</td></tr>
<tr><td>2. Afati për shtyrjen e pagesës së këstit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike</td><td>1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë.</td></tr>
<tr><td>2. Lirimi nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë do të zgjasë nga data 1 mars deri më 31 dhjetor 2020.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina</td><td>1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale të Komunës së Vushtrrisë.</td></tr>
<tr><td>2. Lirimi nga pagesa bëhet prej datës 01.03.2020 deri më 31.12.2020.</td></tr>
</table>

### 3.1.4. Rishikimi i Buxhetit të Komunës për 2020

Buxhetet komunale miratohen në Kuvendin Komunal më së largu me 31 shtator të vitit paraprak. Meqenëse në kohën kur është miratuar buxheti i vitit 2020, nuk ka pasë asnjë indikator të hershëm për pandeminë, ky buxhet është dizajnuar që të plotësojë kërkesat në gjendje të rregullt. Me qëllim që buxheti t'i plotësojë kërkesat emergjente për përgjigje ndaj qytetarëve dhe bizneseve në kohë të pandemisë, atëherë është vlerësuar e domosdoshme që brenda mundësive të ridizajohet buxheti i vitit aktual që sadopak t'i plotësojë kërkesat në kohë pandemie.

*Tabela 4. Rishikimi i buxhetit*

| Rekomandimi | Përshkrimi i aktiviteteve | Vlera |
|---|---|---|
| Rishikimi i Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020 | 1. Nga fondi (10), nga kategoria Paga dhe Meditje bëhet transferimi i mjeteve financiare në kategorinë Mallra dhe Shërbime në kuadër të programit Infrastruktura Publike me kod 18184 , Kodi (00099) COVID-19 | € 200,000.00 |
| | 2. Mjetet financiare nga fondi 10, kategoria Investime Kapitale, programi 47024 - Bujqësia, projekti me kod 49549 "Projektet në bujqësi me bashkëfinancim" shuma e mjeteve financiare (100,000.00 Euro) barten në fondin e njejtë në kategorinë Mallra dhe Shërbime, në programin Infrastruktura Publike, me kod 18184 COVID-19 (00099) | € 100,000.00 |

### 3.1.5. Subvencionimi i bizneseve të komunës

Pavarësisht subvencionimit të bizneseve nga Qeveria e Kosovës është vlerësuar që të krijohen mundësi buxhetore nga rishikimi i Buxhetit 2020 dhe të krijohet një fond për subvencionim e bizneseve të Komunës së Vushtrrisë. Ky subvencionim duhet të bazohet në metodologjinë e Planit për Rimëkëmbjen Ekonomike të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht në masën 10. Nga të dhënat e gjeneruara nga hulumtimi dhe ato të huazuara nga Administrata Tatimore e Kosovës del në pah që masa 13 për subvencionim e punëtorëve të rinj ka bërë që numri i të punësuarve të rritet edhe përkundër që numri i bizneseve aktive (bizneset që deklarojnë në ATK) ka shënuar rënie. Kategorizimi i subvencionimit për biznese të bëhet në biznese miko dhe biznese të vogla. Bizneset e vogla të përfitojnë nga 500-900 euro, përderisa mikro bizneset të përfitojnë nga 300-500 euro.

***Tabela 5. Subvencionimi i bizneseve mikro dhe bizneseve të vogla.***

| Rekomandimi | Përshkrimi i aktiviteteve | Vlera |
|---|---|---|
| Thirrje për mbështetje financiare të bizneseve | Mbështetja planifikohet për operatorë ekonomikë (zejtar dhe shërbyese)<br>Bizneset Mikro përfitojnë nga 300 - 500 Euro<br>Bizneset e Vogla përfitojnë nga 500 - 900 Euro | € 250,000.00 |

### 3.1.6. Planifikimi i Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 në harmoni me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike.

Ekspertët e kompanisë "M-Holding" kanë dorëzuar disa rekomandime profesionale dhe të qëndrushme lidhur me buxhetin e planifikuar 2021. Rekomandimet për buxhetin e vitit 2021 kryesisht janë të harmonizuara me Planin e Rimëkëmbjes Ekonomike të Komunës së Vushtrrisë. Të gjitha rekomandimet janë konsideruar të vlefshme dhe e kanë ndihmuar komunën për planifikim dhe orientim të buxhetit duke i kategorizuar prioritetet dhe janë inkorporuar në buxhetin e planifikuar për vitin 2021.

Për vitin fiskal 2021, Komuna e Vushtrrisë e ka buxhetin në vlerë prej 18,878,128.00 milion (€). Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë rreth 90% të totalit të tij, ndërkaq rreth 10% e pjesës së mbetur, komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që përbën rreth 57 % të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 17 %, teksa pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 20% e shumës totale.







Me rekomandimet e ekspertëve dhe duke u mbështetur në vlerësimet nga hulumtimi, në vitin 2021 është rritur për 51% buxheti në kategorinë "Subvencione dhe Transfere" në vlerë prej 600,000.00 €, e krahasuar me vitin e kaluar që ishte në vlerë prej 292,914.00 €. Ndërsa kategoria "Shpenzimet Kapitale" është ulur për 20% në vlerë prej 3,765,124.00 € në vitin 2021, krahasur me vitin 2020 sa ishte 4,726,391.00 €.

## 3.2. Rimëkëmbja Ekonomike e Komunës së Vushtrrisë

Qeverisja komunale dhe ekspertët kanë zhvilluar disa takime që trajtojmë disa çështje që lidhen me rimëkëmbjen ekonomike. Këto rekomandime janë rezultat i vazhdimësisë së konsultimeve të rregullta që qeverisja komunale dhe ekspertët kanë pasur me partnerët e përfshirë në këshillim e rimëkëmbjes ekonomike. Tani në periudha afatshkurtër qeverisja komunale do të punojë bashkë me partnerët që të implementojmë pakon për Rimëkëmbje Ekonomike. Komuna e Vushtrrisë nuk arriti të ndryshojë buxhetin edhe në mënyrën e planifikimit duke u fokusuar më shumë te kategoria "Subvencione dhe Transfere" dhe të avancojë shpenzimet në kategorinë e "Mallra dhe Shërbime" në favor të mbështetjes finaciare të bizneseve dhe krijimit të vendeve të reja të punës të cilat është llogaritur ta kthejnë ekonominë në gjendjen e cila ka qenë para pandemisë.

Tani që jemi futur në proces të zbutjes dhe gradualisht eliminimit të masave kufizuese të vendosura nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë (bazuar në rekomandimet e IKSHPK), Komuna e Vushtrrisë e sheh të domosdoshme fillimin e kujdesshëm edhe me fazën e dytë të adresimit të vështirësive të derivuara nga Pandemia COVID-19. Kjo fazë e rimëkëmbjes ekonomike si për nga vëllimi i intervenimit, ashtu edhe për nga struktura e masave të parapara, pritet të ketë ndikim dukshëm më intensiv si në stabilizimin e aktivitetit ekonomik në komunë, ashtu edhe në korrigjimin e deformimeve ekzistuese në strukturën e PBB-së. Natyrisht se fokusi primar i pakos së rimëkëmbjes ekonomike do të jetë mbështetja me kredi për secilin biznes që përgjatë periudhës së pandemisë ka hasur në rënie të aktivitetit ekonomik. Por, megjithatë Plani i Rimëkëmbjes synon që përtej synimit primar të dizajnohen masa dhe projekte që mundësojnë rritje të kapaciteteve prodhuese, rritje të eksporteve e përmirësim të bilancit tregtar, rritje të punësimit bashkë me rritjen e formalizimit dhe përmirësimin e strukturës së punësimit.

Duke pasë parasysh që Qeveria e Kosovës ka aprovuar Planin e Rimëkëmbjes Ekonomike, shumë nga aktivitetet e rimëkëmbjes ekonomike të Komunës së Vushtrrisë janë harmonizuar me masa nga ky program. Por, poashtu është e domosdoshme që komuna të ketë një MasterPlan të projekteve investive 5-vjeçare që përmirsojnë jetën e qytetarit, rrisin cilësinë e jetës dhe zbusin papunësinë në Komunë. Në këtë objektiv GLV "Vicianum" dhe Komuna e Vushtrrisë do të organizohen që të maksimizojnë përfitimin e qytetarëve dhe të bizneseve të Vushtrrisë nga masat e Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike të Qeverisë së Kosovës.

### 3.2.1. Moratorium 4-vjeçar për ndalim të shpenzimeve kapitale dhe transferin e tyre në shpenzime për rimëkëmbje ekonomike

Moratorium 4-vjeçar për ndalim të projekteve të asfaltimit nga buxheti komunal. Me qëllim të sigurimit të mjeteve buxhetore për projektet në kuadër të programit të rimëkëmbjes ekonomike të Vushtrrisë, komuna duhet të shpallë moratorium 4-vjeçar dhe të ndalojë përdorimin e buxhetit komunal për asfaltim të rrugëve lokale e cila është vlersuar të jetë 1 milion euro. Ky buxhet do të orientohet në programe dhe projekte tjera si në vijim. Megjithatë, komuna duhet të ndajë buxhet për mirëmbajtje të rrugëve aktuale dhe duhet të synojë që nga grantet qeveritare të adresojë kërkesat e qytetarëve për asfaltim të rrugëve lokale.

Moratoriumi bën që shpenzimet e kategorisë "Subvencione dhe Transfere" të rriten për 1.6 milionë euro në vit, ndërsa nga të gjitha burimet subvencionet arrijnë vlerën prej 6.65.

Konsiderohet shumë e domosdoshme që GLV të aktivizohet dhe të aftësohet sa më shpejtë në mënyrë që të shërbejë si task forcë e Komunës së Vushtrrisë për përfitimin e projekteve kapitale nga Qeveria e Kosovës, në mënyrë që të plotësohet kërkesa e qytetarëve për investime kapitale.

Masa 10 e cila 1/3 (1.1 milion) e kategorisë "mallra dhe shërbime" e destinon për mbështetje financiare të bizneseve, nuk është e domosdoshme të të transferohet në kategorimë "mallra dhë shërbime".

***Tabela 6: Ndryshimet e buxhetit sipas moratoriumit***

| **Shpenzimet** | **Buxheti sipas planifikimit 2021** | **Buxheti sipas moratoriumit 2021** |
|---:|---:|---:|
| Paga dhe Meditje | € 10,691,340 | € 10,691,340 |
| Mallra dhe sherbime | € 3,218,600 | € 3,218,600 |
| Shpenzimet komunale | € 309,035 | € 309,035 |
| Subenvcionet dhe transferet | € 600,000 | € 1,600,000 |
| Shpenzimet kapitale | € 3,765,154 | € 2,765,154 |
| Rezerva | € 294,000 | € 294,000 |
| **Total:** | **€ 18,878,129** | **€ 18,878,129** |




### 3.2.2. Masat financiare për rimëkëmjen ekonomike

Qeveria e Republikës së Kosovës, ka miratuar Planin i zbatimit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Ky plan është i bazuar në masat të cilat Qeveria e Kosovës i ka të mbështetura në Planin e Rimëkëmbjes të Programit Qeverisës. Komuna e Vushtrrisë do të bashkërendojë disa nga aktivitetet me masat e planit të rimëkëmbjes.

**MASA 1** – Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Komunës së Vushtrrisë janë parashikuar 3.65 milionë euro shpenzime kapitale, kryesisht për asfaltim të rrugëve lokale. Këto mjete duhet të ridestionhen, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë në kategori të subvencioneve me qëllim të realizimit të masave tjera të rimëkëmbjes ekonomike si Masa 2 dhe Masa 4.

**MASA 2** – Injektimi i 30 milionë eurove në ekonominë lokale në 4 vitet e ardhshme përmes projektit të mbulimit të normës së interesit në kredi. Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit, në vlerë prej 30 milionë euro të ndarë në 4 vitet e ardhshme, nga kategoria e Shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere". Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të ndihmojë mikrobizneset, Start-Up, agrobizneset dhe bizneset e tjera për qasje në kredi, duke marrë përsipër garantimin për biznese të cilat nuk mund të sigurojnë kolateral apo hipotekë.
Nga kjo masë do të përfitojnë bizneset fillestare, agrobizneset dhe biznesi në përgjithësi duke siguruar qasje në burime financiare pa vështirësi dhe me një greis-periudhë 1-vjeçare. Komuna duhet të planifikojë të ndajë 500,000 euro në vit nga kategoria e "Subvencioneve dhe Transfereve" për këtë qëllim dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me bankat komerciale për të siguruar qasje në burime financiare në vlerë prej 5-6 milionë euro në vit.

**MASA 3** – 25% zbritje të tatimit në pronë për një periudhë 4-vjeçare për qytetarët dhe bizneset brenda masës së lehtësimit të barrës tatimore të qytetarëve dhe bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër. Aktualisht Komuna e Vushtrrisë arkëton 1.91 milionë euro nga të hyrat vetanake të tatimit në pronë. Përmes kësaj mase çdo vit do të krijohen lehtësira prej 25% për qytetarët dhe bizneset duke ju ndihmuar atyre që të përdorin kapitalin e tyre për zhvillim.

Në kuadër të kësaj mase, Komuna do të krijojë zonë të lirë të tatimit në pronë në projektin e zonës ekonomike të planifikuar në Kodrën e Bajskës.
Për realizim të suksesshëm të kësaj mase, komuna duhet të sigurohet që të ketë ZERO tolerancë për mos pagesa duke siguruar edhe mjete për mbledhje të detyrueshme të obligimeve tatimore.
Realizimi i kësaj poashtu kërkon bashkëpunim të Komunës së Vushtrrisë me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Tatimit në Pronë.

- Shtyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve;
- Mbulimi i pesë përqindëshit (5%) të kontributit pensional që biznesi paguan për punëtorë (ato që nuk i mbulon Qeveria e Kosovës dhe vlerësohet që kanë vështirësi);
- Pushimet në pagesa të taksave për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë;
- Lirimet për parapagimet e obligimeve nga ana e bizneseve;
- Ofrimi i mundësisë për ri-programim të borxheve tatimore të mëparshme, duke përfshirë edhe zbritjet për pagesën e menjëhershme të borxhit, dhe
- Subvencionimi i pesëdhjetë përqind (50%) të shpenzimeve të qirasë për biznese (ato që nuk i mbulon Qeveria e Kosovës dhe vlerësohet që kanë vështirësi);

**MASA 4** – Masa aktive të punësimit, ku 2000 të rinjë do të trajnohen me pagesë për tregun e punës në 5 vitet e ardhshme duke rrita e punësimin.
Vlera e projektit parashikohet të jetë 4,080,000.00 euro (ose afërsisht 800,000 euro në vit). Burimi i financimit të projektit është buxheti komunal, kategoria Subvencionet.

- Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë;
- Të vepunësuarit e rinjë në biznese Start-Up;
- Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia dhe që nuk janë mbështetur nga masat e Qeveriusë së Kosovës;
- Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemie, siç është puna nga shtëpia, puna online, transformimi digjital, etj;
- Përkrahja e bizneseve prodhuese dhe shërbyese me pajisje dhe makineri;.

**MASA 5** – Rritja e prodhimit vendor bujqësor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore, për të tejkaluar sfidat nga mungesa e shitjeve shkaktuar nga pandemia dhe për të rritur sigurinë e ushqimit deri në vlerëm prej treqind mijë euro (300.000 euro);

- Rritja e subvenconimit për agrobiznese, bujq, blegtorë;
- Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësie;

- Përkrahja/ndërtimi i pikave përpunuese të ushqimit (përmes masave aktive të punësimit dhe ofrimit të pronave komunale në shfrytëzim), dhe
- Ofrimi i pronave komunale si "Free Tax Zone" për bizneset e reja në fushën e prodhimeve bujqësore.

**MASA 6** – Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike komunale, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë uljen e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale, në vlerë prej treqind mijë euro (300.000 euro).

**MASA 7** – Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo formale, stimulimit të aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe ri-vitalizimit të tyre, në vlerë prej tetëdhjetë e pesë mijë euro (85,000.00 € në vit);

**MASA 8** – Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi, në vlerë prej njëqindëmijë euro (100,000.00 € në vit);

**MASA 9** – Mbështetje financiare për bashkatdhetarët përmes aktiviteteve të ndryshme promovuese dhe përmirësimit të shërbimeve në vlerë prej pesëdhjetë mijë euro (50,000.00 €);

**MASA 10** - I rekomandohet Komunës së Vushtrrisë që të racionalizojë së paku për 30% shpenzimet nga kategoria "Mallra dhe Shërbime" dhe t'i destinojë për mbështetje indirekte financiare për bizneset në nevojë.

***Tabela 7. Masat e mbështetjes financiare***[1]

| Masa | Vlera financiare | Përfituesit | Rezultatet e pritura | Kohëzgjatja e masës |
|---|---|---|---|---|
| Masa 1[2] | 1.000,000.00 € | Të gjitha bizneset; vende të reja pune | Kompenzimi i humbjeve në biznese private | 4 vite, ndryshohet |

[1] Vlera shtesë e masave të mbështetjes financiare merret nga burimet qeveritare pasi që Ligji i Rimekëmjes parasheh grante shtesë për komuna.
[2] Masa 1 është vlera e investimeve kapitale të cilat duhet të transferohen në kategorime e subvencioneve

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Masa 2[3] | 500,000.00 € | Bizneset private | Kompenzimi i humbjeve dhe përmirsimi i likuiditetit të bizneseve | 4 vite |
| Masa 3 | 480,000.00 € | Qyetarët dhe bizneset | Rritja e arkëtimit si rezultat i kushtëzimit | 4 vite |
| Masa 4 | 800,000.00 € | Start-up; të papunët | 2000 vende të reja pune për 5 vite | 5 vite, ndryshohet |
| Masa 5 | 300,000.00 € | Fermerët | Krijimi i vendeve të punës nga vetpunësimi | 4 vite |
| Masa 6 | 300,000.00 € | Bizneset ekzistuese | kompenzimi i humbjeve | 4 vite |
| Masa 7 | 85,000.00 € | OJQ, rinia, sportistët | Riaktivizimi i jetës aktive | 4 vite |
| Masa 8 | 100,000.00 € | Gratë ndërmarrëse | Gjinia femërore e vetpunësuar dhe ndërmarrëse | 5 vite |
| Masa 9 | 50,000.00 € | Diaspora | Kthimi i diasporës në Kosovë | 5 vite |
| Masa 10[4] | 1,072,867.00 € | Bizneset, qytetarët | Blerje për biznese për racionalizim të operimit | 5 vite |

# 4. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik komunal

Fokus primar i pakos së rimëkëmbjes ekonomike do të jetë mbështetja finaciare përgjatë periudhës së pandemisë e cila ka hasur në rënie të aktivitetit ekonomik e planifikua për periudhën pesë vjeçare. Por, megjithatë pakoja synon që përtej synimit primar të dizajnohen masa që mundësojnë rritje të kapaciteteve prodhuese, rritje të eksporteve e përmirësim të bilancit tregtar, rritje të punësimit dhe

[3] Masa 2, i ndikon të hyrat vetanake si kategori e të hyrave dhe si e tillë nuk e ndikon ndryshimin e shpenzimeve kapitale nga moratoriumi

[4] Masa e 10 është vlera e kategorisë së shpenzimmeve “mallra dhe shërbime” të cilat duhet të desinohen për ndihmë direkte për biznese, si ngritja e kapaciteteve njerzore, programe të avancuara të punës, softvere online, trajnime, etj.

formalizimit, përmirësim të strukturës së punësimit dhe të ngjashme. Më konkretisht, pakoja e rimëkëmbjes ekonomike është dukshëm më ambicioze në listimin e objektivave që synon të përmbush përgjatë implementimit të saj. Masat e propozuara në pakon e rimëkëmbjes në shumë raste mund të kontribuojnë në arritjen e disa objektivave njëherësh.

Objetivi për zhvillim të qëndrueshëm komunal është i përbërë nga dy qasje, si:

1. Projektet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.
2. Qasja programore për ndërtimin e strukturës institucionale për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

## 4.1. Projektet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik komunal

Në seancat punuese me zyrtarë komunal (politik dhe publik) dhe nga të dhënat e hulumtimit, është parë e domosdoshme që komuna të fokusohet në projekte të mëdha investive të cilat ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
Këto projekte janë të rëndësisë vitale pasi që përveç që sigurojnë ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, janë projekte që gjenerojnë vende të punës dhe e bëjnë Komunën e Vushtrisë atraktive dhe të përshtatshme për investitor privatë të huaj dhe të brendshëm. Bizneset e Vushtrrisë do të jenë përfituese në fazën e implementimit duke u kyçur në implmentim si bartës kryesor lokal dhe do t'i krijohet mundësia për investime të reja në këto projekte.
Projektet zhvillimore ia japin Vushtrrisë trajtimin e një komune ekonomikisht stabile dhe të suksesshme, qendër e bizneseve të shumta nacionale dhe ndërkombëtare, qendër e rëndësishme logjistike. Vushtrria si qytet inkubator, i cili ofron infrastrukturën dhe financat për të mbështetur këto biznese, qofshin ato të dala apo të ofruara nga jashtë komunës, apo nga ndërmarrjet ekzistuese. Përpos kësaj, Vushtrria do të mbështesë zhvillimet e reja të komunitetit të biznesit vendor dhe ndërkombëtar, duke krijuar edhe hapësira tjera përcjellëse për zhvillimin e tyre.

### 4.1.1. Ngrohtorja e qytetit

| **Titulli i Projektit** | **Ngrohtorja e qytetit (gaz, biomasë, solare)** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Sektori i ngrohjes qendrore është një ndër sektorët shumë të rëndësishëm, që ndikon në mirëqenien e qytetarëve, ekonominë e vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.<br>Ngrohja publike është projekt i rëndësishëm kapital dhe afagjatë për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes për qytetarët, bizneset, institucionet publike të Komunën së Vushtrrisë.<br>Komuna duhet të zhvillojë një studim të fizibilitetit dhe |

| | |
|---|---|
| | hartimin e një Master Plani Zhvillimor i cili e krijon pasqyrën reale të investimit në sektorin e ngrohjes qendrore, përcakton impaktin për qytetarët, bizneset, institucionet publike të Komunës së Vushtrrisë dhe koston e realizimit të tij. Duhet të themelojë ndërmarrjen publike të ngrohjes dhe mbi bazën e Master Planit Zhvillimor të sektorit të ngrohjes publike të hulumtojë për mundësitë e financimit të projektit. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Ofrimin e shërbimeve të ngrohjes për objekte publike, ekonomi familjare dhe biznese;<br>2. Reduktimin e konsumit të energjisë elektrike për ngrohje e cila është me kosto më të lartë;<br>3. Reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse që ndosin ambientin dhe ndikon në ruajtjen e shëndetit të qytetarëve;<br>4. Redukton koston e ngrohjes së objeketeve publike (komuna, spitalet, çerdhet, etj)<br>5. Redukton koston e ngrohjes për ekonomi familjare dhe biznese;<br>6. Kontribuon në mbrojtjen e ambientit dhe klimës në komunë; |
| **Hapat e nevojshëm nga Komuna** | 1. Komuna e Vushtrrisë duhet të bëjë një studim të fizibilitetit për sektorin e ngrohjes qendore duke analizuar të gjithë indikatorët matës duke filluar prej ekonomive familjare, bizneseve, institucioneve publike për ngrohje publike si konsumtator potencial.<br>2. Hartimin e një Master Plani Zhvillimor të sektorit të ngrohjes publike;<br>3. Master Plani Zhvillimor për sektorin e ngrohjes publike ka për qëllim për orientimin e investimeve në të ardhmen, në atë mënyrë që ndër të tjera të sigurohet edhe qëndrueshmëria teknike dhe financiare, determinon në përgatitjen e një Plani Zhvillimor afatgjatë;<br>4. Themelimi i ndërmarrje publike komunale për ngrohje;<br>5. Përcaktimin e lokacionit për vendosje të ndërmarrjes publike;<br>6. Zhvillimin e sistemit të shpërndarjes; |
| **Kosto e projektit** | 12,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Partneritet Publiko-Privat (PPP), Kreditë e buta në IMF (Fondi Monetar Ndërkombëtar), EBRD (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), ËB (Banka Botërore), EIB (Banka Evropiane e Investimeve) apo donatorë tjerë të jashtëm. |
| **Burimi dytësor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë, Qeveria e Republikës së Kosovës |

### 4.1.2. Impiant i ujërave të zeza

| | |
|---|---|
| **Titulli i Projektit** | **Impiant i ujërave të zeza (përmirëson lumin Silnica)** |
| **Qëllimi i Projektit** | Projekti do t'ia mundësojë Komunës së Vushtrrisë ta rehabilitojë, përmirësojë dhe zgjerojë rrjetin e ujërave të zeza dhe ta ndërtojë një impiant për trajtimin e ujërave të zeza të centralizuar me qëllim të mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të zeza sipas standardeve përkatëse mjedisore të BE-së. Komponentët kryesorë të projektit janë: ndërtimi i rrjetit të transmisionit nga njëra anë dhe nga ana tjetër realizimi i |

| | |
|---|---|
| | impiantit komunal të trajtimit të ujërave të zeza. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Zbatimi i projektit do të rezultojë me përfitime të konsiderueshme mjedisore për burimet lokale të ujit të freskët duke i ulur në masë të konsiderueshme vëllimet e ujërave të zeza të papërpunuara dhe ngarkesat ndotëse që ndërlidhen me to dhe që do të shkarkohen drejtpërdrejtë në lumin Silnica;<br>2. Projekti do të kontribuojë në mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore në zonën e projektit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë së zonës;<br>3. Projekti pritet ta shtojë numrin e lidhjeve në rrjetin e kanalizimit dhe ta arrijë pajtueshmërinë me standardet mjedisore të BE-së në trajtimin e ujërave të zeza.<br>4. Projekti e mbështet plotësisht qasjen e agjendës së Tranzicionit të Ekonomisë së Gjelbërt si investim që sjellë dobi mjedisore dhe që zbut efektet e ndryshimeve klimatike.<br>5. Nxitë zhvillimin e turizmit rreth lumit Silnica;<br>6. Eleminon rrezikun potencial për probleme shëndetësore të popullatës së zonës. |
| **Hapat e nevojshëm nga Komuna** | Komuna duhet të inicojë projektin mbi bazën e një studimi të fizibilitetit për përgatitjen e dokumenteve të hollësishme të projektimit dhe të tenderit, tenderimin dhe kontraktimin, si dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për masat e propozuara të projektit. |
| **Kosto e projektit** | 15,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Kreditë e buta në IMF (Fondi Monetar Ndërkombëtar), EBRD (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), ËB (Banka Botërore), EIB (Banka Evropiane e Investimeve) apo donatorë tjerë të jashtëm. |

### 4.1.3. Projekti i gazifikimit të qytetit

| **Titulli i Projektit** | **Projekti i gazifikimit të qytetit** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Projekti i gazifikimit të qytetit është projekti i sistemit të shpërndarjes së ngrohjes përmes gazit. Ky projekt ndikon në implementikmin e projektit të Ngrohjes së Qytetit, i cili është projekt i rëndësishëm kapital dhe afagjtë dhe për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes për qytetarët, bizneset, institucionet publike të komunën së Vushtrrisë.<br>Komuna duhet të zhvillojë një studim të fizibilitetit dhe |

| | |
|---|---|
| | hartimin e një Master Plani Zhvillimor i cili e krijon pasqyrën reale të investimit në sistemin e shpërndarjes së gazit. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Investimi në gazifikim të qytetit ka për qëllim shtrirjen e rrjetit shpërndarës, zvogëlimin e humbjeve të ngrohjes dhe optimizimin e punës së sistemit të shpërndarjes së ngrohjes (balancimi i sistemit, matja dhe faturimi sipas shpenzimit, etj.)<br>2. Ofrimin e shërbimeve efikase të ngrohjes për objekte publike, ekonomi familjare dhe biznese;<br>3. Reduktimin e konsumit të energjisë elektrike për ngrohje e cila është me kosto më të lartë;<br>4. Reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse që ndosin ambientin dhe ndikon në ruajtjen e shëndetit të qytetarëve;<br>5. Redukton koston e ngrohjes së objeketeve publike (komuna, spitalet, çerdhet, etj.)<br>6. Redukton koston e ngrohjes për ekonomi familjare dhe biznese;<br>7. Kontribuon në mbrojtjen e ambientit dhe klimës në komunë; |
| **Hapat e nevojshëm nga Komuna** | 1. Komuna e Vushtrrisë duhet të bëjë një studim të fizibilitetit për sektorin e ngrohjes qendore që gjeneron energji nga gazi duke analizuar të gjithë indikatorët matës duke filluar prej ekonomive familjare, bizneseve, institucioneve publike për ngrohje publike si konsumtator potencial.<br>2. Hartimin e një Master plani zhvillimor të zhvillimit të sistemit të shpërndajres; |
| **Kosto e projektit** | 6,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Partneritet Publiko-Privat (PPP), Kreditë e buta në IMF (Fondi Monetar Ndërkombëtar), EBRD (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), ËB (Banka Botërore), EIB (Banka Evropiane e Investimeve) apo donatorë tjerë të jashtëm. |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë, Qeveria e Republikës së Kosovës |

### 4.1.4. Kredi e butë e Komunës për projekte të mëdha ekonomike/infrastrukturore

| **Titulli i Projektit** | **Kredi e butë e Komunës për projekte të mëdha ekonomike/ infrastrukturore** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Prioriteti i Komunë së Vushtrrisë janë zhvillimi i infrastrukturës, arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe energjia, pasi investimet publike mbështesin shpërndarjen e shërbimeve publike kryesore, lidhin qytetarët dhe bizneset me mundësitë ekonomike, si dhe mund të shërbejnë si katalizatorë për rritje |

| | |
|---|---|
| | ekonomike. Problem mbetet ndarja e fondeve, për shkak të kufizimit të burimeve financiare. Për të shpejtuar zhvillimin e sektorëve prioritarë, komuna e ka mundësinë të ndërmarrë hapa për investime të financuara pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër me financim të jashtëm. Kreditë e buta për investime në projekte të mëdha ekonomike dhe infrastrukturore, kanë për qëllim që sektori privat të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, sepse ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme të klimës për investime, përmirësimin e qeverisjes, rritjen e konkurrueshmërisë në ekonomi si dhe përmirësimin e infrastrukturës publike dhe adresimin e pengesave për zhvillimin e sektorit të energjisë (me theks të veçantën të energjisë së ripërtritshme). Gjithashtu formë tjetër e finanimit të jashtëm është PPP (Partneriteti Publiko-Privat) për investime kapitale në projekte të caktuara. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të kompanive dhe përmirësimit të mjedisit lokal ekonomik;<br>2. Nxit punësimin në nivel lokal dhe rajonal;<br>3. Zhvillon bujqësinë dhe blegtorinë;<br>4. Lidh tregjet më shpejt dhe me kosto më të ulët;<br>5. Rrit mundësinë për arsimim të popullsisë;<br>6. Afron shërbimet shëndetësore;<br>7. Nxit pushtetin vendor për mirë-menaxhim të fondeve të mirëmbajtjes.<br>8. Zhvillim të turizimit;<br>9. Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë energjetike përmes financimit të investimeve në këtë sektor, mbështetjes së reformave dhe promovimit të efiçiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme;<br>10. Përmirësimi i kushteve të jetesës të popullsisë rurale me hartimin e planeve lokale për zhvillimin ekonomik dhe veçanërisht në turizëm;<br>11. Kontributi në zhvillimin ekonomik nëpërmjet punësimit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin rural.<br>12. Përmirësimi i kushteve të transportit në zonat rurale;<br>13. Përmirësimi i shërbimit administrativ, arsimor, shëndetësor. |
| **Hapat e nevojshëm nga Komuna** | Komuna duhet të zhvillojë një program masash dhe aktivitetesh për përgatitjen e projekteve në harmoni me prioritetet e zhvillimit ekonomik, punësimit dhe eksportit dhe të vendosë rregulla strikte se huat publike mund të përdoren vetëm për projekte që janë përgatitur mirë me studime fizibiliteti dhe kapacitete zbatuese dhe të cilat i kalojnë testet e fizibilitetit në aspektin e kthimit të investimeve, bazuar edhe në analizat kosto-përfitime sipas metodologjisë standarde ndërkombëtare. |

| | |
|---|---|
| **Kosto e projektit** | N/A |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | IMF (Fondi Monetar Ndërkombëtar), EBRD (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), ËB (Banka Botërore), EIB (Banka Evropiane e Investimeve) |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë, Qeveria e Kosovës |

### 4.1.5. Zona Ekonomike në Banjskë

| | |
|---|---|
| **Titulli i Projektit** | **Zonë Ekonomike në Banjskë, 220 hektarë në shërbim të Biznesit për krijim të vendeve të punës** |
| **Qëllimi i Projektit** | Krijimi i zonës ekonomike ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin ekonomik lokal, veçanërisht atë privat, të nxisë investimet, të hap vende të reja pune, të tërheq teknologjitë e përparuara, të rrisë konkurrencën e biznesit vendor. Të gjitha procedurat për themelimin e Zonave ekonomike janë të rregulluara me LIGJI Nr. 04/L-159 PËR ZONAT EKONOMIKE. Zonat ekonomike mund themelohen me vendim edhe nga komunat brenda territorit dhe në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.<br>Komuna e Vushtrrisë ka përcaktuar lokacionin e zonës ekonomike në fshatin Banjskë. Të gjitha benefitet të cilat do t'i kenë bizneset brenda zonës ekonomike duhet të nxirren akte nënligjore në koordinim me nivelin qendror të qeverisjes në Republikën e Kosovës. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Nxitjen e investimeve në Vushtrri përmes ofrimit të infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste;<br>2. Zgjerimin e bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe institucioneve;<br>3. Avancimi teknologjik dhe rritja e konkurueshmërisë së prodhimeve dhe shërbimeve vendore;<br>4. Hapja e vendeve të reja të punës;<br>5. Krijimi i një hapësire multi-funksionale dhe ndërvepruese për komunitetin e biznesit;<br>6. Lehtësimi i ambientit biznesor dhe mbështetja e sektorit privat;<br>7. Përshpejtimi i zhvillimit rajonal dhe zgjerimi i lidhjeve ekonomike tregtare brenda dhe jashtë vendit;<br>8. Do të promovohen produktet dhe shërbimet lokale dhe partneritetet publiko-private të hapura për investime.<br>9. Do të ketë mundësi të madhe për rrjetëzim, kontakte në mes bizneseve, institucioneve shtetërore dhe organizatave/shoqatave.<br>10. Zonë e lirë taksuese 10 vjeçare në Banjskë |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna:** | 1. Studimin e fizibilitetit për themelimin e zonës ekonomike; |

| | |
|---|---|
| | 2. Komuna duhet të inicojë projektin mbi bazën e një studimi të fizibilitetit për përgatitjen e dokumenteve të hollësishme të projektimit dhe të tenderit, tenderimin dhe kontraktimin, si dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për masat e propozuara të projektit.<br>3. Vendimi për themelimin e zonës ekonomike;<br>4. Përcaktimin e lokacionit të zonës ekonomike;<br>5. Investime në infrastrukture brenda zonës ekonomike;<br>6. Hartimin e politikës së menxhimit, shfrytëzimit dhe tërheqjes së investimeve të bizneseve në zonës ekonomike;<br>7. Hartimi i politikave lehtësuese në bashkëpunim me nivelin qendror për bizneset brenda zonës ekonomike; |
| **Kosto e projektit** | 5,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna Vushtrri, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Partneriteti Publiko Privat (PPP) |

### 4.1.6. Ndërtimi i parkingjeve publike në Vushtrri

| **Titulli i Projektit** | **Ndërtimi i parkingjeve publike në Vushtrri** |
|---|---|
| **Qëllimi i projektit** | Në vitet e fundit Vushtrria ka pasur një rritje të shpejtë të popullsisë dhe fluks të madh të migrimit nga zonat rurale në ato urbane.<br>Është nevojë emergjente për një studim të fizibilitetit të mënyrave të udhëtimit dhe çështjeve të udhëtimit në Vushtrri për të mbështetur hartimin e një strategjie për mobilitetin e ri urban. Dhe një ndër sfidat kyçe që ka të bëjë me mobilitetin urban në qytet është parkimi i automjeteve brenda zonës urbane. |

| | |
|---|---|
| **Benefitet e projektit** | Një numër opsionesh të kontrollit të parkimit janë në dispozicion në Vushtrri, për të menaxhuar kërkesën për parkim në qytet në mënyrë më efektive.<br>1. Adaptim në standardet evropiane të rrugëve, me ndërtim të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë si dhe parkingje për vetura;<br>2. Krijimi efikas i një sistemi të autoparkingut në qytet dhe një shkëmbim periferik i autoparkingjeve për të reduktuar hyrjen e automjeteve në bërthamën e qytetit;<br>3. Sistemin e parkimit me pagesë në qendër të qytet (çmime relativisht të larta dhe periudha të kufizuara kohore), duke përfshirë krijimin e objekteve të parkimit 'Parko & Udhëto'.<br>4. Kufizimi/rregullimi i hapësirave private të parkimit (në mënyrë legjislative ose nëse nuk është e mundur atëherë me masa të trafikut për infrastrukturë rrugore).<br>5. Krijimi i "zonave rezidenciale" në zonat që rrethojnë qendrën e qytetit – për të mbrojtur banorët lokalë dhe komunitetet nga aktiviteti parkues i njerëzve të tjerë (personat që banojnë në periferi/vizitorët). Rezidenti do të ketë hapësirë parkimi PA PAGESË brenda zonës ku është rezident.<br>6. Hapësirat e pandërtuara dhe zonat e lira duhet të përdoren kryesisht për të përmirësuar mjedisin ekzistues urban dhe jetesën, sasinë, p.sh. rritjen dhe cilësinë e hapësirave publike, duke përfshirë edhe zonat e gjelbërta, për këmbësorë dhe shtigjet për çiklistë, si dhe parking për automjete. |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna:** | Studim i fizibilitetit të mënyrave të udhëtimit dhe çështjeve të udhëtimit në Vushtrri për të mbështetur hartimin e një strategjie për mobilitetin e ri urban me fokus të krijimit hapësirave dhe rregullimit të parkingjeve brenda zonës urbane; |
| **Kosto e projektit:** | 3,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | PPP (Partneriteti Publiko Privat), Qeveria e Kosovës |

### 4.1.7. Parku rekreativ "Taraxha"

| **Titulli i Projektit** | **Parku rekreativ "Taraxha"** |
|---|---|
| **Qëllimi i projektit** | Parku "Taraxha" është parku më i madh natyror që ndodhet në distance 6 km prej qendrës së qytetit të Vushtrrisë. Ofrimi i hapësirave të gjelbëruara në komunën e Vushtrrisë është nevojë e cilësuar nga qytetarët. Krijimi i hapësirave rekreative për qytetarët sjellin nevojën e rehabilitimit të këtij parku.<br>Rehabilitimi i parkut konsiston në:<br>1. Investime në hapësira të përshatshme për akomodim; |

| | |
|---|---|
| | 2. Krijimin e infrastrukturave të nevojshme për ecje, vrapim dhe piknik,<br>3. Shesh lojrash për fëmijë gjithpërfshirëse<br>4. Shesh lojrash për të rritur (Lojëra tavoline, tavolina ping-pong, etj.)<br>5. Fusha sportive (Futboll, Volejboll, Basketboll, Tenis)<br>6. Hapësira e dedikuar për kafshë<br>7. Ulëse/Pushimore<br>8. Hapësira parkimi për vetura dhe biçikleta<br>9. Risistemim të gjelbërimit dhe ripyllëzime sipas nevojës, apo ndërhyrje të tjera që sipas nevojës mund të dalin gjatë procesit të projektimit.<br>Pikë strategjike e rëndësishme është nëse gjen Komuna e Vushtrrisë mundësi përmes partneritetit publiko – privat që në një hapësirë të parkut "Taraxha" të investohet dhe shndërrohet në "Park i Aventurave" i cili do të bëhej zone atraktive turstike për qytetarë të Vushrrisë, por do jetë atraksion edhe për turistë në niveli vendi dhe të huaj. Ky investim do të ndikonte në zhvillim të hovshëm të turizmit, gjenerim të vendeve të reja të punës dhe zhvillim të ekonomive familjare në fshatrat e afërta me Taraxhë. |
| **Benefitet e projektit** | Parku rekreativ "Taraxha" do të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Komunës së Vushtrrisë:<br>1. Për një zhvillim më të shpejtë ekonomik duke tërhequr investime në HORECA dhe zhvillim të turizmit;<br>2. Zhvillim të ekonomive familjare të produkteve bujqësore dhe blegtorale;<br>3. Gjenerim të vendeve të reja të punës;<br>4. Do të ndikojë në përmirësimi të kualitetit të jetës;<br>5. Do të mbrojë resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore.<br>6. Hapësirë rekreative për qyetarë;<br>7. Zhvillimi i turizimit (malor, dimëror, veror, rural, aktivitetet në natyrë, turizmi shëndetësor, ekskursionet turistike, etj);<br>8. Përmirësimi i infrastrukturës së parkut "Taraxhë";<br>9. Krijimi i hpësirave atratkive për qytetarët e Vushtrrisë dhe turistë të huaj; |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna:** | 1. Studimin e fizibilitetit për investime në parkun rekreativ "Taraxha";<br>2. Komuna duhet të inicojë projektin mbi bazën e një studimi të fizibilitetit për përgatitjen e dokumenteve të hollësishme të projektimit dhe të tenderit, tenderimin dhe kontraktimin, si dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për masat e propozuara të projektit. |
| **Kosto e projektit:** | 5,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Partneriteti Publiko Privat (PPP), Niveli qendror (ministritë përkatëse) të Republikës së Kosovë apo donatorë të jashtëm; |

### 4.1.8. Turizmi malor në Zonën e Shalës

| Titulli i Projektit | Turizmi malor në Zonën e Shalës |
|---|---|
| **Përshkrimi i Projektit** | Viteve të fundit njëra prej modeleve më të suksesshme të biznesit janë pikërisht investimet në agroturizëm, të cilat po bëhen gjithnjë e më shumë tërheqëse. Krijimi i bujtinave pritëse, që bashkojnë në një eksperiencë të veçantë në njohjen me natyrën, kulturën, njerëzit, por edhe me produktet tipike vendase, gastronominë apo recetat tradicionale të gatimit, ka bërë që agroturizmet të jenë në fokus të zhvillimit. Interesi i turistëve të huaj për traditën dhe natyrën, ka bërë që shumë prej tyre të drejtohen në bujtinat e zonave rurale për të provuar shijet autentike vendase, natyrën e mrekullueshme dhe traditën unike të vendit tonë. Por jo vetëm, çdo ditë e më shumë këto lloj mjedisesh po kthehen në vendet e preferuara edhe të turistit vendas.<br>Komuna e Vushtrrisë e ka avantazhin e fshatit Shalë është e interesuar në diversifikimin e ofertës aktuale të turizmit në këtë fshat, në mënyrë që të sigurohet zhvillim i integruar dhe i qendrueshëm i turizmit. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Zhvillim të turizimit (turizmi malor, dimëror, veror, rural, aktivitetet në natyrë, turizmi shëndetësor, ekskursionet turistike, etj.)<br>2. Nxitja e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor;<br>3. Përmirësimi i kushteve të jetesës në zonën e Shalës;<br>4. Zhvillim të ekonomive familjare të produkteve bujqësore dhe blegtorale;<br>5. Vetëdijësimi i popullsisë dhe zbatimi i infrastrukturës për ruajtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore;<br>6. Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit natyror;<br>7. Promovimi i vlerave të turizmit rural; |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna** | 1. Përmirësimi i infrastrukturës publike (Mbështetja për infrastrukturën rrugore, shërbimet publike, infrastrukturën mjedisore dhe turistike, monumentet e trashëgimisë kulturore, peizazhin),<br>2. Krijimin e infrastrukturave të nevojshme për ecje, vrapim dhe piknik,<br>3. Zhvillim i fushtave promovuese të bukurive natyrore të zonës së Shalës, bujtinave, restoraneve, ekonomive familjare me prodhime bujqësore dhe blegtorale;<br>4. Stimulim i investimeve private për rritjen e kapaciteteve të shtretërve për pushim;<br>5. Tërheqja e investitorëve në zonën e Shalës;<br>6. Nxitjen e transferimit të njohurive për risi në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale;<br>7. Subvencionim i ekonomive familjare për produkte bujqësore dhe blegotori me qëllim të rritjes së kapaciteteve dhe cilësisë;<br>8. Trajnime profesionale për ngritje të kapaciteteve për zhvillim të turizmit dhe ekonomive familjare në zonën e Shalës; |
| **Kosto e projektit** | 1,500,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë |
| **Burimi i mundshëm dytësor i** | PPP, Niveli qendror (ministritë përkatëse) të Republikës së |

| | |
|---|---|
| **financimit** | Kosovë apo donatorë të jashtëm |

### 4.1.9. Liqeni akumulues në Sllakoc

| **Titulli i Projektit** | **Liqeni akumulues në Sllakoc** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Komuna e Vushtrrisë ka planifikuar ndërtimin e një liqeni artificial në fshatin Sllakoc, i cili do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve për ujë të pijshëm, ujitje dhe prodhimin e energjisë së ripërtritshme. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Projekti do të rris kapacitetet e ujit të pijshëm;<br>2. Rritjen e kapaciteteve për ujitje;<br>3. Mundësinë e prodhimit të energjisë së ripërtritshme;<br>4. Do të ndikojë në zhvillimin e turizmit;<br>5. Tërheqjen e investimeve në HORECA;<br>6. Krijimin e hapësirave rekreative dhe sportive;<br>7. Gjenerimin e vendeve të reja të punës; |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna** | 1. Studimin e fizibilitetit për ndërtimin e liqenit artificial në fshatin "Sllakoc"<br>2. Komuna duhet të inicojë projektin mbi bazën e një studimi të fizibilitetit për përgatitjen e dokumenteve të hollësishme të projektimit dhe të tenderit, tenderimin dhe kontraktimin, si dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për masat e propozuara të projektit.<br>3. Planin për thithjen e investimeve për financimin e implementimit të projektit; |
| **Kosto e projektit** | 15,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë, |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Partneritet Publiko-Privat (PPP), Kreditë e buta në IMF (Fondi Monetar Ndërkombëtar), EBRD (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), ËB (Banka Botërore), EIB (Banka Evropiane e Investimeve) apo donatorë tjerë të jashtëm. |

### 4.1.10. Shfrytëzimi i resurseve minerare

| **Titulli i Projektit** | **Shfrytëzimi i resurseve minerare** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Komuna e Vushtrrisë është e pasur me resurse minerale, nga të cilat resurset minerale në fshatrat Karaçë, Gumnishtë dhe Boshlan – xehrore e Plumbit dhe e Zinkut, Duboc – Magnezit dhe Porcelan, pastaj në Bivolak, Zhilivodë, Beçuk, Stroc, Gllovotinë – qymyr druri dhe Pasomë, Tërllobuq, Smrekonicë dhe Shalë – shfrytëzimi i gurit të cilat paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit.<br>Vushtrria po ashtu është e pasur dhe më një numër të |

| | |
|---|---|
| | konsiderueshëm të vendburimeve jo-metalore, industriale por edhe ujin mineral dhe termal, pa përjashtuar edhe burimet e energjisë gjeo-termale në Bajnskë – ujë termik dhe mineral, Gjelbishtë and Gojbulë – ujë mineral.<br>Nevojitet hartimi i një studimi dhe strategjie promovuese për resurset minerale dhe jo minerale të cilat i posedon komuna për tërheqjen e investitorëve dhe valorizimin ekonomik të tyre. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Nxitjen e investimeve në Vushtrri për shfrytëzimin dhe valorizimin ekonomik të resurseve minerale dhe jo-minerale;<br>2. Zgjerimin e bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe institucioneve;<br>3. Avancimi teknologjik dhe rritja e konkurueshmërisë së prodhimeve;<br>4. Hapja e vendeve të reja të punës;<br>5. Lehtësimi i ambientit biznesor dhe mbështetja e sektorit privat;<br>6. Përshpejtimi i zhvillimit rajonal dhe zgjerimi i lidhjeve ekonomike tregtare brenda dhe jashtë vendit;<br>7. Do të promovohen resurset lokale dhe partneritetet publiko-private të hapura për investime. |
| | 8. |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna** | 1. Studimin e fizibilitetit për shfrytëzimin e resurseve minerale dhe jo-minerale të komunës së Vushtrrisë;<br>2. Komuna duhet të inicojë projektin mbi bazën e një studimi të fizibilitetit për përgatitjen e dokumenteve të hollësishme të projektimit dhe të tenderit, tenderimin dhe kontraktimin, si dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për masat e propozuara të projektit. |
| **Kosto e projektit** | 100,000,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Investime e Huaja Private me Patneritet Publiko-Privat |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Niveli qendror (ministritë përkatëse) të Republikës së Kosovë |

### 4.1.11. Zhvillimi i kapaciteteve në energji të ripërtritshme

| **Titulli i Projektit** | **Zhvillimi i kapaciteteve në energji të ripërtritshme** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Komuna e Vushtrrisë ka potencial të madh për ta shtuar efiçiencën e energjisë dhe për t'i integruar burimet e ripërtëritshme në kombinimin e saj të furnizimit me energji. Kërkesa për energji është parashikuar të rritet për afro 4.6% në vit deri në vitin 2020, nevoja për ta shtuar efiçiencën e energjisë po bëhet gjithnjë e më urgjente.<br>Komuna ka nevoje për ngritjen e kapaciteteve komunale dhe të jetë në hapat me kohën për menaxhimin e investimeve në energji efiçiente dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së |

| | |
|---|---|
| | ripërtritshme. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Projekti synon ta reduktojë konsumin e energjisë dhe përdorimin e karburanteve fosile në ndërtesat publike.<br>2. Përmes këtij investimi do të ndikohet në avancimin e mjedisit politik dhe rregullativ për energji të ripërtëritshme dhe efiçiencë të energjisë.<br>3. Investimet në efiçiencën e energjisë në sektorin publik mund t'i ulin dukshëm shpenzimet e energjisë, duke krijuar hapësirë fiskale për prioritetet zhvillimore të tjera dhe duke e shtuar aftësinë konkurruese dhe krijimin e vendeve të punës.<br>4. Ngritjen e kapaciteteve komunale për menaxhimin e energjisë efiçiente dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së ripërtritshme;<br>5. Ngritjen e kapaciteteve komunale për hartimin politikave për tërheqjen e investimeve në energji efiqiente dhe burime të energjisë së ripërtritshme; |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna** | 1. Studim i fizibilitetit për identifikimin e burimeve të energjisë së ripërtritshme;<br>2. Ngritja e zyrave komunale për energji;<br>3. Krijimin e mekanizmat për zbatimin e efiçiencës së energjisë në nivelin lokal;<br>4. Trajnimi i zyrtarëve të komunës për Energji të Ripërtrishme;<br>5. Bashkëpunimi regjional për këmbim të përvojave për Energji të ripërtritshme dhe Mbrojtje të Mjedisit;<br>6. Organizimi i vizitave studimore për zyrtarët e komunës;<br>7. Komuna t'u jap prioritet projekteve për efiçiencë të energjisë, me bashkëfinancim;<br>8. Projekte për sensibilizimin e opinionit për energji të ripërtritshme;<br>9. Marrja e kredive të buta për projekte të energjisë së ripërtritshme;<br>10. Masa lehtësuese për bizneset – investitorët në burime të ripëtritshme të energjisë; |
| **Kosto e projektit** | 110,000.00 Euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Investimet Private, PPP |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | BE (Bashkimi Europian), EBRD (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim), EIB (Banka Europiane për Investim), donatorët apo Qeveria e Kosovës. |

### 4.1.12. Tregu për prodhues vendor/lokal

| **Titulli i Projektit** | **Tregu për prodhues vendor/lokal** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Komuna e Vushtrrisë është e orientuar nga përkrahja dhe vendosja e lehtësirave për prodhues dhe fermer lokal dhe vendor prandaj tregu është vendi i duro për plasimin më të leht për të shkaktuar kërkesa për prodhimet lokale. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Lehtësira për prodhuesit vendor/lokal për plasimin e produkteve të tyre pa shpenzime;<br>2. Zgjerimin e bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe |

| | |
|---|---|
| | institucioneve;<br>3. Rritjen e këkresës për produkte vendore/lokale;<br>4. Hapja e vendeve të reja të punës;<br>5. Lehtësira për biznese dhe mbështetja e sektorit privat dhe fermerët;<br>6. Përshpejtimi i zhvillimit rajonal dhe zgjerimi i lidhjeve ndërmjet ofertës dhe kërkesës;<br>7. Do të promovohen produktet dhe shërbimet lokale dhe partneritetet publiko-private të hapura për investime të reja.<br>8. Do të ketë mundësi të madhe për rrjetëzim, kontakte në mes bizneseve, institucioneve shtetërore dhe organizatave/shoqatave.<br>9. Zonë e lirë për prodhuesit lokal për plasimin e produkteve të tyre; |
| **Hapat e nevojshëm nga komuna** | 1. Komuna duhet të formojë një ekip punues për hartimin e politikave lehtësuese dhe rregullimin e të gjitha akteve normative/juridike për ofrimin e mbështetjes apo benefiteve ndaj bizneseve;<br>2. Vendimi për themelimin e tregut për prodhues vendor/lokal;<br>3. Hartimi i projektit teknik për tregun lokal;<br>4. Hartimi i propozimit teknik për tregun lokal;<br>5. Destinimi i hapsirës së nevojshme për tregun;<br>6. Tërheqja e investimeve për ndërtimin e tregut; |
| **Kosto e projektit** | 650.000 euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Ambinetit |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Donatorët |

### 6.1.13. Identifikimi i të papunëve sipas strukturës, kualifikimit dhe përcaktimi i nevojave të tyre për punësim

| **Titulli i Projektit** | **Identifikimi i të papunëve sipas strukturës, kualifikimit dhe përcaktimi i nevojave të tyre për punësim** |
|---|---|
| **Qëllimi i Projektit** | Identifikimi i papunësisë do t'i mundësojë Komunës së Vushtrrisë të njihet me strukturën dhe nevojat e tyre dhe të planifikojë aktivitetet e nevojshme për aftësimin e tyre për treg të punës. Përmes këtij projekti Komuna e Vushtrrisë do të krijojë kërkesë reale për tregun e punës dhe do t'i harmonizojë ofertën me kërkesat për fuqi punëtore nga bizneset lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. |
| **Benefitet e projektit** | 1. Identifikimi i saktë i të papunëve sipas strukturës dhe kualifikimeve;<br>2. Mundësia e qasje për pregatitjen e tyre për treg të punës;<br>3. Aftësimi i të papunëve për tregun lokal dhe ndërkombëtar; |

| | |
|---|---|
| | 4. Lehtësira për bizneset lokale duke i ofertuar me fuqi të aftë punëtore. |
| **Hapat e nevojshëm nga Komuna** | 1. Metodologjia e implementimit;<br>2. Hartimi i pyetësorëve;<br>3. Aftësimi i anketuesve;<br>4. Anketimi;<br>5. Krijimi i bazës së të dhënave;<br>6. Studimi i strukturës;<br>7. Përcaktimi i nevojave për aftësim për tregun real të punës;<br>8. Aftësimin e tyre për treg të punës. |
| **Kosto e projektit** | 15.000 euro |
| **Burimi i mundshëm kryesor i financimit** | Komuna e Vushtrrisë |
| **Burimi i mundshëm dytësor i financimit** | Qeveria e Kosovës dhe Donatorët |

## 4.2. Qasja programore për ndërtimin e strukturës institucionale për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Ky objektiv është i fokusuar në ndërtimin e strukturës funksionale dhe të qëndrueshme që për periudhë afatgjatë do të sigurojë rritje të ekonomisë lokale dhe të punësimit. Aktivitetet afatgjata janë të bazuara në:

- Vendosjen e parimeve themelore në menaxhimin e buxhetit;
- Krijimin e infrastrukturës ligjore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Ristrukturimin dhe krijimin e institucioneve që e sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik;

- Krijimin e fondeve (buxhetore dhe jo-buxhetore) për mbështetjen e bizneseve dhe punësimit;
- Ngritjen e kapaciteteve komunale (publiko-privat) për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal;
- Ndërtimin e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të sektorit publik dhe atij privat.

Komuna e Vushtrrisë e sheh segmentin e shoqërisë civile dhe angazhimet e tyre si tejet të rëndësishëm, e në veçanti ato aktivitete që drejtpërdrejtë kontribuojnë në avancimin e interesave të komunitetit.

### 4.2.1. Master Plan Zhvillimor të Komunës së Vushtrrisë

Planifikimi afatgjatë është udhërrëfyes për arritje më të lehtë dhe shpejtë të objektivëve komunalë. Pasi që Komuna të bëjë Moratoriumin është e domosdoshme që të bëhet një planifikim i qëndrueshëm afatgjatë që do t'i mundësojë Komunës të identifikojë dhe t'i qaset projekteve të mëdha kapitale të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit. Master Plani do të japë udhëzime të qarta për:

- Burimet e nevojshme njerëzore dhe fizike;
- Sigurimi i trajtimit të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë;
- Ndërtimi i themeleve për optimalizimin e proceseve dhe strukturave organizative;
- Alokimi efikas i resurseve;
- Përcaktimi i prioriteteve që kanë të bëjnë me investimet e nevojshme;
- Të bazuarit e master-planit në strukturat e zhvilluara historikisht.

Vlerësimin i kapacitetit të nevojave për dhjetëvjeçarin e ardhshëm, me Master Plan Zhvillimor tentohet që Vushtrria të jetë dhe avancojë si:

Qytet i së ardhmes - Për të rinjtë, studentët, fëmijët dhe pleqtë, për qytetarët e saj. Me planifikim të kujdesshëm të qytetit dhe të integruar me botën, të shoqërisë së njohurive, mjedisit të pastër dhe të gjelbër, qytetit të larmishëm dhe atraktiv për të jetuar dhe punuar në të, konkurrent në regjion.

Qytet Historik - Ku vlerat historike të kombit tonë gërshetohen me veprimet moderne të ekonomisë së tregut. Planifikohet me kujdes, duke parasysh të vjetrën e ndritur kulturore dhe historike, identitetin urban të një qyteti historik dhe tregtar, kulturor, përmes shfrytëzimit racional të hapësirës.

Qytet Zhvillimor - Ekonomikisht stabil dhe i suksesshëm, qendër e bizneseve të shumta vendore dhe ndërkombëtare, duke e bërë qendër të rëndësishme logjistike.

Qytet Inkubator – Qytet i cili ofron infrastrukturën, platformën "Si - të dish" dhe financat për të mbështetur këto biznese, qofshin ato të dala apo të ofruara nga jashtë komunës, apo nga ndërmarrjet ekzistuese. Qytet që mbështet zhvillimet e reja të komunitetit të biznesit vendor dhe ndërkombëtar, duke krijuar edhe hapësira tjera përcjellëse për zhvillimin e tyre.

Me Master Plan Zhvillimor sigurohen kushtet për zhvillim ekonomik lokal, duke joshur dhe ruajtur ndërmarrjet aktive në qytet, ofrimin e hapësirave kulturore, tregtare dhe rekreacionit – pushimit.

### 4.2.2. Vendosja e parimeve në menaxhimin e Buxhetit të Komunës

Pandemia dhe masat e ndërmarra të Qeverisë së Kosovës si në pakon emergjente ashtu edhe atë të Rimëkëmbjes Ekonomike kanë ndikuar fuqishëm në zgjerimin e hendekut mes të hyrave buxhetore dhe shpenzimeve në sektorin publik, edhe atë duke ulur të hyrat buxhetore dhe rritur nevojën për shpenzime shtesë. Ky hendek është veçanërisht i lartë gjatë këtij viti, por pritet të vazhdojë edhe përgjatë viteve vijuese si rezultat i implementimit të masave të fazës së dytë. Komuna e Vushtrrisë synon të përdorë kryesisht këto burime të financimit për të mbuluar kërkesat në rritje për shpenzime buxhetore:

- Ristrukturimi në menaxhimin e buxhetit në disfavor të shpenzimeve kapitale;
- Burimet e gjeneruara nga fondet nacionale dhe internacionale;
- Burimet nga Qeveria e Kosovës.

Duke qenë se Buxheti i Komunës është baza për mbulimin e Pakos së Rimëkëmjes atëherë janë rekomanduar parimet në menaxhimin e buxhetit për vitet e ardhshme si:

- Zhvillimi ekonomik lokal të trajtohet veçmas nga bujqësia;
- Të transferohet dhe trajnohet stafi kompetent në zhvillim ekonomik lokal;
- Kategoria e të hyrave "Të Hyrat Vetanake" të destinohet si Subvencioni dhe Transfere;
- Të hyrat vetanake të Komunës së Vushtrrisë duhet të rriten gradualisht duke filluar në vitin 2021, pasi që në 2020 kanë shënuar një rënie të lehtë;
- Komuna të transferojë më shumë staf në departamentet për mbledhje të të hyrave vetanake;
- Të aftësojë stafin komunal kompetent për mbledhjen e të hyrave vetanake duke u bazuar në qasje proaktive dhe bashkëpunuese me biznese;
- Të hartojë politika për përkrahjen e bizneseve të cilat ndikojnë/ndërlidhen edhe në rritje të të hyrave;
- Shpenzimet komunale për zhvillim ekonomik në vitet e ardhshme duhet të rriten;
- Fondi për mbështetje financiare të bizneseve të trajtohet veçanërisht nga fondi për bujqësi;
- Fondi për mbështetje financiare të bizneseve, kategoria "Subvencionet dhe Transferet" të rritet së paku për 100%;
- Hartimi i rregulloreve komunale për mbështetje finaciare dhe shërbime të veçanta të bizneseve të Komunës së Vushtrrisë;
- Hartimi i rregulloreve për mbështetje financiare dhe shërbime të veçanta për të vetpunësuar dhe prodhues;

- Të hyrat vetanake të realizuara nga bizneset rekomandohet që të i kthehen së paku dyfish bizneseve, në formë të përkrahjes dhe investimeve që ata i përcaktojnë;
- Të organizohet komuniteti i biznesit në mënyrë që ata të jenë pjesë e vendimmarrjes dhe planifikimit të buxhetit;
- Në kuadër të fondit për mbështetje financiare të bizneseve të destinohet 30% e tyre për krijimin e vendeve të reja të punës përmes vetëpunësimit;
- Të hartoj forma të stimulimit/motivimit të tatimpaguesve të rregulltë me qëllim të rritjes më të lartë të inkasimit vullnetar;

### 4.2.3. Aktivizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Grupit Lokal të Veprimit "Vicianarural"

Përkrahja dhe zhvillimi i zonave rurale po bëhet nëpërmjet shumë formave, të cilat deri më tash janë treguar mjaft të suksesshme. Përveç përkrahjes së drejtpërdrejtë të fermerëve, institucionet vendore po përkrahin edhe realizimin e shumë projekteve, me Grupet Lokale të Veprimit (GLV), nëpër komuna.

Realizimi i projekteve me këto grupe ka filluar të realizohet që nga viti 2009, në partneritet me komunat dhe Ministrinë e Bujqësisë. Qëllimi i këtyre grupeve, përveç përkrahjes së fermerëve është edhe rregullimi i infrastrukturës dhe realizimi i projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë më përmirësimin e jetës së banorëve në zonat rurale.

GLV "Vicianarural" konsiderohet pasiv prej dy vitesh, pasi që kanë konsideruar që kushtet e Ministrisë së Bujqësisë janë shumë të pavaforshme për funsionimin e tij. Megjithatë në Kosovë ka disa storje të suksesit, të cilat sot janë bartëse të zhvillimit rural në komuna. GLV mund të kryej edhe funksionin e kooperativave buujqësore me shumë sukses, të cilat funksionojnë me koncepte bashkëkohore dhe si të tilla i ndihmojnë fermerët në mënyra të ndryshme duke filluar nga sigurimi i tregut dhe planifikimi i mbjelljeve, në mbështetjen profesionale dhe teknike, në sigurimin e farave dhe fidaneve e deri në gjetjen e financimeve dhe implementimin e projeteve të ndryshme.

GLV "Vicianarural" do të funksionojë sipas 7 parimeve kyqe të Konceptit LEADER si:

- Strategjitë Zhvillimore Lokale të bazuara në zonë
- Partneritetet lokale publiko-private: Grupet Lokale të Veprimit
- Qasja nga poshtë-lartë
- Veprimet e integruara dhe shumësektoriale
- Inovacioni
- Bashkëpunimi
- Rrjetizimi

Grupi Lokal i Veprimit “Vicianarural” duhet të jetë forcë bartëse e zhvillimit lokal dhe të sigurojë bashkëpunimin dhe vashkëveprimin e institucioneve private dhe institucioneve publike. Ky grup do të marrë përsipër që të angazhojë staf i cili do të aftësohet në pregatitje të:

- Projekt propozime për biznese;
- Projekt propozime në llogari të Komunës;
- Të aftësojë stafin e kompanive private sipas nevojës së tyre;
- Të asistojë Komunën në gjenerimin e fondeve nga Qeveria e Kosovës;
- Gjenerimin e fondeve nga agjensionet kombëtare dhe ndërkombëtare;

Ekspertët e “M Holding” do të marrin përsipër që të asistojnë në formimin e organeve të nevojshme të GLV “Vicianarural”, si dhe trajnimin e stafit dhe hartimin e disa projekt propozimeve.

### 4.2.4. Krijimi i Fondit për Zhvillim Ekonomik Komunal

Komuna e Vushtrisë me një rregullore të veçantë apo me vendim të krijojë një Fond për Zhvillim Ekonomik Lokal. Fondi mund të themelohet si fondacion apo mund të ndahet për çdo vit vlerë e caktuar e buxhetit (100,000 euro) e cila destonohet për mbështetje të bizneseve të vogla dhe bizneseve mikro. Ndarja e këtij fondi bëhet sipas kritereve të përcaktuara në vendim apo rregullore.
Rregullorët që komuna duhet t’i nxjerrë janë:

- Rregullore për krijimin e Fondit për Zhvillim Ekonomik Lokal (mund të krijohet si fondacion i jashtëm);
- Rregullore për përkrahjen e bizneseve (përfshihen kushtet dhe kritret, si p.sh.: punëtorët e rinj financohen me 50% të pagës);
- Rregullore për përkrahjen e prodhuesve;
- Fondi për Garanci Kreditore;

Qëllimi i përgjithshëm i Fondacionit Fondi për Zhvillim Ekonomik Lokal është promovimi i zhvillimit regjional të integruar dhe të qëndrueshëm në Sektorin e Bujqësisë duke forcuar strukturat lokale ekzistuese dhe potenciale.

### 4.2.5. Qendra e Biznesit

Qendra e Biznesit është e formuar përbrenda administratës të Kuvendit Komunal për të përkrahur zhvillimin ekonomik. Punonjësit e kësaj zyre do të ndihmojnë NVM-të dhe do të koordinojnë projektet komunale, p.sh.: ndihma në përgatitjen e të gjithë dokumenteve të nevojshme, eliminimin e

pengesave në nivel komunal, në nivele ministrive përkatëse dhe të ngjashme. Kjo zyre duhet të punësojë së paku tre punonjës dhe duhet të jetë e pajisur mirë me pajisje TI (Teknologji Informative) si  dhe pajisje tjera të nevojshme për të kryer suksesshëm punën. Personeli i zyrës duhet të jetë i trajnuar në strategjitë e zhvillimit ekonomik me qëllim që t'i takojë nevojat e ekonomisë së tregut. Punëtorët duhet të udhëheqin hulumtime të zbatueshmërisë për secilin projekt komunal sa më parë që është  mundur. Pasi të përfundohen vlerësimet teknike dhe hulumtimet financiare, projekti duhet të përkrahet nga kjo zyre me qëllim që të vazhdoj më tutje. Kjo zyre do të përfitonte nga lidhje më të mira të bashkëpunimit me bizneset dhe kompanitë të dhe ato përreth Komunës. Do të funksionojë si një zyrë për këshillime ekonomike dhe përfaqësojë kompanitë e suksesshme brenda dhe jashtë Kosovës.

Bartëse e zhvilimit ekonomik lokal do të jetë Qendra e Zhvillimit Ekonomik Lokal - QZHEL.

### 4.2.6. Qendra Komunale për Zhvillim Ekonomik

QKZHE është instuticion që merret me zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë. Kjo qendër bën planifikimin, kordinimin dhe implementimin e zhvillimit ekonomik të komunës:

Funksionet kryesore të qendrës përfshirë si:

- organizimin strategjik, vlerësimin e ekonomisë lokale, krijimin e strategjisë, implementimin dhe evaluimin.
- Koordinon procesin e zhvillimit ekonomik lokal me të gjithë partnerët si: pushteti lokal, qendra e biznesit, qytetarët, shoqëria civile, arsimin, etj.
- Angazhon të gjithë akterët në zhvillim ekonomik lokal, krijimin e vendeve të punës dhe përmirsimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Planifikon dhe harton projekt-propozime.
- Menaxhon zhvillimin ekonomik lokal.

### 4.2.7. Këshilli për Zhvillim Ekonomik Lokal

KZHEL është organi më i lartë i zhvillimit ekonomik të komunës, por nuk merr vendime drejtpërdrejtë pasi që kryesisht është organ aprovues dhe miratues për çështje të zhvillimit ekonomik të komunës. Përbërja e KZHEL përfshinë të gjithë partnerët dhe akteret që mund të ndikojnë dhe kontribojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Përkufizimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e KZHEL:

1. Këshilli i Zhvillimit Ekonomik Lokal është organ jo-vendimmarrës.
2. KZHEL është organ që miraton dhe aprovon të gjitha vendimet, strategjitë dhe planet që kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik lokal, para se të miratohet në Asamblenë Komunale.
3. KZHEL është mekanizëm filtrues i të gjitha vendimeve që kanë të bëjnë me zhvilllim ekonomik lokal.
4. Inicion vendime, projekte, strategji dhe plane për zhvillim ekonomik lokal.
5. Ndërvepron me Asamblenë Komunale për të gjitha veprimet dhe planet e zhvillimit ekonomik lokal.
6. Propozon vendime për Asamblenë Komunale.
7. Bashkvepron me kryetarin e komunës për zhvillim ekonomik lokal.
8. Përfaqëson komunën para menakizmave shtetëror dhe ndërkombëtar për zhvillim ekonomik lokal.
9. I mbështet profesionalisht dhe institucionalisht vendimet dhe ndërmarrësit e kryetarit për zhvillim ekonomik lokal.
10. Organizon mekanizmat e komunës, qeveritare dhe joqeveritare në drejtim të zhvillimit ekonomik lokal.

Përbërja e KZHEL:

1. Kryetari i Komunës, i cili është edhe kryetar i KZHEL.
2. Gjashtë (6) përfaqësues nga komuniteti i biznesit të cilët propozohen nga Qendra e Biznesit dhe të cilët përfaqësojnë fuqi ekonomike. Prioritet kanë biznismenët duke filluar nga më i suksesshmi.
3. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
4. Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Bujqësi
5. Dy (2) të deleguar nga Qendra e Biznesit
6. Dy (2) përfaqësues nga sektori i bujqësisë (preferohen të mos jenë nga komuna)
7. Një (1) ekspert nga fusha e urbanizmit
8. Dy (2) të deleguar nga mekanizmat e shoqërisë civile.
9. Një (1) ekspert nga lëmia e arsimit (preferohet të mos jetë nga komuna)
10. Dy (2) anëtarë që përfaqësojnë vlera dhe që nuk janë të përfshirë në këta mekanizma.

Meqenëse Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Vushtrrisë ka objektiva strategjike zhvillimi i bujqësisë, përmirësimi i klimës biznesore, atëherë preferohet që nga drejtime të ndryshme të propozohen nga një person nga tre objektivat strategjike.

### 4.2.8. Shërbime të përshtatshme online

Qendra për Përkrahjen e Biznesit gjithashtu do t'i ndihmojë bizneset dhe ndërmarrësit që u nevojitet ndihmë me procedurat ligjore: juridike, ekonomike në ministritë përkatëse, etj. Procedurat për fillimin dhe funksionimin e biznesit janë duke u thjeshtësuar, por duhet të thjeshtohen edhe më që mos të jenë aspak të komplikuara dhe të marrin kohë jashtë mase.

Qendra e  Biznesit ka hapësirë të përshtatshme që shërbimet e biznesit të përsosen dhe të jepen sipas kërkesave të komunitetit të biznesit, brenda kornizave ligjore. Kjo qendër do t'i mundësojë që shumicën e shërbimeve bizneset t'i marrin "One Stop Shop", online dhe përmes porosisë të cilën e bëjnë përmes telefonit. Këto shërbime do të duhej të arriheshin sidomos nga klientët e privilegjuar.

### 4.2.9. Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues

Komuna e Vushtrrisë është në ndërtim e sipër të zonës industriale me sipërfaqë rreth 14 hektarë. Përderisa kjo zonë është në proces, Komuna e Vushtrrisë, specifikisht Drejtoria për Zhvillim ekonomik dhe bujqësi mund të fillojë me ndërtimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin e zonës dhe tërheqjen e investitorëve.

Duke u bazuar në studimin e fizibiletit të zonës, filimisht mund të targetohen bizneset që do të alokohen në zonë. Është shumë e rëndësishme që bizneset ekzistuese të konsultohen fillimisht për nevojat dhe kapacitetet e tyre për vendosjen në zonë industriale duke pas parasysh që ato janë bartëse të nivelit të deritashëm i zhvillimit ekonomik lokal.

# 5. Plani i Aktiviteteve

## 5.1. Zbutja e ndikimit të pandemisë

**AKTIVITETET 2020, ZBUTJA E NDIKIMIT TË PANDEMISË**

| Aktiviteti | Periudha e implementimit | Organet Përgjegjëse | Veprimet | Kosto financiare | Burimet e financimit | Sqarime plotësuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rialokimi i mjeteve buxhetore për krijimin e mundësive për përgjigje emergjente në pandemi | Gusht, Shtator 2020 | Drejtoria e Buxhetit dhe Finacave & Drejtoria e Shëndetësisë | Identifikimi i tepricave buxhetore dhe Propozim/Vendim i | 200.000 euro | Buxheti i Komunës, kategoria Mallra dhe Shërbime | Të transferohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare |
| Përgjigje ndaj kërkesave emergjente të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë | Gusht, Shtator 2020 | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Administratës | Identifikimi i nevojave, vendosja e kritereve dhe identifikimi i nevojave të qytetarëve | 200.000 euro | Buxheti i Komunës, kategoria Mallra dhe Shërbime | Të hartohen shërbime standarde dhe të trajnohet stafi kompetent |
| Lirimet e përkohshme tatimore | Shtator, Tetor 2020 | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave | Vendim i Kuvendit Komunal | 100.000 euro | Të hyrat komunale | Krijohet komision për shqyrtimin e kërkesave për lirime tatimore |
| Rishikimi i Buxhetit të Komunës për 2020 | Tetor, 2020 | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave | Analiza e rregulloreve dhe identifikimi i nevojave të qytetarëve | Nuk ka kosto financiare | | Të transferohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare në kategorinë "Mallra dhe Shërbime" dhe "Subvencione dhe Transfere" |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Subvencionimi i bizneseve të komunës | Janar -Shtator 2021 | Kryetari & Administrata | Vendosja e kritereve nga komisioni | 200.000 euro | Buxheti i Komunës dhe burimet e jashtme | Komisioni duhet të menaxhoj për përgjgje të shpejta |
| Planifikimi i Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 në harmoni me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike. | Shtator, 2020 | Kryetari & Administrata Komunale | Të implementohen parimet e rekomanduara për përgjigje në pandemi | 18 milionë euro | Buxheti i Komunës | Të delegohet GLV për gjenerim të fondeve shtesë |

## 5.2. Plani i aktiviteteve: Rimëkëmbja Ekonomike

**AKTIVITETET 2025 - RIMËKËMBJA EKONOMIKE**

| Aktiviteti | Periudha e implementimit | Organet Përgjegjëse | Veprimet | Kosto financiare | Burimet e financimit | Sqarime plotësuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 1 -** Moratoriumi për destinimin e buxhetit për rimëkëmbje ekonomike | Janar-Mars, 2021 | Kryetari, Kuvendi dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave & Ministria e Finacave dhe Transfereve | Ngritja e kapaciteteve dhe aftësimi i stafit me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike | 2.14 milionë euro | Buxheti i Komunës | Moratoriumi përfshin ndalimin e investimeve kapitale dhe transferin e mjeteve buxhetore nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale" në kategorinë e Shpenzimeve "Subvencioni dhe Transfere" |
| **Masa 2** – Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit | Shkurt-Prill, 2021 | Kryetari, Kuvendi dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave & Ministria e Finacave dhe Transfereve | Hartimi i kushteve dhe kritereve, promovimi, krijimi i komisioneve profesionale | 30 milionë euro | Buxheti i Komunës, Qeveria e Kosovës, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore | Mjetet buxhetore komunale shfrytëzohen për kategoritë të cilat mbesin/përjashtohen nga Plani i Qeverisë së Kosovës |
| **Masa 3** – Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër | 2021-2025 | Kryetari & Administrata | Vendosja e kritereve dhe kushteve nga komisioni profesional | 500.000 euro | Të hyrat buxhetore | Drejtoria për Buxhet dhe Financa duhet të intensifikojë arkëtimet, dhe të krijojë kushte që të lirohen të gjithë ata që i kryejnë obligimet. Komisioni duhet të menaxhojë për përgjigje të shpejta |
| **Masa 4** – Rritja e punësimit, sipas zërave të masës | 2021-2025 | Kryetari, Kuvendi Komunal & Administrata Komunale | Të implementohen parimet e rekomanduara për përgjigje në pandemi | 4.08 milionë euro 0.81 milion.për vit | Buxheti i Komunës | Të shfrytëzohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare në kategorinë "Mallra dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Shërbime" dhe "Subvencioni dhe Transfere" |
| **Masa 5** – Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale | 2021-2025 | GLV dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Finacave & Drejtoria e Shëndetësisë | Të rritet fondi për bujqësi dhe të përfshihen edhe fermerët si qytetarë | 200.000 euro në vit | Buxheti i Komunës | Të shfrytëzohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare në kategorinë "Mallra dhe Shërbime" dhe "Subvencioni dhe Transfere" |
| **Masa 6** – Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike komunale | Qershor, 2021 | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Finacave | Të krijohet komision për vlerësimin e nevojave për operimin normal të NP komunale | 35.000 euro | Qeveria e Kosovës, Buxheti i Komunës ose Agjensionet Ndëkombëtare | Të mbahen nën presion NP për operim normal |
| **Masa 7** – Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo-formale | 2021-2025 | Kryetari&Administrata Komunale | Të implementohen parimet e rekomanduara për përgjigje në pandemi | 85.000 euro në vit | Buxheti i Komunës | Të shfrytëzohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare në kategorinë "Mallra dhe Shërbime" dhe "Subvencioni dhe Transfere" |
| **Masa 8** – Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi | 2021-2025 | Kryetari&Administrata Komunale | Të implementohen parimet e rekomanduara për përgjigje në pandemi | 250.000 euro | Buxheti i Komunës | Të shfrytëzohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare në kategorinë "Mallra dhe Shërbime" dhe "Subvencioni dhe Transfere" |
| **Masa 9** – Mbështetje për bashkatdhetarët përmes aktiviteteve të ndryshme promovuese dhe përmirësimit të shërbimeve | 2021-2025 | Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Diasporës | Të identifikohen nevojat e mërgimtarve | 75.000 euro | Komuna dhe Qeveria | Aktivitetet duhet të jenë pjesë e VicianumFest |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 10** – Racionalizimi i shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" destinimi i tyre në mbështetje të bizneseve | 2021-2025 | Kryetari, Administrata Komunale | Të identifikohen nevojat që mund të ofrohen si shërbime të gatshme | 1.1 milionë euro | Komuna | Kjo mbështetje të destinohet për programe online të menaxhimit, operimit, financave, shitjes, si dhe për marketing, brendim dhe standardizim. |

## 5.3. Plani i Aktiviteteve: Zhvillimi Qëndrueshëm Ekonomik Lokal – Projektet zhvillimore

**PLANI I AKTIVITETEVE PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE ZHVILLIMORE - Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik Komunal**

| Aktiviteti | Periudha e implementimit | Organet Përgjegjëse | Veprimet | Kosto financiare | Burimet e financimit | Sqarime plotësuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ngrohtorja e Qytetit | 2021-2024 | Kryetari & Administrata Komunale | Studimi teknik, paramasa dhe parallogaria | 12 milionë euro | PPP, Qeveria e Kosovës, Kredi Investive | Të ndërmerren të gjitha veprimet sipas rekomandimeve |
| Impianti i ujërave të zeza | 2021-2026 | Kryetari dhe Qeveria e Kosovës | Projekt propozimi dhe aplikimi si projekt strategjik | 15 milionë euro | Kredi në llogari të Qeverisë së Kosovës | Të regjistrohet si projekt strategjik dhe të hulumtohet për burimet e financimit/kreditimit |
| Gazifikimi | 2021-2030 | Kryetari & Administrata Komunale | Studimi teknik, paramasa dhe parallogaria | 6 milionë euro | PPP, Qeveria e Kosovës, Kredi Investive | Të ndërmerren të gjitha veprimet sipas rekomandimeve |
| Kredi e butë e Komunës për projekte të mëdha ekonomike/infrastrukturore | 2021 | Kryetari, Administrata Komunale dhe GLV | Të bëhet plani operativ për hulumtim dhe aplikimi përmes Qeverisë së Kosovës | S'ka kosto financiare | Fondet Ndërkomëtare | Të krijohet ekip komunal dhe GLV dhe të aftësohen për aplikim |
| Zona Ekonomike në | 2021-2023 | Kryetari, | Plani i Menaxhimit | 5 milionë euro | MTI, PPP dhe | GLV dhe QB të jenë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Banjskë | | Administrata Komunale dhe Qendra e Biznesit | dhe Studimi i Fizibilietit | | Komuna | agresive në gjenerim të fondeve |
| Ndërtimi i parkingjeve publike në Komunë | 2021-2022 | Kryetari, Administrata Komunale | Studimi teknik dhe fizibiliteti financiar | 3 milionë euro | PPP, Komuna, Qeveria e Kosvës | Të hulumtohet për biznese lokale që kanë kapacitete për investime dhe menaxhim të parkingjeve publike |
| Turizmi-Parku Rekreativ Taraxha | 2021-2024 | Administrata Komunale | Të hartohet Plani i Fizibilitetit dhe shpallet konkursi ndërkombëtar | 5 milionë euro | Komuna e Vushtrrisë, PPP, Donatorët | Të lejohet dhe jepet përparësi mundësia e menaxhimit të investitorëve lokalë |
| Turizmi malor në zonën e Shalës | 2021-2022 | Administrata Komunale | Studimi dhe Projekti | 1.5 milionë euro | Komuna e Vushtrrisë dhe burimet e jashtme | Të licencohen ciceronët dhe familjet nikoçire |
| Liqeni akumulues në Sllakovc | 2021-2031 | Kryetari, Qeveria e Kosovës | Studimi teknik | 15 milionë euro | Komuna dhe Qeveria e Kosovës | Të tërheqen kredidhënësit në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës |
| Shfrytëzimi i resurseve minerare | 2020-vazhdon | Kryetari, Qeveria e Kosovës | Identifikimi i resurseve minerale dhe tërheqja e investitorëve | 100.000 euro | Investitorë të huaj dhe PPP | Pas identifikimit të resurseve minerale të kontaktohen dhe tërheqen investitorë privatë |
| Zhvillimi i kapaciteteve në energji të ripërtëritshme | 2020-vazhdon | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural | Identifikimi i resurseve minerale dhe tërheqja e investitorëve | 200.000 euro | Investitorë të huaj dhe PPP | Pas identifikimit të resurseve minerale të kontaktohen dhe tërheqen investitorë privatë |
| Zona e lirë taksuse në Banjskë dhe lirimi nga taksat për ferma dhe agrobiznese | 2021 | Kryetari dhe Administrata Komunale | Rregullorja dhe Memorandumi | S'ka kosto financiare | | Të kërkohet aprovim nga institucionet përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Identifikimi i të papunëve sipas strukturës, kualifikimit dhe nevojave të tyre | 2021 | Administrata Komunale dhe GLV | Hartimi i pyetësorëve për të papunët | 10.000 euro | Buxheti i Komunës | Projekti identifikon strukturën dhe nevojat për kualifikime të të papunëve dhe aftësimin e tyre për treg të punës |
| Studimi i përfituesve të asistencës sociale | 2021 | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjës Sociale | Hartimi i pyetësorëve për të papunët | 25.000 euro | Buxheti i Komunës | Mundëson planifikimin e transferimit nga përfitues të asistencës në të punësuar |

## 5.4. Qasja programore për zhvillim ekonomik komunal

**AKTIVITETET PROGRAMORE – Qasja programore për zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik komunal**

| Aktiviteti | Periudha e implementimit | Organet Përgjegjëse | Veprimet | Kosto financiare | Burimet e financimit | Sqarime plotësuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vendosja e parimeve në menaxhimin e buxhetit të komunës | 2021-2025 | Kryetari & Administrata | Zbatimi i rekomandimeve për menaxhimin e buxhetit | | | Drejtoria e Finacave duhet t'i përmbahet rekomandimeve për ndarje buxhetore |
| Aktivizimi i GLV "Vicianarural" | Nëntor. 2020 | Administrata komunale& MTI | Të aplikohet në MTI | 50.000-200.000 euro | | GLV të përfshijë të gjitha grupet lokale që e përfaqësojnë sektorin privat dhe OJQ-të |
| Ngritja e kapaciteteve të GLV "Vicianarural" | Dhjetor, 2020 | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural | Të fillohet me hartimin e koncept projektit dhe të aplikohet për financim | 10.000 euro | Buxheti i Komunës ose Agjensionet Ndëkombëtare | GLV të ngris kapacitetet dhe të themelojë raporte me sektorin privat |
| Krijimi i Fondit për Zhvillim Ekonomik Lokal | Qershor, 2021 | Kryetari&Administrata Komunale | Të hartohet dhe miratohet rregullorja për | 100.000 euro secilin vit | Buxheti i Komunës dhe fondet aktive në | GLV dhe Administrata të aftësohet për gjenerimin e fondeve |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | fondin | | Kosovë | |
| Qendra e Biznesit | Korrik, 2021 | GLV dhe Drejtoria e Ekonomisë, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | Të lidhet marrëveshje ndërmjet QB dhe Kryetarit të Komunës për bashkëpunim dhe bashkëveprim | 5.000 euro | Buxheti i Komunës | Të mbahen takime të rregullta të QB dhe Kryetarit të Komunës |
| Qendra Komunale për Zhvillim Ekonomik | Qershor, 2021 | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Finacave | Të krijohet komision për vlerësimin e nevojave për operimin normal të NP komunale | 35.000 euro | Qeveria e Kosovës, Buxheti i Komunës ose Agjensionet Ndëkombëtare | Të mbahen nën presion NP për operim normal |
| Këshilli për Zhvillim Ekonomik Lokal | Prill, Maj, 2021 | Kryetari&Administrata Komunale | Të implementohen parimet e rekomanduara | 5.000 euro në secilin vit | Buxheti i Komunës | KZHEL është edhe organ konsultativ i Kryetarit të Komunës |
| Shërbime të përshtatshme “One Stop Shop”, online dhe telefon | Prill, Maj, 2021 | Administrata Komunale | Të implementohen parimet e rekomanduara | 10.000 euro | Buxheti i Komunës | Të shfrytëzohen mjetet buxhetore nga kodet të cilat konsiderohen më pak prioritare në kategorinë "Mallra dhe Shërbime" dhe "Subvencioni dhe Transfere" |
| Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës | 2021-2025 | GLV dhe Drejtoria e Ekonomisë, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | Të identifikohen kapacitetet komunale | 5 milionë euro | Komuna dhe Qeveria | GLV dhe QB të jenë agresive në gjenerim të fondeve |

/

# *VLERËSIMI I NDIKIMIT EKONOMIK TË PANDEMISË COVID-19 NË KOMUNËN E VUSHTRRISË*



Implementuar nga:

Vushtrri,
Dhjetor 2020

**PËRMBAJTJA,**


**1. HYRJE ........ 5**

**2. QËLLIMI I HULUMTIMIT ........ 6**

**3. METODOLOGJIA E PROJEKTIT ........ 6**

3.1. Pyetësori me ekonomi familjare ........ 7
3.2. Pyetësori me Biznese ........ 7

**4. PROFILI I KOMUNËS SË VUSHTRRISË ........ 9**

4.1. Struktura demografike ........ 9
4.2. Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit ........ 9
4.3. Struktura religjioze ........ 10
4.4. Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik ........ 10
4.5. Struktura e bizneseve aktive ........ 10
4.6. Buxheti Komunal ........ 15
*4.6.1. Buxheti Komunal për vitin 2020 ........ 15*
*4.6.2. Buxheti Komunal për vitin 2021 ........ 19*
*4.6.3. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në të hyrat komunale ........ 20*
*4.6.4. Ndikimi i pandemisë COVID -19 në realizimin e projekteve dhe investimeve kapitale ........ 24*
4.7. Masat e ndërmarra nga komuna anti COVID-19 ........ 25
4.8. Efektet e pandemisë COVID-19 në tregun lokal të punës ........ 28

**5. REZULTATET E HULUMTIMIT ........ 32**

5.1. Pyetësori me ekonomi familjare ........ 32
5.2. Pyetësori me biznese ........ 43

**KONKLUZIONE ........ 53**

**REKOMANDIME ........ 56**

**SHTOJCA 1. ........ 57**

## Lista e tabelave:

TABLE 1. SHPËRNDAJRA E MOSTRËS SIPAS ZONËS SË BANIMIT ....7
TABLE 2. SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS GJINISË....7
TABLE 3. SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS MOSHËS ....7
TABLE 4. NUMRI I BIZNESEVE TË REXHISTRUARA SIPAS SEKTORËVE DHE LLOGARIVE TATIMORE PERIUDHA MARS- SHTATOR 2020 - VUSHTRRI ....11
TABLE 5. NUMRI I BZINESEVE AKTIVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK, DIFERENCA (DHJETOR 2019 - SHTATOR 2020)....13
TABLE 6. NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA SIPAS SEKTORËVE DHE LLOGARIVE TATIMORE PERIUDHA DHJETOR 2019 - VUSHTRRI ....14
TABLE 7. VENDIMET E ASAMBLESË KOMUNALE VUSHTRRI, GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË MARS – SHTATOR 2020....16
TABLE 8. TABELA E TË HYRAVE KOMUNALE PËR PERIUDHËN JANAR – TETOR 2020 ....22
TABLE 9. PROJKETET E NDIKUARA NGA COVID-19, VUSHTRRI....24
TABLE 10. MASAT E NDËRMARRA NGA KOMUNA ANTI COVID-19 ....26
TABLE 11. NR.I TË PUNËSUARVE SIPAS SEKTORËVE PERIUDHA DHJETOR 2019 DHE MARS-SHTATOR 2020 - VUSHTRRI ....28
TABLE 12. NUMRI I PUNËTORËVE QË APLIKUAN PËR PËRFITIM MASA 14, KOMUNA E VUSHTRRISË ....30
TABLE 13. PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR (MUAJI, GJINIA), VUSHTRRI ....30

## Lista e figurave

FIGURE 1. NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE SIPAS SEKTOREVE EKONOMIK, I PARAQITUR NË %, VUSHTRRI....12
FIGURE 2. NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE SIPAS SEKTOREVE EKONOMIK, I PARAQITUR NË %, VUSHTRRI, DHJETOR 2019 ....14
FIGURE 3. NUMRI I TË PUNËSUARËVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK, (MARS - SHTATOR 2020), VUSHTRRI....29
FIGURE 4. NUMRI I TË PUNËSUARËVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK, (MARS - DHJETOR 2019), VUSHTRRI ....29
FIGURE 5. NUMRI I PUNËTORËVE QË APLIKUAN PËR PËRFITIM MASA 14, SIPAS GJINISË (%) VUSHTRRI ....30
FIGURE 6. PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR (MUAJI DHE GJINIA), VUSHTRRI ....31
FIGURE 7.PUNËKËRKUESIT SIPAS GJINISË NË %, SHTATOR 2020, VUSHTRRI....31
FIGURE 8.GJINIA E TË ANKETUARVE FIGURE 9.MOSHA E TË ANKETUARËVE ....32
FIGURE 10. VENDBANIMI I ANKETUESËVE ....32
FIGURE 11. NIVELI I ARSIMIMIT TË ANKETUESËVE FIGURE 12. NACIONALITETI I ANKETUESËVE....33
FIGURE 13. STATUSI CIVIL I TË ANKETUARËVE ....33
FIGURE 14. TË HYRAT E FAMILJES SË ANKETUESËVE....33
FIGURE 15. NDRYSHIMI I NIVELIT TË TË HYRAVE PAS FILLIMIT TË PANDEMISË COVID-19 ....34
FIGURE 16. NDRYSHIMI I NIVELIT TË TË HYRAVE PAS PANDEMISË COVID-19, SIPAS GJINISË ....34
FIGURE 17. STATUSI I PUNËSIMIT PARA PANDEMISË TË ANKETUESËVE....35
FIGURE 18. STATUSI I PUNËSIMIT PARA PANDEMISË (VENDBANIMI) ....36
FIGURE 19. PUNËSIMI SIPAS SEKTORIT DHE GJINISË....36
FIGURE 20. SEKTORI I PUNËSIMIT, SIPAS MOSHËS....37
FIGURE 21. VEPRIMTARIT EKONOMIKE TË PUNËSIMIT, SIPAS GJINISË ....37
FIGURE 22.NDIKIMI I PANDEMISË NË NDRYSHIMIN E ORAREVE TË PUNËS, SIPAS SEKTORIT ....38
FIGURE 23. NDIKIMI I PANDEMISË NË NDRYSHIMIN E ORAREVE TË PUNËS, SIPAS INDUSTRISË....38
FIGURE 24. PUSHIMET E DETYRUESHME PËR SHKAK TË PANDEMISË, SIPAS SEKTORI ....39
FIGURE 25. PRITJET PËR PUNËSIM PAS PËRFUNDIMIT TË PANDEMISË ....39
FIGURE 26. MËNYRA E MARRJES SË PAGËS PARA COVID-19, SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE....40
FIGURE 27. MËNYRA E MARRJES SË PAGËS PARA COVID-19, SIPAS GJINISË ....40
FIGURE 28. PAGESA E KONTRIBUTEVE PENSIONALE PARA COVID-19, SIPAS VEPRIMTARISË EKONOMIKE ....41
FIGURE 29. TREGU I PUNËSIMIT SIPAS VEPRIMTARISË EKONOMIKE ....41
FIGURE 30. SI PASOJË E COVID19, SI JANË PREKUR SECILA NGA BURIMET (TË HYRAT) E MËPARSHME PERSONALE?....42
FIGURE 31. A KENI MARRË NDONJË MBËSHTETJE FINANCIARE NGA NDONJË INSTITUCION PUBLIK DHE ORGANIZATË....42
FIGURE 32. STRUKTURA E BIZNESVE TË ANKETUARA SIPAS MADHËSISË FIGURE 33. VITET E OPERIMIT NË TREG ....43
FIGURE 34. STRUKTURA E BIZNESVE TË ANKETUARA SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE ....44
FIGURE 35. AJENI NDËRMARRJE EKSPORTUESE? ....44

FIGURE 36. SI E VLERËSONI NDIKIMIN E PANDEMISË NË BIZNESIN TUAJ? .... 44
FIGURE 37. SFIDAT E BIZNESEVE TË SHKAKTUARA NGA PANDEMIA COVID -19 .... 45
FIGURE 38. NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 SIPAS AKTIVITETI EKONOMIK .... 45
FIGURE 39. MBYLLJA E BIZNESEVE PAS MASAVE KUFIZUESE TË QEVERISË PËR PARANDALIMIN E COVID-19 .... 46
FIGURE 40. NDIKIMI I COVID-19 NË SHITJET E BIZNESEVE .... 46
FIGURE 41. PRITSHMËRITË E NDËRMARRJEVE MBI TË NDIKIMIN E PANDEMISË NË TË HYRA .... 46
FIGURE 42. PERIUDHA MAKSIMALE QË BIZNESI MUNDET TË OPEROJË PA HUMBJE NËSE VAZHDON PANDEMIA ? .... 47
FIGURE 43. A I KENI NDRYSHUAR PRAKTIKAT EKZISTUESE TE BIZNESIT PAS SHFAQJES SË PANDEMISË ? .... 47
FIGURE 44. A KANË NDRYSHUAR PLANET E INVESTIMEVE? .... 48
FIGURE 45. A KENI KREDI BANKARE? .... 48
FIGURE 46. MUNGESA E STAFIT SI REZULTAT I IZOLIMIT .... 48
FIGURE 47. A KENI MARRË MASA ANTI COVID-19 NË MBROTJE TË PUNËTORËVE TUAJ? .... 49
FIGURE 48. MASA PËR TË SIGURUAR VIJIMËSINË E BIZNESIT SIPAS SEKTORIT EKONOMIK .... 49
FIGURE 49. SA KANË NDIKUAR MASAT E NIVELIT QENDROR NË BIZNESIN TUAJ? .... 50
FIGURE 50. BIZNESET MË TË PREKURA SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE .... 50
FIGURE 51. ÇFARË NDIHME KENI NEVOJË PËR MBËSHTETJE NGA SHTETI? .... 52

# 1. Hyrje

Pandemia globale COVID-19 ka filluar në vitin 2019 dhe në Mars të vitit 2020 janë shfaqur rastet e para në Kosovë, nga ky virus ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme përtej ndikimit të pandemisë në jetën e njerëzve, pandemia ka ndikuar në shfaqjen një krizë ekonomike të madhe në nivel global.

Pandemia COVID-19 nuk është vetëm krizë mjekësore, por është krizë sociale dhe ekonomike sepse ka krijuar dhe probleme në zinxhirin e furnizimit, linjat ajrore, udhëtimet, luhatjet e tregjeve financiare, sektorin bankar dhe atë të sigurimeve dhe të të gjithë zinxhirit të shërbimeve në hoteleri-turizëm dhe pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik.

Pandemia e COVID-19 ka çuar në marrjen e masave të rrepta nga institucionet e Kosovës për të parandaluar përhapjen e virusit. Disa nga masat përfshijnë mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore publike dhe private, mbylljen graduale fizike të të gjitha ndërmarrjeve që merren me tregti me pakicë, të industrisë së ushqimit dhe shërbimeve, anulimin e të gjitha fluturimeve dhe mbylljen e të gjithë kufijve tokësorë. Kufizimi i qytetarëve në shkallë të gjerë, kufizimet e udhëtimit dhe masat për distancimin shoqëror dhe masat tjera restriktive për mbylljen e bizneseve shkaktojnë një rënie të ndjeshme të shpenzimeve të konsumatorit dhe biznesit. Masa e fundit e ndërmarrë është kufizimi i lëvizjes së qytetarëve dhe makinave private brenda afateve kohore specifike. Kjo për arsye, se konsumatorëve ju kufizohet lëvizja, bizneset humbasin të ardhurat dhe pushojnë punëtorët dhe nivelet e papunësisë rriten ndjeshëm. Dhe si pasojë e kësaj bizneset heqin dorë nga investimet dhe falimentimet e kompanive rriten, duke bërë presion të ndjeshëm në sistemin bankar dhe financiar. Prandaj, nevojitet një intervenim i qeverisë me një numër masash për të përkrahur bizneset për të tejkaluar krizën nga pandemia.

Institucionet qendrore kanë ndërmarrë masa për të mbështetur bizneset përfshirë propozimin e një pakoje të stimulimit fiskal për të mbështetur rimëkëmbjen e sektorëve privat dhe publik nga kriza por edhe Komuna e Vushtrrisë ka ndërmarrë masa në mbështetje të ekonomive familjare në nevojë dhe bizneseve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë.

Pandemia pritet të ketë ndikime dhe implikime të mëdha dhe varësisht nga kohëzgjatja e saj, implikimet sociale dhe ekonomike do të jenë domethënëse. Ndikimi do të varet nga rritja e papunësisë, varfëria e thelluar, humbja e të ardhurave, pasiguria e vendeve të punës, pabarazitë specifike të industrive, deri te ngecja në arsim e ngecja në përpjekjet për të zvogëluar hendekun gjinor në Kosovë. Vlerësimi i ndikimit ekonomik të COVID-19 është i rëndësishëm për të kuptuar ndikimin në ekonomi familjare dhe bizneset e komunës së Vushtrrisë.

# 2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të përcaktojë natyrën dhe nivelin e ndikimit të krizës COVID-19 dhe të identifikojë ndikimin e saj në ekonominë lokale të komunës së Vushtrrisë:

1. Në këtë hulumtim është aplikuar metoda e rastit, e cila është realizuar duke e dërguar linkun e formës elektronike të pyetësorit bizneseve dhe vizita në biznese sipas regjistrit të bizneseve aktive të Administratës Tatimore (ATK) dhe të dhënave të bizneseve aktive të dërguara nga komuna e Vushtrrisë ndëresa pyetësori me ekonomi familjare është realizuar në teren nga anketuesit e kompanisë në zona urbane dhe rurale.
2. Vlerësimi synon të analizojë ndikimin ekonomik të krizës duke përdorur një grup të dhënash primare nga pyetësori (1) me ekonomi familjare dhe (2) bizneset aktive në komunë, dhe në fund të bëjë rekomandime të qarta të bazuara nga të dhënat me evidencë nga tereni.
3. Gjetjet e këtij raporti do të identifikojnë nevojat dhe e bëjnë të mundshme mbështetjen e synuar nga autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe partnerët e zhvillimit, për të zbutur ndikimin e krizës dhe për të rritur adaptueshmërinë e qytetarëve.
4. Vlerësim për të mundësuar hartimin dhe vendosjen e masave reaguese për të zvogëluar ndikimin negativ për ekonomi familjare dhe bizneset. Gjetjet e hulumtimit do të mundësojnë që të kuptohet më mirë se kush u ndikua më tepër.
5. Do të bashkëpunojmë ngushtë me autroitetet lokale të komunës së Vushtrrisë për t'i ndihmuar përmes rekomandimeve në zhvillimin e kapaciteteve lokale për krijimin e ambientit më të favorshëm për biznes;
6. Do të nxjerrim rekomandime të qëndrueshme për zhvillimin e aktivitete që e ndihmojnë promovimin e zhvillimit socio – ekonomik të komunës së Vushtrrisë;

# 3. Metodologjia e projektit

M Holding ka realizuar pyetësor me ekonomi familjare dhe biznese, për të kuptuar më mirë ndikimin e COVID-19 në aktivitetet sociale dhe biznesore dhe për të analizuar masat që janë të nevojshme për daljen e bizneseve në komunën e Vushtrrisë nga kjo situatë. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë natyrën dhe nivelin e ndikimi të krizës COVID-19 dhe të identifikojë ndikimin e tij në ekonominë lokale të Komunës së Vushtrrisë. Gjetjet e studimit do të mundësojnë që të kuptohet më mirë se kush u ndikua më tepër, dhe nxjerrjen e rekomandimeve për qasje më të mirë dhe efektshme nga komuna e Vushtrrisë.

Në këtë raport do të bazohemi në skenar të mundshme lidhur me zgjatje të krizës për të matur efektet eventuale të COVID-19 në bizneset e Komunës së Vushtrrisë. Faza e pas pandemisë, pritet të jetë mjaft

sfiduese për bizneset dhe ekonomitë familjare dhe është e nevojshme që niveli qendror dhe lokal të marrin masa me kohë për t'i përballuar më lehtë sfidat me të cilat do të ballafaqohemi.

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësoreve i cili përfshin vlerësim të ndikimit të pandemisë në (1) ekonomitë familjare dhe (2) bizneset e Vushtrrisë.

## 3.1. Pyetësori me ekonomi familjare

Pyetësori për ekonomi familjare siguron të dhëna mbi disa tregues të rëndësishëm mbi përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshi të dhëna të *ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet, statustin e punësimit, qasjen në shërbimet bazike përgjatë pandemisë dhe sfidat me të cilat përballen të shkaktuara nga pandemia COVID-19.*

Të dhënat janë mbledhur përmes anketimit direkt me intervista në zona urbane dhe rurale të Komunës së Vushtrrisë, duke përfshirë 458 ekonomi familjare, të zgjedhura sipas metodës së rastit dhe në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë në Excel.

TABLE 1. SHPËRNDAJRA E MOSTRËS SIPAS ZONËS SË BANIMIT

| Zona | Përqindja (%) | Intervista |
|---:|:---:|:---:|
| **Rurale** | 42% | 192 |
| **Urbane** | 58% | 266 |
| **Total:** | 100 % | 458 |

TABLE 2. SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS GJINISË

| Gjinia | Përqindja (%) | Intervista |
|---:|:---:|:---:|
| **Femra** | 50% | 229 |
| **Mashkuj** | 50% | 229 |
| **Total:** | 100% | 458 |

TABLE 3. SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS MOSHËS

| Mosha | Përqindja (%) | Intervista |
|---:|:---:|:---:|
| **18-24** | 17% | 79 |
| **25-34** | 30% | 137 |
| **35-44** | 19% | 87 |
| **45-54** | 16% | 73 |
| **55-64** | 12% | 55 |
| **65+** | 6% | 27 |
| **Total** | 100% | 458 |

## 3.2. Pyetësori me Biznese

Hulumtimi për biznese është realizuar përmes pyetësorit në dy forma *(online dhe intervistimit direkt përmes vizitve tek bizneset).* Kompania ka M-Holding ka mbledhur të gjitha shënimet prej burimeve të ndryshme lidhur me numrin e bizneseve aktive duke filluar nga (*Komuna përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ARBK dhe Administrata Tatimore e Kosovës – ATK).* Të gjitha

këto biznese janë informuar në formë elektronike përmes e-maili lidhur me qëllimin e studimit dhe ju kemi dërguar linkun e pyetësorit për plotësim përmes platformës (google forms) dhe i kemi kontaktuar me telefon në bazë të kontakteve zyrtare lidhur me planifikimin e vizitave për intervistim direkt.
Pyetësori i bizneseve përmban elemente lidhur me: *Reagimin e bizneseve në këtë situatë të panjohur dhe me çfarë sfidash po përballen për sa i përket likuiditetit, mungesës së prodhimit, mungesës së klientëve, rritjes së kostove, etj. Cilat janë vlerësimet e tyre mbi ndikimin e COVID-19 në xhiron vjetore të biznesit të tyre? Si mundet niveli qendror dhe lokale të ndihmojnë duke patur parasysh nevojat specifike gjatë kësaj periudhe.*

Nga Komuna e Vushtrrisë e kemi pranuar regjistrin e biznesve të totale sipas (ARBK, gjithsejt 4,468) por këtë listë e kemi përditësuar në bazë të regjistrit të bizneseve aktive të deklauar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe ka rezultar në bazë të ATK-së se në komunën e Vushtrrisë janë biznese aktive/tatim pagues Mars - Shtator 2020, gjithsejt 622 biznese dhe bazuar në shkallën e përqindjes së informalitetit i cili është rreth 30% prezent në nivel vendi duke u bazuar në raporet e (BB, FMN dhe institucione tjera kredibile) orientimisht munden të jenë rreth apo maksimalisht 900 biznese.
Mostra prej 184 biznese është përfaqësuese dhe kemi përzgjedh biznese të sektorëve dhe veprimtarive të ndryshme për të gjeneruar rezultate të sakta dhe përmbajtësore lidhur me gjendjen reale të krijuar nga pandemia COVID-19.

# 4. Profili i Komunës së Vushtrrisë

## 4.1. Struktura demografike

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që kjo komunë i ka pasur rreth 69 mijë banorë, ndërkaq, deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për më shumë 5 mijë banorë, domethënë tani ka rreth 64 mijë. Sipas përkatësisë etnike, 98.5% të banorëve të Vushtrrisë janë shqiptarë, 0.55% serbë, 0.4% turq dhe 0.55% u përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 51.5% meshkuj dhe 48.5% femra.[1]




## 4.2. Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 33 janë analfabetë, 99 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 485 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 349.6 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 66.4 kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.[2] Komuna e Vushtrrisë i ka gjithsej 41 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme me një raport prej 1.53 shkollave në 1000 banorë të moshës deri në 19-vjet. Në 36 institucione arsimore me 809 mësimdhënës mësimi zhvillohet me Kurrikulë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës,[3] ndërsa me kurrikulë të Serbisë mësimi zhvillohet në pesë institucione me 70 mësimdhënës dhe personel administrativ.[4] Në komunën e Vushtrrisë janë të regjistruara 27 klube sportive, tre klube-shoqata kulturore, kurse sa i përket numrit të objekteve kulturore sekulare, teatrove, kinemave dhe biblotekave në këtë komunë janë gjithsej 10.[5]

[1] Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsise-2019
[2] Popullsia e moshës 10-vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.
[3] Statisktikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf.
[4] Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Vushtrri/ Vučitrn (2018), https://www.osce.org/kosovo/13134?download=true.
[5] Të dhëna nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vushtrrisë, 03.05.2019.

## 4.3. Struktura religjioze

Sa i përket strukturës religjioze, 99.2% e popullsisë së Komunës së Vushtrrisë janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, të besimit ortodoks janë deklaruar 0.55%, dhe 0.25% të të tjerëve përfshijnë personat e përkatësive tjera fetare, personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen. Në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë funksionale 44 xhami, nëntë prej të cilave janë në qytet dhe 35 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve Islam është 49.[6] Këtu duhet theksuar që pas përfundimit të konfliktit/luftës në vitin 1999, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve islamë kanë hyrë 34 xhami të reja.[7] Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.8 xhami në 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.33 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku një është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e femrave.[8] Besimtarët ortodoksë i kanë tre kisha ortodokse, 41 ndërkaq, besimtarët protestantë në shërbimin e tyre kanë një klerik protestant, mirëpo nuk e kanë asnjë kishë protestante.[9]

## 4.4. Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Vushtrrisë tregojnë se nga 50 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 44.2% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 44.3% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 55.8% e popullsisë mbi 15 vjet.[10] Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Ndërkaq, sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 34.4% prej tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 45.5% kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të përmendet që 7% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërsa 7.6% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.[11]

## 4.5. Struktura e bizneseve aktive

Sipas ARBK-së në MTI dhe Komunës së Vushtrrisë, numri i NVM-ve të regjistruara deri në Shtator 2020 është 4,468, të cilat punësojnë 4,698 punëtorë, ose 75 % të totalit të të punësuarve në komunën e Vushtrrisë janë në sektorin privat ndërsa 1,587 apo 25 % të punësuar janë në sektorin publik. Numri i bizneseve aktive është 622 (sipas ATK-së, TM3 2020) apo 15 % në raport me numrin e bizneseve të regjistruara në total prej 4,468 biznese.

[6] Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018
[7] Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Vushtrri/ Vučitrn (2018), https://www.osce.org/kosovo/13134?download=true.
[8] Të dhëna nga Bashëesia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.
[9] Të dhëna nga Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.
[10] Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave te Kosoves.
[11] Popullsia sipas burimit kryesor te jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Madhësia e NVM-ve në Kosovë është e definuar me Ligjin nr. 2005/02-L5 dhe me Ligjin nr. 03/L-031 për mbështetjen e e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Numri i të punësuarve është kriteri i vetëm që përdoret për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas madhësisë në Kosovë. Kjo paraqet dallimin me vendet e BEsë, ku përveç numrit të punëtorëve, merret parasysh edhe qarkullimi vjetor. Në tabelë është dhënë regjistri i bizneseve aktive dhe sipas llogarive tatimore të regjistruara në Komunën e Vushtrrisë, sipas sektoreve ekonomik:

**TABLE 4. NUMRI I BIZNESEVE TË AKTIVE SIPAS SEKTORËVE DHE LLOGARIVE TATIMORE PERIUDHA MARS- SHTATOR 2020 - VUSHTRRI**

| Sektorët Ekonomik | [TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar | [WM] Pasqyrë e mbajtjes në burim | [CM] Pasqyra e kontributeve për | [CI] Formulari i raportit tremuj | [WR]INTEREST, DIVIDENT, ROYALTY, | [IS] Kestet tremujore për Biznes | [IR] Tatimi mbi Qiratë dhe Pasur | [QS] Kestet tremujore per Korpor | [CD] Deklarata vjetore e tatimit | [GJ] Ndeshkimet manuale (Gjobat) | Total | Totali % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi | | 18 | 18 | 16 | | 16 | | 2 | | | 70 | 11% |
| Industria përpunuese | 4 | 17 | 18 | 6 | 2 | 6 | | 8 | 3 | | 64 | 10% |
| Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave | | 2 | 2 | 2 | | 2 | | | | | 8 | 1% |
| Ndërtimtaria | 4 | 24 | 24 | 7 | | 7 | | 12 | 5 | | 83 | 13% |
| Tregtia me shumice dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 18 | 48 | 48 | 8 | 5 | 8 | | 24 | 17 | 1 | 177 | 28% |
| Transporti dhe magazinimi | 4 | 6 | 6 | 1 | 1 | 1 | | 3 | 3 | | 25 | 4% |
| Akomodimi dhe shërbimi ushqimor | 1 | 12 | 12 | 5 | 3 | 5 | | 4 | 3 | | 45 | 7% |
| Informimi dhe komunikimi | | 1 | 1 | 1 | | 1 | | | | | 4 | 1% |
| Aktivitetet e patundshmëris | 1 | 3 | 3 | 2 | | 2 | 1 | 1 | | | 13 | 2% |
| Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike | | 9 | 9 | 5 | | 5 | | 4 | | | 32 | 5% |
| Shërbimet administrative dhe mbështetëse | 2 | 11 | 11 | 2 | 3 | 2 | | 6 | 3 | | 40 | 6% |
| Arsimi | | 2 | 2 | | | | | 2 | | | 6 | 1% |
| Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale | | 4 | 4 | 3 | | 3 | | | 1 | | 15 | 2% |
| Artet, Argëtimi dhe rekreacioni | | 2 | 2 | | | | | 2 | | | 6 | 1% |
| Aktivitetet e tjera shërbyese | 1 | 6 | 6 | 4 | 1 | 4 | | 1 | 8 | | 31 | 5% |
| Person Fizik | | 1 | 1 | 1 | | | | | | | 3 | 0% |
| **Total** | 35 | 166 | 167 | 63 | 15 | 62 | 1 | 69 | 43 | 1 | 622 | 100% |

**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës, Dt. 16.11.2020

FIGURE 1. NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE SIPAS SEKTOREVE EKONOMIK, I PARAQITUR NË %, VUSHTRRI




**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Mars – Shtator 2020.

Masat kufizuese të nivelit qendror për mbrojtje nga pandemia COVID-19 kanë ndikuar që bizneset të pësojnë pasoja dhe dëme materiale deri te mbyllja, pauzimi dhe largimi i punëtorëve. Në Dhjetor (TM4) të vitit 2020 sipas Administratës Tatimor të Kosovës (ATK) në komunën e Vushtrrisë kanë qenë aktive 953 biznese, shih (tabela 6), por vërehet se në periudhën Mars – Shtator 2020 është zvogëluar dukshëm numri i bizneseve aktive apo tatim paguese në 331 biznese joaktive apo 35 % janë më pak aktive në raport me numrin e biznesve aktive në dhjetor 2019, shih (Tabela 6). Dhe kjo pasqyre e gjendjes është alarmante dhe urgjentisht duhet të përgatitet një pako e mbështetje financiare për biznese nga niveli qendror dhe lokal për të ndërmarr masa të nevojshme në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare së bizneseve për tejkalimin e situatatës së krijuar nga COVID-19.

Nga të dhënat vërehet se pandemia ka ndikuar më së shumti në këta sektor ekonomik: *Bujqesia; Pylltaria dhe Peshkimi sektori i cili është një ndër shtyllat kryesore ekonomike të Vushtrrisë është zvogëluar për (15%), Industria përpunuese është zvogëluar për (55%), Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave është rritur për (62 %), Ndërtimtaria është zvogëluar për (16%), Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motocikletave është zvogëluar për (18%), Transporti dhe magazinimi është rritur për (32%), Akomodimi dhe shërbimi ushqimor është zvogëluar për (31%), Informimi dhe komunikimi është zvogëluar për (93%), Aktivitetet financiare dhe te sigurimit janë zvogëluar (100%), Aktivitetet e patundshmerise janë rritur (650%), Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike janë zvogëluar (35%), Shërbimet administrative dhe mbështetëse janë zvogëluar (9%), Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshem janë zvogëluar (100%), Arsimi është zvogëluar për (57%), Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës*

*sociale janë zvogëluar për (40%), Artet, Argëtimi dhe rekreacioni janë zvogëluar për (79%), Aktivitetet e tjera shërbyese janë zvogëluar për (68%), Persona fizik janë zvogëluar për (40%).*

**TABLE 5. NUMRI I BZINESEVE AKTIVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK, DIFERENCA (DHJETOR 2019 - SHTATOR 2020)**

| Sektorët Ekonomik | Total Dhjetor 2019 | Total Shtator 2020 | Diferenca (TM4)Dhjetor 2019 – (TM3)Shtator 2020 | % Zogëluar | % rritur |
|---|---|---|---|---|---|
| Bujqësia;Pylltaria dhe Peshkimi | 82 | 70 | 12 | 15% | |
| Industria përpunuese | 143 | 64 | 79 | 55% | |
| Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave | 3 | 8 | +5 | | 63% |
| Ndërtimtaria | 99 | 83 | 16 | 16% | |
| Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motocikletave | 215 | 177 | 38 | 18% | |
| Transporti dhe magazinimi | 17 | 25 | +8 | | 32% |
| Akomodimi dhe shërbimi ushqimor | 65 | 45 | 20 | 31% | |
| Informimi dhe komunikimi | 56 | 4 | 52 | 93% | |
| Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 3 | 0 | 3 | 100% | |
| Aktivitetet e patundshmëris | 2 | 13 | +11 | | 650% |
| Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike | 49 | 32 | 17 | 35% | |
| Shërbimet administrative dhe mbështetëse | 44 | 40 | 4 | 9% | |
| Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm | 4 | 0 | 4 | 100% | |
| Arsimi | 14 | 6 | 8 | 57% | |
| Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale | 25 | 15 | 10 | 40% | |
| Artet, Argëtimi dhe rekreacioni | 29 | 6 | 23 | 79% | |
| Aktivitetet e tjera shërbyese | 98 | 31 | 67 | 68% | |
| Persona Fizik | 5 | 3 | 2 | 40% | |
| **Total** | **953** | **622** | **-331 (35%)** | | |

**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), përpunuar nga M-Holding

TABLE 6. NUMRI I BIZNESEVE TË AKTIVE SIPAS SEKTORËVE DHE LLOGARIVE TATIMORE PERIUDHA DHJETOR 2019 - VUSHTRRI

| Sektorët Ekonomik | [TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar | [WM] Pasqyrë e mbajtjes në burim | [CM] Pasqyra e kontributeve për | [CI] Formulari i raportit tremuj | [WR]INTEREST, DIVIDENT, ROYALTY, | [IS] Kestet tremujore për Biznes | [QS] Kestet tremujore per Korpor | [CD] Deklarata vjetore e tatimit | [PD] Deklarata vjetore e tatimit | [GJ] Ndeshkimet manuale (Gjobat) | Total | Total % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi | 3 | 20 | 20 | 18 | | 17 | 3 | | 1 | | 82 | 9% |
| Industria përpunuese | 3 | 36 | 36 | 23 | 6 | 23 | 10 | 5 | | 1 | 143 | 15% |
| Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave | | 1 | 1 | | | | 1 | | | | 3 | 0% |
| Ndërtimtaria | 9 | 27 | 27 | 8 | | 8 | 9 | 11 | | | 99 | 10% |
| Tregtia me shumicë dhe pakiceë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 17 | 51 | 51 | 25 | 12 | 25 | 16 | 16 | | 2 | 215 | 23% |
| Transporti dhe magazinimi | 1 | 3 | 3 | 3 | | 3 | 1 | 2 | | 1 | 17 | 2% |
| Akomodimi dhe shërbimi ushqimor | 1 | 15 | 15 | 6 | 5 | 6 | 4 | 6 | | 7 | 65 | 7% |
| Informimi dhe komunikimi | 2 | 14 | 14 | 6 | 3 | 6 | 9 | 2 | | | 56 | 6% |
| Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | | 1 | 1 | | | | | 1 | | | 3 | 0% |
| Aktivitetet e patundshmëris | | | | 1 | | 1 | | | | | 2 | 0% |
| Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike | 2 | 12 | 12 | 6 | 4 | 4 | 5 | 2 | 2 | | 49 | 5% |
| Sherbimet administrative dhe mbeshtetese | | 13 | 13 | 5 | | 5 | 8 | | | | 44 | 5% |
| Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm | | 1 | 1 | 1 | | 1 | | | | | 4 | 0% |
| Arsimi | | 4 | 4 | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 | | | 14 | 1% |
| Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale | | 7 | 7 | 4 | | 4 | 2 | 1 | | | 25 | 3% |
| Artet, Argëtimi dhe rekreacioni | 1 | 7 | 7 | 3 | 4 | 3 | 2 | 2 | | | 29 | 3% |
| Aktivitetet e tjera shërbyese | | 20 | 20 | 17 | 5 | 15 | | 17 | 2 | 2 | 98 | 10% |
| Persona Fizik | | | | | 1 | | | | 4 | | 5 | 1% |
| Total | 39 | 232 | 232 | 127 | 41 | 122 | 72 | 66 | 9 | 13 | 953 | 100% |

**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

FIGURE 2. NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE SIPAS SEKTOREVE EKONOMIK, I PARAQITUR NË %, VUSHTRRI, DHJETOR 2019



# 4.6. Buxheti Komunal

## 4.6.1. Buxheti Komunal për vitin 2020

Për vitin fiskal 2020 Komuna e Vushtrrisë e ka një buxhet prej rreth 19,939,965.00 milion €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë rreth 90% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 10% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që përbën rreth 57 % të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 16 %, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 24 % e shumës totale.[12]







Por, prej muajit mars 2020 Kosova, përkatësisht edhe komuna e Vushtrrisë është sfiduar nga pandemia globale COVID-19 dhe kjo ka reflektuar në të hyrat komunale si dhe në implementimin e planifikimit buxhetor. Komuna e Vushtrrisë ka ndërmarr hapa për plotësim/ndryshime të buxhetit duke rilokuar mjete me destinim për t'u ballafaquar me pandemin globale COVID-19.

Por, nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson mjaftueshëm këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 28.1% të popullatës së përgjithshme të Komunës së Vushtrrisë. Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 3 % (570,176.00 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, duke e paraqitur 52% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 36% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 16 % për shpenzime kapitale.

Hapat e ndërmarr nga komuna e Vushtrrisë përmes asamblesë komunale për plotësim ndryshime të buxhetit janë si në vijim të paraqitura në mënyrë deskriptive dhe kronologjike, shih *(Tabela 7)*.

[12] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/06/Buxheti-i-Komunes-Plani-i-ndarjeve-buxhetore-te-shpenzimeve-totale-te-komunes-per-vitin-2020.pdf

TABLE 7. VENDIMET E ASAMBLESË KOMUNALE VUSHTRRI, GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË MARS – SHTATOR 2020

| Nr. | Vendimi i Asamblesë | Lloji i vendimit | Përshkrimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nr. 64/20, Dt. 26.03.2020[13] | Vendim për rialokimin-transferimin e mjeteve financiare të komunës | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 47826 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 300,000.00 Euro. | € 30,000.00 |
| | | | Nga fondi (21), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 47826 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 20,000.00 Euro. | € 20,000.00 |
| | | | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 90226 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 30,000.00 Euro. | € 30,000.00 |
| | | | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 47838 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 10,000.00 Euro. | € 10,000.00 |
| | | | Nga fondi (21), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 47838 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 40,000.00 Euro. | € 40,000.00 |
| | | | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare nga Progami Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66425 në programin Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 49579 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 20,000.00 Euro. | € 20,000.00 |
| | | | Nga fondi (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare nga Progami Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66425 në programin Infrastruktura publike me kod 18184 nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit 41424 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë 50,000.00 Euro. | € 50,000.00 |
| | | | Transferohen në kategorin Mallra dhe Shërbime, Total: | € 200,000.00 |

[13] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-nga-mbledhja-urgjente-mars-2020.pdf

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Nr. 65/20, Dt. 26.03.2020 | Vendim për financimin e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 *(nga kategoria Mallra dhe Shërbime)* | Blerjen e mjeteve mbrojtëse, barnave dhe pajisjeve të nevojshme shëndetësore për7 punëtorët shëndetësorë, administratës së komunës, mjeteve dezinfektuese dhe çdo gjë tjetër që do të jetë e nevojshme për parandalim dhe mbrojtje të kësaj sëmundje.<br>Blerjen e pakove sociale (pako ushqimore dhe higjienike) për familjet në gjendje të rëndë sociale, në vlerë prej 50.00 Euro. | € 200,000.00 |
| Nr. | Vendimi i Asamblesë | Lloji i vendimit | Përshkrimi | Vlera |
| 1 | Nr. 68/20, Dt. 23.04.2020[14] | Vendim për inicimin e procedurës për zhvillimin e studimit të efektit të pandemisë COVID-19 | Me këtë vendim, inicohet procedura për studim mbi ndikimin e virusit COVID-19 në ekonominë lokale, formale e jo formale të komunës së Vushtrrisë dhe masat për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë së virusit COVID-19. | |
| 2 | Nr. 69/20, Dt. 23.04.2020[15] | Vendim për lirim nga pagesa e tarifës për çerdhen e fëmijëve "Foleja" Vushtrri | 1. Me këtë vendim, lirohen nga pagesa e tarifës komunale për prindërit e Komunës së Vushtrrisë për shërbimet e edukimit për fëmijët e tyre të cilat ofrohen në Çerdhen e Fëmijëve "Foleja" në Vushtrri.<br>2. Lirimi nga pagesa bëhet prej dt. 01.03.2020 deri në fillim të vitit të ri shkollor 2020 - 2021. | |
| 3 | Nr. 71/20, Dt.23.04.2020 | Vendim për shtyrjen e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë | 1. Me këtë vendim lejohet shtyrja e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.<br>2. Afati për shtyrjen e pagesës së këstit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë. | |
| 4 | Nr. 72/20, Dt.23.04.2020 | Vendim për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike | 1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe hapësirave publike në komunën e Vushtrrisë.<br>2. Lirimi nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë do të zgjasë nga data 1 mars deri më 31 dhjetor 2020. | |
| Nr. | Vendimi i Asamblesë | Lloji i vendimit | Përshkrimi | Vlera |
| 1 | Nr. 92/20, Dt. 28.05.2020[16] | Vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina | 1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale të Komunës së Vushtrrisë.<br>2. Lirimi nga pagesa bëhet prej dt. 01.03.2020 deri më 31.12.2020. | |
| Nr. | Vendimi i Asamblesë | Lloji i vendimit | Përshkrimi | Vlera |

[14] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-e-mbledhjees-s%C3%AB-jasht%C3%ABzakonshme.pdf
[16] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/07/Vendimet-e-muajit-maj-2020.pdf

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nr. 101/20, Dt. 10.06.2020[17] | Vendim për rishikimin e buxhetit të komunës së Vushtrrisë për vitin 2020 | 1. Nga fondi (10), Nga kategoria Paga dhe Meditje bëhet transferimi i mjeteve financiare në kategorin Mallra dhe Shërbime në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184 , Kodi (00099) COVID-19 | € 200,000.00 |
| 2 | | | 2. Mjetet financiare nga fondi 10, kategoria investime kapitale, programi 47024 - Bujqësia, projekti me kod 49549 "Projektet në bujqësi me bashkëfinancim" shuma e mjeteve financiare (100,000.00 Euro) baren në fondin njejtë në kategorin Mallra dhe Shërbime, në programin Infrastruktura Publike, me kod 18184 COVID-19 (00099) | € 100,000.00 |
| **Nr.** | **Vendimi i Asamblesë** | **Lloji i vendimit** | **Përshkrimi** | **Vlera** |
| 1 | Nr. 149/20, Dt. 10.09.2020[18] | Vendim për transferin e fondit rezervë të komunës | 1. Transferim I mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime bëhet si në vijim:<br>Nga programet: 1.1.1. Arsimi parafillor (92670) shuma 561, 29 Euro dhe 1.1.2. Arsim I mesëm (94890) shuma 24,438.71 Euro<br>Transferohen në programin:<br>1.2.1. Infrastruktura publike (180) nen-programi (18184) në shumën 25,000 Euro (fondi COVID-10, kodi 00099). | € 25,000.00 |
| **Nr.** | | **Lloji i vendimit** | **Përshkrimi** | **Vlera** |
| 1 | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural[19] | Ka shpall thirrje per mbeshtetje financiare te bizneseve | Mbeshtetja eshte planifikuar për operator ekonomike (zejtar dhe shërbyese)<br>Bizneset Mikro perfitojne nga 300 - 500 Euro<br>Bizneset e Vogla perfitojne 500 - 1900 Euro | € 250,000.00 |

Të gjitha këto plotësim ndryshime të buxhetit Komunal janë bërë harmoni me bazën ligjore dhe të aprovuara në Kuvendin Komunal, arsyeja e plotësim ndryshimit të buxhetit është bërë për t'u përballuar me pandeminë globale COVID-19 më lehtë dhe t'ju dalin në ndihmë qytetarëve dhe komunitetit të biznesit në komunën e Vushtrrisë.

[17] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/06/Vendim-nga-mbledhja-urgjente-e-KK-s%C3%AB-10-qershor-2020.pdf
[18] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/09/Vendimet-nga-mbledhja-e-jashtzakonshme-shtator-2020.pdf
[19] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/10/ftese-per-aplikim-2020.pdf

## 4.6.2. Buxheti Komunal për vitin 2021

Për vitin fiskal 2021 Komuna e Vushtrrisë e ka miratuar buxhetin më 24.09.2020 në vlerë prej 18,878,128.00 milion (€). Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë rreth 90% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 10% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që përbën rreth 57 % të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 17 %, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 20 % e shumës totale.[20]







Në vitin 2021 është rritur për 51% buxheti në kategorin “Subvencione dhe transfere” në vlerë prej 600,000.00 €, e krahasuar me vitin e kaluar që ishte në vlerë prej 292,914.00 €. Ndërsa kategoria “Shpenzimet kapitale” janë ulur për 20% në vlere prej 3,765,124.00 € në vitin 2021 krahasur me vitin 2020 sa ishte 4,726,391.00 €.

Për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson mjaftueshëm këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 28.1% të popullatës së përgjithshme të Komunës së Vushtrrisë. Në buxhetin e vitit 2021, vetëm 3 % (567,648.00 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, duke e paraqitur 55% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 39% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 16 % për shpenzime kapitale.

Ekspertët e kompanisë M-Holding kanë dorëzuar rekomandime profesionale dhe të qëndrushme lidhur me buxhetin e planifikuar 2021. Të gjitha rekomandimet janë konsideruar të vlefshme dhe e kanë ndihmuar komunën për planifikim dhe orientim të buxhetit duke i kategorizuar prioritetet dhe janë inkorporuar në buxhetin e planifikuar për vitin 2021. Rekomandimet e ekspertëve të M-Holding janë (Shtojca 1).

[20] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/10/Vendimet-e-kuvendit-24-shtator-2020.pdf

### 4.6.3. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në të hyrat komunale

Pandemia COVID-19 ka prodhuar efekte negative në rënien e nivelit të hyrave në disa kategori të planifikuara të të hyrave në Komunën e Vushtrrisë. Komuna e Vushtrrisë në buxhetin Komunal të aprovuar për vitin 2020, të hyrat komunale të planifikuar janë 2,035,660.00 Euro. Ndër të hyrat kryesore janë: *tatimi në pronë, taksat komunale, lejet për ndërtim.*

Gjatë periudhës së pandemisë Komuna e Vushtrrisë përmes asamblesë komunale ka nxjerrë vendime, si në vijim:

1. Vendim për lirim nga pagesa e tarifës për çerdhen e fëmijëve "Foleja" Vushtrri. Lirimi nga pagesa bëhet prej dt. 01.03.2020 deri më 31.12.2020. Nga ky vendim janë liruar qyetatarët në vlerë prej 28,125.00 Euro.
2. Vendim për shtyrjen e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë. Afati për shtyrjen e pagesës së këstit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë.
3. Vendim për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike. Lirimi nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë do të zgjasë nga data 1 mars deri më 31 dhjetor 2020. Nga ky vendim janë liruar shfrytëzuesit në vlerë prej 31,250.00 Euro.
4. Vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale të Komunës së Vushtrrisë. Lirimi nga pagesa bëhet prej dt. 01.03.2020 deri më 31.12.2020.
   Nga ky vendim janë liruar 1,300 familjare me asistencë sociale në vlerë prej 54,990.00 Euro.

Përgjatë periudhes së pandemisë COVID-19, Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) ka marr vendim për heqje të obligimit të pagesës së tatimit në pronë për regjistrimin e automjeteve në Komunë. Vendimi i Ministris (MFT) përfshin periudhën 15 Mars deri më 31 qershor 2020, i cili specifikon që automjetet të regjistrohen vetëm me pagesën e polisës së sigurimit[21] dhe kjo ka evituar pagesën e tatimit në pronë, e cila është njëra prej të hyrave kryesore për komunën e Vushtrrisë. Por Komuna e Vushtrrisë është treguar efikase në realizimin e planifikimit të hyrave të Tatimit në Pronë, ku gjithsejt ishin të planifikuara për periudhë Janar – Tetor ishin 672,723.33 € dhe janë realizuar 596,152.19 € apo 89% e të hyrave të planifikuara.

[21] Ministria e Financave dhe Transfereve, publikimi: https://tatimineprone-rks.org/2020/03/20/postponement-of-dates-to-file-complaints-and-pay-first-installment/

E hyrë tjetër për Komunën janë dënimet e shqiptuara nga policia në rrugët lokale për shkelësit e rregullave në komunikacion. Pas ndërmarrjes së masave për parandalimin e pandemisë COVID-19, është kufizuar qarkullimi dhe numri i gjobave të shqiptuara ka pësuar rënie dhe kjo ka ndikuar edhe në rënien e të hyrave. Përveç kësaj, as gjykatat nuk janë marrë me lëndë administrative ose civile (si rastet e parashtruara nga inspekcioni komunal ose policia) që kanë pasur natyrë kontestimore e një pjesë e të cilave zakonisht përfundojnë në favor të të hyrave komunale.[22]

Ndërsa komuna e Vushtrrisë ka tejkaluar planin e të hyrave nga *ndërrimi ose destinimi i tokës*, nga gjithsejt të planifikuara 16,666.67 Euro ka arritur ti inkasojë 109,816.22 Euro apo 659% më shumë se të hyrat e planifikuara.

Edhe pse thuajse të gjithë sektorët prej nga inkason të hyra komuna janë të prekura nga masat e ndërmarra për parandalimin e pandemisë COVID-19, komuna ka arritur të realizojë inkasimin e të hyrave komunale në mënyrë efikase duke tejkaluar të hyrat e planifikuara për 4% për periudhën Janar – Tetor 2020.

[22] https://www.gjyqesori-rks.org/2020/03/24/njoftim-17/

TABLE 8. TABELA E TË HYRAVE KOMUNALE PËR PERIUDHËN JANAR – TETOR 2020

| Drejtoritë | Nr. | Lloji i të hyrave | Planifikimi mujor Janar - Tetor 2020 | Realizimi Janar - Tetor 2020 | Realizimi në % | Të pa realizuara Janar-Tetor 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Administratë** | **1** | Administrata | € 66,666.67 | € 43,326.00 | 65% | € 23,340.67 |
| | | **Total:** | **€ 66,666.67** | **€ 43,326.00** | **65%** | **€ 23,340.67** |
| **Buxhet, Financa dhe Thesar** | **2** | Taksat e firmave | € 16,666.67 | € 15,559.00 | 93% | € (1,107.67) |
| | **3** | Tatimi në pronë | € 672,723.33 | € 596,152.19 | 89% | € (76,571.14) |
| | **4** | Tatimi në toka | € - | € - | 0% | € - |
| | | **Total:** | **€ 689,390.00** | **€ 611,711.19** | **89%** | **€ (77,678.81)** |
| **Arsim** | **5** | Participimi Qerdhja e Fëmijëve | € 37,500.00 | € 6,831.00 | 18% | € (30,669.00) |
| | **6** | Shkolla SHMT | € 12,500.00 | € 11,348.00 | 91% | € (1,152.00) |
| | **7** | Shkolla SHMP | € 11,666.67 | € 15,318.00 | 131% | € 3,651.33 |
| | | **Total:** | **€ 61,666.67** | **€ 33,497.00** | **54%** | **€ (28,169.67)** |
| **Gjeodezi, Kadastër dhe pronë** | **8** | RDPP, Dalja në teren | € 58,333.33 | € 74,739.50 | 128% | € 16,406.17 |
| | **9** | Qiraja nga objektet publike | € 33,333.33 | € 12,010.31 | 36% | € (21,323.02) |
| | | **Total:** | **€ 91,666.67** | **€ 86,749.81** | **95%** | **€ (4,916.86)** |
| **Kulturë, Rini dhe Sport** | **10** | Palestra sportive | € 833.33 | € 504.00 | 60% | € (329.33) |
| | **11** | Bibloteka M-.L.k-Sm | € 416.67 | € - | 0% | € (416.67) |
| | **12** | Shtepia e Kultures | € - | € - | 0% | € - |
| | | **Total:** | **€ 1,250.00** | **€ 504.00** | **40%** | **€ (746.00)** |
| **Shërbime Publike** | **13** | Ndalja e veturave në rrugë | € 2,500.00 | € 2,507.45 | 100% | € 7.45 |
| | **14** | Regjistrmi i automjeteve | € 83,333.33 | € 90,030.50 | 108% | € 6,697.17 |
| | **15** | Taksat e Mbeturinave | € 494,076.67 | € 368,556.50 | 75% | € (125,520.17) |
| | | **Total:** | **€ 579,910.00** | **€ 461,094.45** | **80%** | **€ (118,815.55)** |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prokurim** | **15** | Tender | € | - | € | 1,751.82 | | € | 1,751.82 |
| | | **Total:** | **€** | - | **€** | **1,751.82** | | **€** | **1,751.82** |
| **Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural** | **16** | Ndërrim i destinimit të tokës bujqësore | € | 16,666.67 | € | 109,816.22 | 659% | € | 93,149.55 |
| | **17** | Leje pune | € | - | € | 30.00 | | € | 30.00 |
| | | **Total:** | **€** | **16,666.67** | **€** | **109,846.22** | **659%** | **€** | **93,179.55** |
| **Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** | **18** | Participim Drejtoria e Shëndetësis | € | 41,666.67 | € | 20,756.50 | 50% | € | (20,910.17) |
| | **19** | Qendra për punë sociale | € | 1,666.67 | € | 1,861.00 | 112% | € | 194.33 |
| | **20** | Shëndetësi | € | 43,333.33 | € | 22,617.50 | 52% | € | (20,715.83) |
| | | **Total:** | **€** | **43,333.33** | **€** | **45,235.00** | **104%** | **€** | **(41,431.67)** |
| **Inspekcioni** | **22** | Pranimet Teknike | € | 5,000.00 | € | 2,627.50 | 53% | € | (2,372.50) |
| | **23** | Pëlqimet Sanitare | € | 6,666.67 | € | 12,342.17 | 185% | € | 5,675.50 |
| | **24** | Gjobat e inspekcionit | € | 833.33 | € | 5,825.00 | 699% | € | 4,991.67 |
| | | **Total:** | **€** | **12,500.00** | **€** | **20,794.67** | **166%** | **€** | **8,294.67** |
| **Ubranizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** | **25** | Leje ndërtimi | € | 125,000.00 | € | 226,233.25 | 181% | € | 101,233.25 |
| | **26** | Shfrytëzimi i pronës publike | € | 8,333.33 | € | 511.25 | 6% | € | (7,822.08) |
| | | **Total:** | **€** | **133,333.33** | **€** | **226,744.50** | **170%** | **€** | **93,411.17** |
| **Tjera** | **27** | Dënimet e Policisë | € | - | € | 137,822.50 | | € | 137,822.50 |
| | **28** | Dënimet Gjykatave | € | - | € | 10,845.00 | | € | 10,845.00 |
| | **29** | Shitja e drunjëve | € | - | € | - | | € | - |
| | **30** | Të hyrat tjera | € | - | € | 598.00 | | € | 598.00 |
| | | **Total:** | **€** | **1,739,716.67** | **€** | **1,813,137.66** | **104%** | **€** | **73,420.99** |

**Burimi:** Buxhet, Financa dhe Thesar, Komuna Vushtrri

### 4.6.4. Ndikimi i pandemisë COVID -19 në realizimin e projekteve dhe investimeve kapitale

Pandemisa COVID-19 ka prodhur efekte negative dhe krijimin e barrierave duke kanë ndikuar edhe në realizimin e projekteve dhe investimeve kapitale në veqanti në periudhën Mars – Prill 2020, kur kanë hyrë në fuqi masat e para në nivel vendi për parandalimin e pandemisë COVID-19. Kryesisht projektet e kësaj periudhes kanë qenë të bartuara nga viti 2019 ose kanë filluar para datës 13 mars dhe ka pas problem t'i vazhdojnë punimet e kontraktuara edhe për për arsye të masave kufizuese të qarkullimit të fuqisë punëtore nga qeveria.

Pas datës 13 mars 2020, komuna ka qenë e kufizuar në ndërmarrjen e procedura sipas planeve të parapara për investime bazuar në Ligjin për prokurim publik për shkak të kufizimeve nga masat e marr nga niveli qendror. Dhe pas krijimit të kësaj situate Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ka marr vendim me datën 15 prill 2020, me të cilin komunave u është ndalur ndjekja e procedurave të prokurimit për secilën kategori, përveç kontratave të lidhura me negocim që lidhen me masat ndaj pandemisë COVID-19[23]

Konkretisht në komunën e Vushtrrisë ka ndikuar në këto projekte:

TABLE 9. PROJKETET E NDIKUARA NGA COVID-19, VUSHTRRI

| Nr. | Projekti | Vlera në (€) | Statusi |
|---|---|---|---|
| 1. | Ndërtimi i kiosqeve në sheshin "Adem Jashari" | 10,000.00 | Zhvendoset në pjesën e dytë të vitit |
| 2. | Ndërtimi i kanalizimeve në zonat rurale | 50,000.00 | Zhvendoset në pjesën e dytë të vitit |
| 3. | Ndërtimi i ujësjelläseve në zonat rirale | 200,000.00 | Zhvendoset në pjesën e dytë të vitit |
| 4. | Ndërtimi i stacionit të autobusëve | 15,000.00 | Largohet nga lista e investimeve |
| 5. | Renovimi i QMF dhe instalimi i ngrohjes qendrore | 15,000.00 | Largohet nga lista e investimeve |
| | Total: | **290,000.00** | |

**Burimi:** Drejtoria e Prokurimit KK Vushtrri

[23] https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Contacts&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=66

## 4.7. Masat e ndërmarra nga komuna anti COVID-19

Komuna e Vushtrrisë ka qenë aktive në ndërmarrjen e masave për parandalimin e përhapjes se virusit. Me rastin e shapalljes pandemi globale COVID-19 nga OBSH (11.03.2020), komuna e Vushtrrisë të nesërmen me dt. 12.03.2020 ka themeluar Shtabin Emergjent për mbrojtje nga COVID-19 në përbërje prej 15 anëtarësh, në të cilin përveç përfaqësuesve institucional janë përfshi edhe: përfaqësuesi i organizatave rinore të komunës, përfaqësuesi i shoqatës së bizneseve, bashkësisë islame dhe kryqit të kuq në Vushtrri. Përveç këtyre masave, komuna është koordinuar në vazhdimësi për vendimet dhe masat e ndërmarra nga niveli qendror për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.

Shtabi ka qenë  dhe ende vazhdon të jetë mobil 24 orë dhe ka mbajtë mbledhje varësisht prej situatës në terren, dhe ka marr një varg masash konform vendimeve të Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës.

Por krahas punës së Shtabit Emergjent, Kuvendi Komunal ka marrë masa të ndryshme në interes dhe mbrojtje të qytetarëve dhe bizneseve të Komunës së Vushtrrisë.  Komuna ka treguar potencial të mirë në menaxhimin institucional dhe ndërmarrjen e masave në parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Përveç rolit sensibilizues, komuna kanë dëshmuar rol të mirë koordinues me nivelin qendror dhe kjo qasje ka dhënë rezultate të mira në ruajtjen e shëndetit publik.

### TABLE 10. MASAT E NDËRMARRA NGA KOMUNA ANTI COVID-19

| Nr. | Vendimi i Asamblesë/Kryetarit | Llojit i vendimit | Pershkrimi | Vlera/Shuma |
|---|---|---|---|---|
| Masa 1 | Vendim Kryetari nr. 291/20, dt. 12.03.2020 | Vendimi për themelimin e Shtabit Emergjent | Shtabi Emergjent për Menaxhimin e Pandemisë COVID-19 | |
| Masa 2 | Nr. 65/20, Dt. 26.03.2020[24] | Vendim për financimin e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 *(nga kategoria Mallra dhe Shërbime)* | Blerjen e mjeteve mbrojtëse, barnave dhe pajisjeve të nevojshme shëndetësore për punëtorët shëndetësorë, administratës së komunës, mjeteve dezinfektuese dhe çdo gjë tjetër që do të jetë e nevojshme për parandalim dhe mbrojtje të kësaj sëmundje. | € 200,000.00 |
| Masa 3 | Nr. 65/20, Dt. 26.03.2020[25] | Vendim për financimin e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 *(nga kategoria Mallra dhe Shërbime)* | Blerjen e pakove sociale (pako ushqimore dhe higjienike) për familjet në gjendje të rëndë sociale, në vlerë prej 50.00 Euro. | |
| Masa 4 | Shtabi Emergjent për Menaxhimin e Pandemisë COVID-19 | Shtabi Emergjent për Menaxhimin e Pandemisë COVID-19 | Dezinfektimi i hapësirave publike (sheshit, rrugeve, ndertesave publike) | |
| Masa 5 | Nr. 68/20, Dt. 23.04.2020[26] | Vendim për inicimin e procedurës për zhvillimin e studimit të efektit të pandemisë COVID-19 | Me këtë vendim, inicohet procedura për studim mbi ndikimin e virusit COVID-19 në ekonominë lokale, formale e jo formale të komunës së Vushtrrisë dhe masat për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë së virusit COVID-19. | |
| Masa 6 | Nr. 69/20, Dt. 23.04.2020[27] | Vendim për lirim nga pagesa e tarifës për çerdhen e fëmijëve "Foleja" Vushtrri | 1. Me këtë vendim, lirohen nga pagesa e tarifës komunale për prindërit e Komunës së Vushtrrisë për shërbimet e edukimit për fëmijët e tyre të cilat ofrohen në Çerdhen e Fëmijëve "Foleja" në Vushtrri.<br>2. Lirimi nga pagesa bëhet prej dt. 01.03.2020 deri në fillim të vitit të ri shkollor 2020 - 2021. | |

[24] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-nga-mbledhja-urgjente-mars-2020.pdf
[25] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-nga-mbledhja-urgjente-mars-2020.pdf
[26] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-e-mbledhjees-s%C3%AB-jasht%C3%ABzakonshme.pdf
[27] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-e-mbledhjees-s%C3%AB-jasht%C3%ABzakonshme.pdf

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Masa 7 | Nr. 71/20, Dt.23.04.2020[28] | Vendim për shtyrjen e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë | 1. Me këtë vendim lejohet shtyrja e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.<br>2. Afati për shtyrjen e pagesës së këstit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë. | |
| Masa 8 | Nr. 72/20, Dt.23.04.2020[29] | Vendim për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike | 1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe hapësirave publike në komunën e Vushtrrisë.<br>2. Lirimi nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë do të zgjasë nga data 1 mars deri më 31 dhjetor 2020. | |
| Masa 9 | Nr. 92/20, Dt. 28.05.2020 | Vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina | 1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale të Komunës së Vushtrrisë.<br>2. Lirimi nga pagesa bëhet prej dt. 01.03.2020 deri më 31.12.2020. | |
| Masa 10 | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | Ka shpall thirrje për mbështetje financiare të bizneseve | Mbeshtetja eshte planifikuar për operator ekonomike (zejtar dhe shërbyese)<br>Bizneset Mikro perfitojne nga 300 - 500 Euro<br>Bizneset e Vogla perfitojne 500 - 1900 Euro | € 250,000.00 |

[28] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-e-mbledhjees-s%C3%AB-jasht%C3%ABzakonshme.pdf
[29] https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Vendimet-e-mbledhjees-s%C3%AB-jasht%C3%ABzakonshme.pdf

## 4.8. Efektet e pandemisë COVID-19 në tregun lokal të punës

Masat kufizuese, si pasojë e pandemisë, kanë ndikuar edhe në tregun e punës në nivelin lokal. Në kuadër të masave, Pako Fiskal Emergjente në Kosovë e ka përfshi mbështetjen e pagave të atyre që kanë humbur vendet e punës si pasojë e pandemisë ose si formë e asistencës sociale për personat e papunë dhe në kushte të rënda sociale. Sipas Pakos Fiskale Emergjente, të bërë publike nga Qeveria e Kosovës, parashihet edhe asistencë prej 170 euro në muaj për pagat e punëtorëve për ato shoqëri tregtare të cilat janë në vështirësi financiare (masa 1.3, pika 1.3.1), si dhe (masa 1.8) parashihet asistencë financiare pej 130 euro në muaj për ata që e humbin vendin e punës.[30] Në bazë të të dhënave nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në Komunën e Vushtrrisë numri i të punësuarve sipas sektorëve ekonomik në vitin 2020 është rritur edhe pse në gjendje pandemie dhe kjo ka ardh si rezultat i formalizimit të të punësuarëve të ndikuar nga (masa 14) e Pakos Fiskale Emergjente të Qeverisë së Kosovës. Numri më i madh i formalizimit të punësuarëve është bërë në sektorin e *Industrisë përpunuese, Ndërtimtari, Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave dhe në sektorin Transport dhe Magaznim*, shih (Tabela 10).

**TABLE 11. NR.I TË PUNËSUARVE SIPAS SEKTORËVE PERIUDHA DHJETOR 2019 DHE MARS-SHTATOR 2020 - VUSHTRRI**

| Sektorët Ekonomike | Totali Dhjetor 2019 | Totali Shtator 2020 |
|---|---|---|
| Mungon aktiviteti | 105 | 80 |
| Bujqësia;Pylltaria dhe Peshkimi | 266 | 257 |
| Industria përpunuese | 804 | 1,001 |
| Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar | 1 | 1 |
| Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave | 10 | 14 |
| Ndërtimtaria | 524 | 633 |
| Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 1,613 | 1,796 |
| Transporti dhe magazinimi | 76 | 104 |
| Akomodimi dhe shërbimi ushqimor | 245 | 264 |
| Informimi dhe komunikimi | 86 | 62 |
| Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 9 | 18 |
| Aktivitetet e patundshmërisë | 1 | 1 |
| Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike | 87 | 84 |
| Shërbimet administrative dhe mbështetëse | 86 | 68 |
| Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyruesheëm | 64 | 56 |
| Arsimi | 46 | 50 |
| Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale | 55 | 68 |
| Artet, Argëtimi dhe rekreacioni | 25 | 17 |
| Aktivitetet e tjera shërbyese | 109 | 120 |
| Person Fizik | 18 | 6 |
| Totali | 4,230 | 4,698 |

**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

[30] https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf

#### FIGURE 3. NUMRI I TË PUNËSUARËVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK, (MARS - SHTATOR 2020), VUSHTRRI




**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) periudha Mars – Shtator 2020

#### FIGURE 4. NUMRI I TË PUNËSUARËVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK, (MARS - DHJETOR 2019), VUSHTRRI




**Burimi:** Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) periudha Mars - Dhjetor 2019

Masa 14 parasheh mbështetje financiare prej 130 euro për dy muaj për shoqëritë tregtare të cilat gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik regjistrojnë punëtorë me kontratë pune së paku një vjeçare. Për të përfituar punëdhënësi nga kjo masë, kontrata duhet të jetë e nënshkruar pas fillimit të pandemisë në Kosovë dhe të jetë në kohëzgjatje jo më pak se një vit.[31]

Numri i të punësuarve formal është rritur përgjatë periudhës së pandemisë për 10 % apo 468 të punësuar në sektorin privat në Komunën e Vushtrrisë.

TABLE 12. NUMRI I PUNËTORËVE QË APLIKUAN PËR PËRFITIM MASA 14, KOMUNA E VUSHTRRISË

| Komuna | Femra | Mashkuj | Total |
|---|---|---|---|
| Vushtrri | 98 | 284 | 382 |

FIGURE 5. NUMRI I PUNËTORËVE QË APLIKUAN PËR PËRFITIM MASA 14, SIPAS GJINISË (%) VUSHTRRI




Ndërsa, të dhënat nga Agjencia e Statistikës së Kosovës (ASK) tregojnë për një rritje të shpejtë të numrit të të papunëve. Duke marrë parasysh që pandemia e koronavirusit shkaktoi rënie të punëtorëve prej industrive të ndryshme, Pakoja Emergjente Fiskale ishte një hap i duhur për t'i zvogëluar efektet e pandemisë në ekonomi të Kosovës. Megjithatë, pasi që Masa 15 e pakos parasheh një pagesë mujore në vlerë prej 130 euro për qytetarët të lajmëruar si të papunë pranë entit të punësimit (dhe që janë me kushte të rënda sociale apo që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga Buxheti i Kosovës), kjo mund të ketë quar në një rritje tejet të lartë të punëkërkuesve të regjistruar.[32]

Më saktësisht, nga muaji mars 2020 numri i punëkërkuesve u rrit për 3,126 apo rreth 40%. Aktualisht në Komunën e Vushtrrisë janë punëkërkues të regjistruar 7,869 persona (4,179-mashkuj dhe 3,690 femra), shih (Tabela 11).

TABLE 13. PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR (MUAJI, GJINIA), VUSHTRRI

| Gjinia | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mashkuj | 2.555 | 2.581 | 2.592 | 2.991 | 3.819 | 3.849 | 4.054 | 4.135 | 4.179 |
| Femra | 2.101 | 2.133 | 2.151 | 2.567 | 3.424 | 3.439 | 3.576 | 3.637 | 3.690 |
| Total: | 4.656 | 4.714 | 4.743 | 5.558 | 7.243 | 7.288 | 7.630 | 7.772 | 7.869 |

[31] https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf
[32] https://ask.rks-gov.net/media/5672/buletini-tremujor-tetor-2020.pdf

FIGURE 6. PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR (MUAJI DHE GJINIA), VUSHTRRI




FIGURE 7.PUNËKËRKUESIT SIPAS GJINISË NË %, SHTATOR 2020, VUSHTRRI



# 5. Rezultatet e hulumtimit

## 5.1. Pyetësori me ekonomi familjare

Pyetësori për ekonomi familjare është realizuar me 450 qytetar të Komunës së Vushtrrisë. Në këtë pyetësor është trajtuar ndikimi socio-ekonomik i pandemisë COVID-19 në ekonomitë familjare të komunës së Vushtrrisë lidhur me përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshi të dhëna të *ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet, statustin e punësimit, dhe sfidat me të cilat përballen të shkaktuara nga pandemia COVID-19, kërkesat e tyre nga niveli institucionet publike.* Të anketuarit janë përgjigjugjur në pyetje individuale dhe familjare. Të dhënat janë mbledhur nga tereni përmes anketuesëve.

FIGURE 8.GJINIA E TË ANKETUARVE




FIGURE 9.MOSHA E TË ANKETUARËVE




Pyetësori me ekonomi familjare ka përfaqësim gjinor 50/50, ndërsa 18 % e të anketuarve bëjnë pjesë në grupmoshën 18-24 vjeç, 30 % në grupmoshën 25-34 vjeç, 19 % në grupmoshën 34-44 vjeç, 16% në grupmoshën 45-54 vjeç, 12 % në grupmoshën 55-64 vjeç, dhe në fund, 6% janë në grupmoshën 65+. (Figura 8 dhe 9).

Sa i përket shpërndarjes, mostra është gjithashtu përfaqësuese e popullsisë së Komunës së Vushtrrisë. Ndërkohë, 58% e të anketuarve janë nga zona urbane dhe 42% e të anketuarve nga zona rurale. (Figura 10).

FIGURE 10. VENDBANIMI I ANKETUESËVE



FIGURE 11. NIVELI I ARSIMIMIT TË ANKETUESËVE




FIGURE 12. NACIONALITETI I ANKETUESËVE




Nivelit i arsimit, 0.3% e të anketuarve nuk kanë arsimim; 26.7% kanë përfunduar arsimin fillor; 43% kanë përfunduar arsimin e mesëm ose ekuivalent; 28% kanë përfunduar arsimin në nivelin universitar (bachelor) ose ekuivalent; dhe 2% kanë përfunduar arsimin pasuniversitar (master ose më të lartë).(Figura 11). Ndërsa struktura e naciolitetit/etnis të të anketuarve, ka të anketuar shqiptarë (98%), serbë (1%), turqi (0.6%) dhe të komuniteteve të tjera jo-shumicë (0.4%), përafërsisht e njejtë me përbërjen e vërtetë të popullsisë.(Figura 12).

FIGURE 13. STATUSI CIVIL I TË ANKETUARËVE




Ndërsa, lidhur me statusin civil, 29% e të anketuarve janë beqarë, 64% janë të martuar, 1% janë në bashkëjetesë, 0.5% të ndarë ose të divorcuar, dhe 5% janë të veja. (Figura 13).

FIGURE 14. TË HYRAT E FAMILJES SË ANKETUESËVE




Sa i përket të ardhurave mujore të familjeve, 28% e familjeve kanë të ardhura të përbashkëta mujore deri në 249 Euro, 18% e familjeve jetojnë me të ardhura mujore nga 250 deri në 299 Euro, 22% kanë të ardhura në mes 400 - 799 Euro, 6% kanë të ardhura familjare mujore nga 800-1,199 Euro, 3% kanë

të ardhura familjare mujore nga 1,200-2,000 Euro, dhe 1% jetojnë me të ardhura mujore me më shumë se 2,000 Euro. Ndërsa, 22% nuk kanë treguar të ardhurat mujore të familjeve të tyre. (Figura 14).

FIGURE 15. NDRYSHIMI I NIVELIT TË TË HYRAVE PAS FILLIMIT TË PANDEMISË COVID-19




| Të ardhurat e familjes | | |
|---|---|---|
| | Mesatarja | Moda |
| Janë rritur (Mujore) | 100 | 25 |
| Janë ulur (Mujore) | 350 | 380 |

Në pyetjen nëse niveli i të hyrave të familjes ka ndryshuar si rezultat i pandemisë COVID-19, 2% pohuan se të ardhurat e tyre familjare janë rritur, 51% pohuan se të hyrat e tyre familjare janë ulur, 45% pohuan se të ardhurat e tyre familjare nuk kanë ndryshuar, dhe 2% nuk janë të sigurt. Të anketuarit që deklaruan rritje të të ardhurave familjare kanë pësuar mesatarisht një rritje prej 100 Euro në muaj, ndërsa vlera më e përsëritur e deklaruar në këtë grup ishte një rritje prej 20 Eurosh në të ardhurat mujore. Në anën tjetër, pothuajse gjysma e familjeve kanë përjetuar një ulje mesatare prej 350 Eurosh në muaj, ku vlera më e përsëritur e uljes së të ardhurave është 380 Euro në muaj. (Figura 15).

FIGURE 16. NDRYSHIMI I NIVELIT TË TË HYRAVE PAS PANDEMISË COVID-19, SIPAS GJINISË




Analiza e të hyrave pas pandemisë COVID-19 sipas gjinisë, rezulton se 51% e meshkujve dhe 48% e femrave kishin përjetuar ulje të të ardhurave pas pandemisë. Ndërsa, 41% e meshkujve dhe 46% e femrave nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim në të ardhura. Një pjesë e vogël e meshkujve (3%) dhe femrave (2%) kanë pësuar rritje të të ardhurave pas pandemisë COVID-19. (Figura 16).

FIGURE 17. STATUSI I PUNËSIMIT PARA PANDEMISË TË ANKETUESËVE




Kjo pyetje na tregon se si kanë ndryshuar punësimi dhe jetesa e individëve dhe familjeve pas pandemisë me koronavirus. Të paktën një javë para pandemisë, 52% e meshkujve dhe 34% e femrave kanë punuar në një institucion ose një kompani, ndërsa, 15% e meshkujve dhe 5% e femrave deklarojnë se kanë qenë të vetëpunësuar ose kanë qenë pronarë të bizneseve të tyre. Vetëm rreth 3% e mashkujve ndihmonin në një biznes familjar pa pagesë. Rreth 11% e meshkujve dhe 17% e femrave ishin të papunë, dhe 2% e meshkujve dhe 3% e femrave ishin punonjës të dekurajuar që nuk po kërkonin punë. Ndërsa, 3% e mashkujve dhe 6% e femrave nuk punonin sepse ishin studentë me kohë të plotë. Kishte edhe pensionistë, nga të cilët 12% ishin mashkuj dhe 7% ishin femra. Edhe pse nuk ishin duke punuar, 2% e meshkujve dhe 1% e femrave ishin përfitues të një skeme të ndihmës sociale publike. Rreth 3% e mashkujve dhe dhe 2% e femrave deklaruan se janë të papunë për shkak të gjendjes shëndetësore. Së fundmi, për mashkujt, përgjegjësia për punët shtëpiake dhe kujdesin familjar nuk paraqiste pengesë në krahasim me 24% të femrave. (Figura 17).

FIGURE 18. STATUSI I PUNËSIMIT PARA PANDEMISË (VENDBANIMI)




Krahasuar në bazë të vendbanimit urban apo rural, gjysma e banorëve urban, punojnë për dikë, një kompani ose institucion. Në zonat rurale, kjo pjesë përbën 42% të qytetarëve. Në anën tjetër, në zonat rurale, ka më shumë (12%) njerëz që kujdesen për familjen dhe punët shtëpiake sesa në zonat urbane (6%), si dhe më shumë punonjës të dekurajuar, me një ndryshim prej 5 pikë përqindjeje në krahasim me banorët urban. Ndërsa, në lidhje me statuset e tjera të punësimit, ndryshimet midis zonave urbane dhe rurale janë të vogla.(Figura 18).

FIGURE 19. PUNËSIMI SIPAS SEKTORIT DHE GJINISË




Krahasuar sipas gjinisë, më shumë se një e treta e femrave të anketuara punojnë në sektorin publik, ndërsa rreth një e pesta e mashkujve punojnë në sektorin publik. Dy të tretat e femrave dhe katër të pestat e mashkujve punojnë në sektorin privat. (Figura 19).

FIGURE 20. SEKTORI I PUNËSIMIT, SIPAS MOSHËS




Ka më shumë dallime sipas sektorit të punësimit kur krahasohen grupmoshat e ndryshme. Sa më të rinj të jenë individët, aq më shumë priren të punojnë në sektorin privat. Të rriturit e rinj që janë 18-24 vjeç që supozohet se janë në fillim të karrierës, punojnë shumë më shumë (89%) në sektorin privat krahasuar me sektorin publik (11%). Grupi tjetër i të anketuarëve që janë 25-34 vjeç kanë tendencë ta punojnë në sektorin publik më shumë (32%) sesa grupi i mëparshëm, por edhe këta janë kryesisht të punësuar në sektorin privat (68%). Ndërsa, për ata në grupmoshën 55-64 vjeç ndryshimi midis sektorit publik dhe privat është pothuajse i barabartë.(Figura 20).

FIGURE 21. VEPRIMTARIT EKONOMIKE TË PUNËSIMIT, SIPAS GJINISË




Sa i përket punësimit sipas industrisë, ka dallime më të mëdha gjinore në industri të caktuara. Ka më shumë mashkuj (22%) sesa femra (15%) që punojnë në restorante, kafene, apo hotele. Ndërsa, ka shumë më tepër femra që punojnë në arsim dhe shëndetësi (13%) krahasuar me mashkuj (7%). Sa i përket industrisë së prodhimit dhe ndërtimtarisë, mashkuj (përkatësisht 9% dhe 18%) përsëri përbëjnë një pjesë

shumë më të madhe sesa femrat (7% dhe 1%). Femrat janë më të përfaqësuara në sektorin publik dhe tekstil sesa mashkujt. (Figura 21).

FIGURE 22.NDIKIMI I PANDEMISË NË NDRYSHIMIN E ORAREVE TË PUNËS, SIPAS SEKTORIT




Lloji i punësimit, sektori dhe industria e morën për bazë periudhën të paktën një javë para përhapjes së pandemisë COVID-19. Megjithatë, në një pyetje vijuese, të anketuarit u pyetën nëse orët kushtuar punës kanë ndryshuar pas pandemisë dhe, në përgjithësi, 3% thanë se janë rritur, 23% thanë se ju mbetën të njëjta, 20% thanë se orët ju mbetën të njëjta por që ju ishin zvogëluar pagat, 35% thanë se orët u janë zvogëluar por ata janë ende të punësuar, dhe 10% thanë që janë ende të punësuar por aktualisht nuk punojnë fare, ndërsa 7 % thanë që kanë humbur vendin e punës dhe 2% janë larguar nga puna.(Figura 22).

FIGURE 23. NDIKIMI I PANDEMISË NË NDRYSHIMIN E ORAREVE TË PUNËS, SIPAS INDUSTRISË




Ndikimi i COVID-19 në orët kushtuar punës dallon në bazë të industrisë. Punëtorët më të goditur janë në sektorin e patundshmërisë, ndërtimtarisë dhe tekstilit. Kur krahasohen sipas industrisë së punësimit, 7% e të anketuarve në industrinë e tregtisë me shumicë dhe arsimit/shëndetësisë, 3% e të anketuarve në industrinë e shërbimeve profesionale, 5% në prodhim, 5% në sektorin publik dhe 1% në restorante/ kafene/hotel dhe tregti me pakicë deklarojnë se orët e shpenzuara në punë u janë rritur. Në industrinë e

bujqësisë, 55% deklarojnë se nuk u kanë ndryshuar orët kushtuar punës që përbën pjesën më të madhe në krahasim me industritë e tjera.(Figura 23).

FIGURE 24. PUSHIMET E DETYRUESHME PËR SHKAK TË PANDEMISË, SIPAS SEKTORI




Për të kuptuar dinamikën e punës dhe mekanizmat e përballjes së institucioneve dhe ndërmarrjeve të ndryshme me punonjësit e tyre, të anketuarit u pyetën nëse ishin detyruar të merrnin pushim për shkak të pandemisë. Nga ata që ishin ende të punësuar pas pandemisë në sektorin publik, 7% morën pushim me pagesë të plotë, 7% pushim të paguar pjesërisht, 69% pushim pa pagesë dhe 17% nuk morën pushim. Ndërsa në sektorin privat, 5% kishin marrë pushim me pagesë të plotë, 7% pushim të paguar pjesërisht, 24% pushim pa pagesë dhe 53% nuk morën pushim. Kishte gjithashtu 3% të të anketuarve që deklaruan se nuk kishin të drejtë pushimi në asnjërin sektor. Megjithëse arsyet për këtë nuk u shqyrtuan më tej përmes anketës, disa nga këto përgjigje mund të vijnë për shkak të llojit të kontratës që kanë punonjësit në secilin sector. (Figura 24).

FIGURE 25. PRITJET PËR PUNËSIM PAS PËRFUNDIMIT TË PANDEMISË




Sidoqoftë, 92% e të anketuarve që ishin dhe vazhdojnë të jenë të punësuar, që përfaqësojnë pak më shumë se gjysmën e mostrës, janë optimistë për mundësitë e tyre të punësimit pas pandemisë. Vetëm disa (6% dhe 2%) besojnë se nuk do të vazhdojnë të punojnë apo nuk janë të sigurt nëse do të punojnë.(Figura 25).

FIGURE 26. MËNYRA E MARRJES SË PAGËS PARA COVID-19, SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE




Ndërsa më e goditura nga informaliteti është industria e ndërtimtarisë ku 68% e të anketuarve deklaruan se marrin pagat e tyre në para të gatshme, përcjellur nga punëtorët në restorante, kafene dhe hotele (49%), në Bujqësi (48%), në transport dhe komunikim (46%), dhe tekstil dhe veshmbathje (45%). Sektorët më pak informalë në këtë aspekt duket se janë shërbimet profesionale (12%), tregtia me shumicë (12%), arsimi dhe shëndetësia (8%).

FIGURE 27. MËNYRA E MARRJES SË PAGËS PARA COVID-19, SIPAS GJINISË




Mashkujt duket se janë më të prekur sa i përket punësimit joformal sesa femratë. Përderisa 55% e mashkujve dhe 79% e femrave janë paguar përmes llogarisë bankare; ka më shumë mashkuj (39%) sesa femra (12%) të cilët paguheshin me para të gatshme. Vetëm një numër i vogël i mashkujve (4%) dhe femrave (8%) ishin paguar pjesërisht në para dhe pjesërisht përmes llogarisë bankare.

FIGURE 28. PAGESA E KONTRIBUTEVE PENSIONALE PARA COVID-19, SIPAS VEPRIMTARISË EKONOMIKE




Në mënyrë të ngjashme, shumicës së punonjësve në ndërtimtari (74%) nuk u paguhen kontributet pensionale nga punëdhënësi siç kërkohet me ligj. Sidoqoftë, kjo ndodh edhe në sektorë të tjerë, ku të paktën një të tretës së punonjësve nuk u paguhen kontributet pensionale, përkatësisht, në transport/komunikim (39%), restorante/kafene/hotel (33%) dhe bujqësi (30%). Rreth një të pestës apo të katërtës së punonjësve nuk u paguhen kontributet pensionale në industrinë e tekstilit/veshmbathjes, tregtisë me pakicë dhe prodhimit.

FIGURE 29. TREGU I PUNËSIMIT SIPAS VEPRIMTARISË EKONOMIKE




Tregu i punës sipas veprimtarive ekonomike rezulton si punëdhënësi kryesorë ndërtimtaria (19%), restorantet, kafenetë, apo hotelet (17%), dhe sektori publik, industria e prodhimit (secila nga 12%). Pjesa më e vogël e fituesve kryesorë të të ardhurave janë të punësuar në bujqësi (2%), tekstil/veshmbathje (3%) dhe tregti me shumicë (2%). (Figura 29).

FIGURE 30. SI PASOJË E COVID19, SI JANË PREKUR SECILA NGA BURIMET (TË HYRAT) E MËPARSHME PERSONALE?




Duke pasur parasysh që punësimi i qytetarëve kishte pësuar ndryshime, ishte me shumë rëndësi të kuptohej nëse të ardhurat e tyre personale nga burime të ndryshme janë ndikuar. U konstatua se 55% e të anketuarve nuk kishin ndonjë ndryshim në të ardhura nga vendi i punës, 31% kishin pësuar rënie, dhe 1% kishin pësuar rritje përmes këtij burimi të fitimit. Sidoqoftë, në përgjithësi, 29% e të anketuarve deklarojnë se të ardhurat e tyre të fituara përmes një pune dhe përmes një biznesi janë zvogëluar. Shumica e të anketuarve nuk marrin të ardhura si mbështetje financiare nga OJQ-të (96%), qeveria (89%), familja (89%), të ardhura nga bujqësia (69%), remitancat (79%), pronat personale, investimet ose kursimet ( 86%), dhe biznesi familjar (55%). Megjithatë, për ata që kanë të ardhura nga këto burime, ka pasur një ulje 5%të të ardhurave nga bujqësia, 7% nga remitancat, 8% nga pronat personale, investimet ose kursimet, dhe 3% nga mbështetja financiare e familjes.

FIGURE 31. A KENI MARRË NDONJË MBËSHTETJE FINANCIARE NGA NDONJË INSTITUCION PUBLIK DHE ORGANIZATË




Shumica e të anketuarve nuk kanë marrë ndonjë mbështetje materiale nga qeveria (100%), komunat (96%) ose OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Sidoqoftë, rreth 7% kanë marrë ushqim dhe 6% kanë marrë produkte higjienike familjare dhe personale nga komunat; ndërsa, 2% kanë marrë ushqim dhe 3% produkte higjienike familjare nga OJQ-të dhe/apo organizatat ndërkombëtare. Këtu reflektohet masa e ndërmarrë nga Komuna e Vushtrrisë, Vendimi: Nr. 65/20, Dt. 26.03.2020 - Blerjen e pakove sociale (pako ushqimore dhe higjienike) për familjet në gjendje të rëndë sociale, në vlerë prej 50.00 Euro.

## 5.2. Pyetësori me biznese

Pyetësori me biznese është realizuar në dy forma *(online dhe intervistimit direkt permes vizitve tek bizneset).* Kompania ka M-Holding ka mbledhur të gjitha shenimet prej burimeve të ndryshme lidhur me numrin e bizneseve aktive duket filluar nga (*Komuna përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ARBK dhe Administrata Tatimore e Kosovës – ATK*). Të gjitha këto biznese janë informuar në formë elektronike përmes e-maili lidhur me qëllimin e studimit dhe ju kemi dërguar linkun e pyetësorit për plotësim permes platformës (google forms) dhe i kemi kontaktuar me telefon në bazë të kontakteve zyrtare lidhur me planifikimin e vizitave për intervistim direkt.
Pyetësori i bizneseve përmban elemente lidhur: *Reagimin e bizneseve në këtë situatë të panjohur dhe me çfarë sfidash po përballen për sa i përket likuiditetit, mungesës së prodhimit, mungesës së klientëve, rritjes së kostove, etj. Cilat janë vlerësimet e tyre mbi ndikimin e COVID-19 në xhiron vjetore të biznesit të tyre? Si mundet niveli qendror dhe lokale të ndihmojnë duke patur parasysh nevojat specifike gjatë kësaj periudhes.*

Nga Komuna e Vushtrrisë e kemi pranuar regjistrin e biznesve të totale sipas (ARBK, gjithsejt 4,468) por këtë listë e kemi përditësuar në bazë të regjistrit të bizneseve aktive të deklauar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe ka rezultar në bazë të ATK-së se në komunën e Vushtrrisë janë biznese aktive/tatim pagues Mars - Shtator 2020, gjithsejt 622 biznese dhe bazuar në shkallën e përqindjes së informalitetit i cili është rreth 30% prezent në nivel vendi duke u bazuar në raporet e (BB, FMN dhe institucione tjera kredibile) orientimisht munden të jenë rreth apo maksimalisht 900 biznese.
Mostra prej 202 biznese është representative dhe kemi përzgjedh biznese të sektorëve dhe veprimtarive të ndryshme për të gjeneruar rezultate të sakta dhe përmbajtësore lidhur me gjendjen reale të krijuar nga pandemia COVID-19. Mostra është shpërndarë me metodën e rastit dhe nënkupton se përzgjedhja e bizneseve është bërë në mënyrë të rastësishme duke përfshi të gjithë sektorët dhe lejon mundësin e përgjithësimit të rezultateve në nivel të komunës së Vushtrrisë.

FIGURE 32. STRUKTURA E BIZNESVE TË ANKETUARA SIPAS MADHËSISË




FIGURE 33. VITET E OPERIMIT NË TREG




Biznese të anketuara sipas strukturës së madhësisë janë: 52% Mikrondërmarrje, 38% Ndërmarrje të vogla, dhe 10% Ndërmarrje të mesme. (Figura 32). Dhe në bazë të viteve të operimit në treg rezultojnë të jenë 45% prej 1-5 vite dhe 55% mbi 5 vite operim në treg. (Figure 33)

FIGURE 34. STRUKTURA E BIZNESVE TË ANKETUARA SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE




Në bazë të anketimit ka rezultuar të jenë pjesëmarrëse ndërmarrjet sipas strukturës së veprimtarive ekonomike si në vijim: bujqësore 22%, edukativo-arsimore 2% , gastronomia dhe hoteleria 16% , ndërtimore dhe material ndërtimor 5%, shëndetësore 2%, shërbyese 19%, transportuese 1%, tregtare 17% dhe veprimtari tjera 2%.

FIGURE 35. AJENI NDËRMARRJE EKSPORTUESE?




Ndërsa në pyetjen a jeni ndërmarrje eksportuese rezulton të jenë 12% eksportuese dhe 88% nuk eksportojnë. (Figure 34).

FIGURE 36. SI E VLERËSONI NDIKIMIN E PANDEMISË NË BIZNESIN TUAJ?




Në përgjithësi, gati dy të tretat e ndërmarrjeve të anketuara e vlerësojnë ndikimin e COVID-19 si shumë negativ (69%), ndërsa 28% e vlerësojnë atë si negativ. Rreth 2 % e ndërmarrjeve vlerësojnë se COVID-19 nuk ka pasur asnjë ndikim në biznesin e tyre, ndërsa vetëm 1% e ndërmarrjeve deklaruan ndikim pozitiv. Asnjë ndërmarrje nuk deklaroi se COVID-19 kishte pasur ndikim shumë pozitiv në biznesin e tyre. (Figura 35)

FIGURE 37. SFIDAT E BIZNESEVE TË SHKAKTUARA NGA PANDEMIA COVID -19




Pastaj, të anketuarit u pyetën për sfidat e pandemisë me ndikim në ndërmarrjen e tyre. Mungesa e klientëve dhe Mungesa e likuiditetit për shkak të shfaqjes së COVID19, janë çështjet më problematike me të cilat u përballën të gjitha ndërmarrjet pavarësisht madhësisë së tyre. Nga ana tjetër, vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve tatimore ishin më sfiduese për ndërmarrjet e vogla, ndërsa ndërmarrjet e mëdha kishin vështirësi në pagesën e pagave. Ky është alaram që shteti në mënyrë institucionale duhet të ndërmarrë masa për mbështetje të bizneseve përmes dizajnimit të një pakoje financiare e cila do t'ju lehtësonte operimin bizneseve dhe do ta ruante qëndrueshmërin e tyre. Sipas aktiviteti ekonomik, sfidat me të cilat u përballën kompanitë janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

FIGURE 38. NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 SIPAS AKTIVITETI EKONOMIK



Pastaj, të anketuarit u pyetën për sfidat e pandemisë me ndikim në biznesin e tyre. Të gjithë sektorët e ekonomisë pritet të ndikohen negativisht. Keshtu, 97 % e kompanive presin që aktiviteti i tyre të ndikohet shumë negativisht dhe negativisht nga përhapja e pandemia COVID-19. Vetëm bujqësia në 6% të saj mendon se nuk do të ndikohet. (Figura 37)

FIGURE 39. MBYLLJA E BIZNESEVE PAS MASAVE KUFIZUESE TË QEVERISË PËR PARANDALIMIN E COVID-19




Të dhënat tregojnë më tej se shumica e ndërmarrjeve e ndalun aktivitetin e tyre pas vendosjes së masave nga qeveria. Sidoqoftë, duhet të theksohet 75 % e kanë ndaluar aktivitetin e tyre ose kanë ndryshuar mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë duke punuar nga shtëpia, ndërsa 25 % kanë vazhdur sipas udhëzimeve të qeverisë.(Figura 38)

FIGURE 40. NDIKIMI I COVID-19 NË SHITJET E BIZNESEVE




Shumica e bizneseve apo 74 % kanë deklaruar se shitjet e tyre janë ndikuar nga pandemia duke u zvogëluar shitjet e tyre, ndërsa 15% kanë deklaruar se kanë mbetur të njejta dhe 11% deklaruna se janë rritur. Këto pasoja janë rezultat i masave kufizuese qeveritare duke e zvogëluar ndjeshëm sasin e konsumit.(Figura 39)

FIGURE 41. PRITSHMËRITË E NDËRMARRJEVE MBI TË NDIKIMIN E PANDEMISË NË TË HYRA




Pavarësisht nga madhësia apo sektori, të gjitha ndërmarrjet në lidhje me pritshmërit mbi ndikimin e COVID19 në të hyrat vjetore të tyre - 80% e kompanive vlerësojnë se do të kenë më shumë se 20% rënie të qarkullimit vjetor të tyre.

FIGURE 42. PERIUDHA MAKSIMALE QË BIZNESI MUNDET TË OPEROJË PA HUMBJE NËSE VAZHDON PANDEMIA ?




Në bazë të përgjigjeve rezulton se nëse Pandemia COVID-19 vazhdon deri në 3 muaj me mbyllje/masa të rënda kufizuese, 55% e bizneseve nuk do të mund t'a përballojnë. Rrjedhimisht, do t'i përjashtojnë punëtorët nga puna dhe do të reduktojnë aktivitetin e tyre biznesore deri tek mbyllja. (Figura 42)

FIGURE 43. A I KENI NDRYSHUAR PRAKTIKAT EKZISTUESE TE BIZNESIT PAS SHFAQJES SË PANDEMISË ?




Si rezultati i gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19 biznset kanë reflektuar dhe kanë filluar të mendojnë ndryshe dhe ta integrojnë teknologjinë në shumë procese të funksionimit të biznesit. Nga përgjigjet e bizneseve rezulton se 27% kanë filluar për herë të parë shitjen online e cila është një kanal shumë efektiv dhe i suksesshëm në kohën e globalizimit dhe mundëson shitjen pa kontakte të drejtëpërdrejta ndërmjet shitësit dhe blerësit. Ndërsa 25% do të bëjnë ndyshime në mënyrën e të bërit biznesit, 22% do të bëjnë ndryshime organizative, 13% do të bëjnë ndryshime në teknologjinë prodhuese, 7% kanë mendurar për futje të produkteve të reja por ka edhe 4% prej tyre që e kanë shfrytëzuar për krijimin e mundësive të reja për biznes. (Figura 43)

FIGURE 44. A KANË NDRYSHUAR PLANET E INVESTIMEVE?




Pandemia ka ndikuar që bizneset t'i rikonsiderojnë vendimet e tyre investive. Dhe 83% e ndërmarrjeve veçse raportojnë se do të anulojnë ndonjë investim të planifikuar në infrastrukturë apo në prodhim/shërbime si rezultat i rënies së kërkesës dhe paqartësis lidhur me zhvillimin dhe kohëzgjatjen e pandemisë. (Figura 43).

FIGURE 45. A KENI KREDI BANKARE?




Ndërsa, rreth 82% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se kanë kredi bankare aktive dhe se do të ballafaqohen me probleme serioze për kthimin e kredisë, si rezultat i pandemisë. Dhe duhet urgjentisht që shteti në mënyrë institucionale të ndërmarrë masa për mbështetje të bizneseve përmes dizajnimit të një pakoje financiare e cila do t'ju lehtësonte operimin bizneseve dhe do ta ruante qëndrueshmërin e tyre financiare. (Figura 44).

FIGURE 46. MUNGESA E STAFIT SI REZULTAT I IZOLIMIT




Si rezultat i pandemisë Qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa kufizuese për biznese por edhe për qarkullimin e lire të qytetarëve, por këto masa kanë ndikuar negativisht tek bizneset dhe kanë shkaktuar edhe mungesa të mëdha të punëtorëve për shkak të sëmundjes, izolimit, kujdesit për fëmijët etj. Dhe pikëpamja e bizneseve është se 81% e tyre konsiderojnë se mungesat e tilla kanë ndikim negativ në zhvillimin e aktivitetit të tyre biznesor. (Figura 46).

FIGURE 47. A KENI MARRË MASA ANTI COVID-19 NË MBROTJE TË PUNËTORËVE TUAJ?




Masat që lidhen me furnizimin me pajisje të sigurisë për stafin e tyre (d.m.th. doreza, maska dhe dezinfektues) ndërmerren më së shpeshti nga ato biznese që vetëm pjesërisht ose aspak nuk e kanë ndalur punën e tyre (91%). Rreth 65% lejojnë që punonjësit e tyre të punojnë nga shtëpia. Vetëm disa morën masa që lidhen me përdorimin e ditëve të pushimit vjetor ose pagimin e pagave më të ulta (75% secila).

FIGURE 48. MASA PËR TË SIGURUAR VIJIMËSINË E BIZNESIT SIPAS SEKTORIT EKONOMIK




Për të siguruar vazhdimësinë e biznesit, kompanitë deklarojnë se kryesisht do të përdorin të ardhura të mëparshme të akumuluara (34%) si edhe do të ulin kostot (32%) fokus shkurtimi i vëndeve të punës ose ulja e prodhimit. Marrja e kredisë në bankë konsiderohet si opsioni i tretë.

FIGURE **49.** SA KANË NDIKUAR MASAT E NIVELIT QENDROR NË BIZNESIN TUAJ?




Kur u pyetën se çfarë ndikimi mund të kenë një sërë masash qeveritare në ndërmarrjet e anketuara, mbi 90% nuk shihnin asnjë ndikim në lidhje me pesë nga shtatë masat e listuara.[33] Vetëm për sa i përket ndihmës për bizneset në mbulimin e kostove operacionale, si dhe shtyrjen e deklaratave tatimore nga ATK, një numër ndërmarrjesh që vlen të përmendet menduan se do të kishte ndikim të vogël (12% secila) ose ndikim mesatar (6% dhe 12% respektivisht). Të dhënat treguan se ndërmarrjet në përgjithësi duket se mendojnë se masat e listuara nuk janë efektive për nevojat e tyre.

FIGURE **50.** BIZNESET MË TË PREKURA SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE




Kjo analizë tregon pasqyren e humbjeve ekonomike në periudhën 6 javore (Mars – Prill 2020) të masave kufizuese nga qeveria, humbjet e supozuara ekonomike janë 11,430.00 Euro të deklaruara nga bizneset (duke përfshi: pagat e papaguara, tatimet dhe taksat, humbjet e fitimit dhe humbjet tjera).

[33] Ju lutemi vini re se 88% e ndërmarrjeve të anketuara nuk merren me eksportimin e mallrave apo shërbimeve. Prandaj, masat në lidhje me këto çështje mund të mos jenë të rëndësishme/zbatueshme për një numër të madh të tyre që morën pjesë në këtë anketë. E njëjta vlen edhe për masat në lidhje me bujqësinë, pasi vetëm 3% e ndërmarrjeve të anketuara janë pjesë e këtij sektori.

Sektori më i prekur nga masat kufizuese rezulton të jetë **HORECA** me humbje prej 2,500.000 Euro, i cili është njëri prej punëdhënësve kryesor në komunën e Vushtrrisë rrjedhimisht nga këto masa dhe humbje të rezultuara janë detyruar që të zovgëlojnë numrin e punëtorëve. Sektori i cili është goditur më së shumti nga masat qeveritare, sektori i hotelerisë dhe shërbimit të ushqimit është gjithashtu një nga sektorët që ka më shumë gjasa të ndikohet edhe më tej si rezultat i rënies së turizmit apo mungesa e ardhjes së diasporës. Një element tjetër negative është se sektori konsiderohet gjithashtu që ka nivelin më të lartë të informalitetit dhe në bazë të hulumtimit ka rezultuar se të punësuar informal janë rreth 33% që nënkupton se atyre ju kanë kufizuar ose ndalur të gjitha të hyrat dhe njëkohësisht nuk kanë përfituar nga masat e pakos fiskale të qeverisë. Nëse vazhdojmë masat kufizuese humbja e vendeve të punës në sektorin e hotelerisë do të jetë më e larta.

Ndërsa sektori i **ndërtimtarisë** mbetet një sektor kyç dhe ky sektor ka potencial të vazhdueshëm të rritjes. Humbjet e rezultuara në këtë sector janë në vlerë prej 1,530.000 Euro. Gjatë pandemisë COVID-19, masat e Qeverisë së Kosovës nuk i kanë kufizuar punimet në sektorin e ndërtimtarisë, dhe vazhdimi i punës në ndërtim ka treguar se sektori është ende duke funksionuar. Duke marrë parasysh që sektori i ndërtimit është një nga sektorët më të varur në fuqinë punëtore, humbjet nga funksionimi me kapacitet më të ulët është llogaritur që kjo pasqyron drejtpërdrejt në shkurtimet e vendeve të punës.

**Tregtia** është njëri ndër sektorët me numrin më të madh të punësuareve dhe nga masat qeveritare ka ndikuar që ky sektorë të rezultojë me humbje deri në 2,070.000 Euro si rezultat i rënies së kërkesës blerëse. Duke pasur parasysh që sektori gjithashtu do të ndikohet nga turizmi apo ardhja e diasporës, e pandemia pritet të ndikojë sektorin e turizmit më së rëndi, pritet që ky sektor gjithashtu të ketë ndikim negativ në tregtinë me shumicë dhe pakicë. Megjithatë, ky ndikim ka më shumë gjasa të përhapet në tremujorin e tretë të vitit 2020, i cili mund të kompensohet (deri në një mase) nga përfundimi i masave aktuale parandaluese të qeverisë.

Për më tepër, duke marrë parasysh që pandemia do të ketë një ndikim negativ në ekonomitë në të gjithë botën, tregtia mund të ndikohet më tej gjatë periudhës së rimëkëmbjes, veçanërisht tek importet. Niveli i importeve, si dhe rritja potenciale e çmimeve për shkak të mungesës së prodhimit global, mund të çojnë në rritje të çmimeve edhe në Kosovë. Megjithatë, ky ndikim mund të zbutet me mbështetje të shtuar për prodhuesit dhe produktet vendase, për të zëvendësuar mungesat në treg.

Sektori i **prodhimit dhe përpunimit** ka rezultuar me humbje prej 1,940.000 Euro nga masat kufizuese edhe pse vendimet e qeverisë që kanë të bëjnë me kufizimet e funksionimit gjatë krizës shëndetësore nuk kufizojnë punën e sektorit në tërësi. Për më tepër, nën-sektorëve specifikë, veçanërisht atyre që operojnë në prodhimin e produktive farmaceutike, si dhe në prodhimin e tekstilit, u është bërë thirrje për të rritur kapacitetet e prodhimit për të siguruar furnizimin vendor të gjërave thelbësore për pandeminë. Në mënyrë të ngjashme, prodhuesit vendor të ushqimeve esenciale

dhe pijeve janë identifikuar gjithashtu si qenësorë për të siguruar furnizim të vazhdueshëm, duke përmirësuar kështu potencialin e tyre për tu pozicionuar në treg, por gjithashtu edhe duke i zvogëluar blerjet e panikut në popullatë.

Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi është njëri ndër sektorët kyç të komunës së Vushtrrisë dhe në bazë të hulumtimit rezulton me humbje prej 970,000.00 Euro. Është qenësore që sektori të vazhdojë punën gjatë krizës shëndetësore, duke pasur parasysh që produktet thelbësore nga bujqësia janë të domosdoshme si produkteve ushqimore përfundimtare, por edhe si furnizimin bazë për prodhimin e ushqimit dhe pijeve.

**Sektorët e tjerë** që janë ndikuar nga situata aktuale përfshijnë aktivitetet e transportit, aktivitetet profesionale, si dhe afarizmi me pasuri të patundshme. Të gjitha këto kanë kontribut të konsiderueshëm në ekonominë e komunës së Vushtrrisë dhe në punësimin.

FIGURE 51. ÇFARË NDIHME KENI NEVOJË PËR MBËSHTETJE NGA SHTETI?




Në pyetjen lidhur me nevojat e bizneseve për mbështetje nga shteti deklarohen se janë të interesuar 68% për ndihmë financiare pa kthim, 12% mbulim i shpenzimeve operative dhe 8% për mbulimin e interesit të kredisë. (Figura 51)

# Konkluzione

Duke u bazuar në rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët e realizuar për vlerësimin e ndikimit në ekonomi familjare dhe biznese të Komunës së Vushtrrisë, rezulton se ndikimin i pandemisë ka prodhuar efekte negative duke shkaktuar pasoja me humbje për ekonomi familjare dhe bizneset e Vushtrrisë në veçanti përgjatë periudhës së masave të rënduara kufizuese gjatë periudhës Mars – Qershor 2020. Dëmet e shkaktuar priten të jenë të konsiderueshme për shkak të vazhdimit të virusit dhe masave kufizuese me orare për operim të bizneseve dhe qarkullim të qytetarëve.

Në vijim janë konkluzionet e nxjerra nga hulumtimi:

1. Pandemia ka ndikuar në rënien e nivelit të hyrave për ekonomi familjare për 380 Euro për familje mesatarisht, në periudhën e masave të mbylljes totale;
2. Përgjatë periudhës së pandemisë numri i të punësuarëve në sektorin informal (të varfrit punojnë masivisht në sektorin informal) kanë pësuar më së shumti sepse ju kanë ndërprerë të hyrat dhe nuk kanë marrë mbështetje nga Pakoja Emergjente Fiskale e qeverisë së Kosovës;
3. Një numër i shumë i madh individësh pritet të humbasin vendin e punës, veçanërisht ata me kontrata me afat të caktuar, punëtorët sezonalë dhe të punësuarit në sektorin informal;
4. Flukset hyrëse për familjet kanë pësuar rënie nga remitancat e dërguara nga mërgata në vende të ndryshme evropiane dhe SHBA, janë zvogëluar për arsye se edhe mërgata janë prekur nga pandemia;
5. Pasoja edhe më të rënda ekonomike vazhdon ti sjell mos ardhja e diasporës sivjet, Komuna e Vushtrrisë viteve paraprake stërmbushej nga mërgata e të cilët shpenzonin para të mëdha në vendlindje. Duhet të theksojmë se diaspora ka ndikim të madh për mbijetesë ekonomike, prandaj meqenëse pritet se shumica nuk kanë ardhur këtë verë edhe humbjet ekonomike dhe financiare për ekonominë e Vushtrrisë janë dukshëm më të larta sesa ato deri tani. Mungesa e ardhjes së diasporës nënkupton sasi më të vogël të parasë në qarkullim dhe kërkesë dukshëm më të vogël për mallrat dhe shërbimet e ofruara. Kjo do rezultojë me stagnim të madh të aktivitetit ekonomik dhe humbje të mëdha sidomos për këtë vit kalendarike.
6. Sektori më i prekur nga masat kufizuese rezulton të jetë **HORECA** me humbje prej 2,500.000 Euro, i cili është njëri prej punëdhënësve kryesor në komunën e Vushtrrisë rrjedhimisht nga këto masa dhe humbje të rezultuara janë detyruar që të zovgëlojnë numrin e punëtorëve.
7. Ndërsa sektori i **ndërtimtarisë** mbetet një sektor kyç dhe ky sektor ka potencial të vazhdueshëm të rritjes. Humbjet e rezultuara në këtë sektor janë në vlerë prej 1,530.000 Euro.
8. **Tregtia** është njëri ndër sektorët me numrin më të madh të punësuareve dhe nga masat qeveritare ka ndikuar që ky sektorë të rezultojë me humbje deri në 2,070.000 Euro si rezultat i rënies së kërkesës blerëse.

9. Sektori i **prodhimit dhe përpunimit** ka rezultuar me humbje prej 1,940.000 Euro nga masat kufizuese edhe pse vendimet e qeverisë që kanë të bëjnë me kufizimet e funksionimit gjatë krizës shëndetësore nuk kufizojnë punën e sektorit në tërësi.
10. Masat kufizuese të lëvizjes dhe mbyllja e kufijve ka ndikuar në zvogëlimin e punësimit sezonal në BE dhe duhet ta theksojmë se punëtorët emigrantë, veçanërisht të punësuarit e përkohshëm ose informalë, mund të humbasin vendet e punës në vendet evropiane të goditura rëndë nga pandemia dhe izolimi. Disa nga këta emigrantë do të kthehen, duke rrezikuar të mbeten të papunë dhe pambrojtje sociale.
11. Pandemia ka prodhuar efekte negative dhe të theksuara në qëndrueshmërin e biznesit duke e vështirësuar likuiditetin;
12. Të gjithë sektorët e ekonomisë pritet të ndikohen negativisht. Keshtu, 97 % e bizneseve presin që aktiviteti i tyre të ndikohet shumë negativisht dhe negativisht nga përhapja e koronavirusit të ri. Vetëm bujqësia në 6% të saj mendon se nuk do të ndikohet. Gjithashtu, 62% e eksportuesve presin që të ndikohen shumë negativisht.
13. Theksojme se 82 % e ndërmarrjeve ndaluan plotësisht aktivitetin gjatë COVID-19, ndërsa 12% e tyre vazhduan aktivitetin plotësisht ose pjesërisht. Nga të gjithë sektorët e ekonomisë, turizmi rezulton si më i prekuri me një mbyllje të veprimtarisë deri në 75%. Në të kundërt, sektori i bujqësisë deklaron se vazhdoi punën pjesërisht ose plotësisht në 81% të saj.
14. Pavarësisht nga madhësia apo sektori, të gjitha kompanitë në lidhje me pritshmërit mbi ndikimin e COVID19 në xhiron vjetore të tyre - 80% e kompanive vlerësojnë se do të kenë më shumë se 20% rënie të qarkullimit vjetor të tyre.
15. Në lidhje me problematikat më të shpeshta, kompanitë gjatë COVID-19, theksojnë mungesën e klientëve, mungesën e likuiditetit, vështirësitë në likuidimin të pagave dhe respektimi i detyrimeve dhe pagesave tatimore. Më konkretisht, Bujqësia, Industria dhe ndërtimi theksojnë mungesën e likuiditetit si shqetësimi kryesor i tyre; ndërsa turizmi, shërbimet dhe tregtia theksojnë mungesën e klientëve.
16. Kompanitë, janë gjendur të papërgatitur për të përballuar pamundësinë e forcës së punës për t'u paraqitur në punë. Kështu, ndërmarrjet konfirmojnë se nuk kanë arritur të marrin asnjë masë në kohë për ta adresuar këtë sfidë, ndërkohë që përdorën lejët e zakonshme dhe punë nga shtëpia (kryesisht shërbimet), ndërsa pjesa tjetër përdorën largimet nga puna (më së shumti ndërmarrjet e mëdha).
17. Për të siguruar vazhdimësinë e biznesit, kompanitë deklarojnë se kryesisht do të përdorin të ardhura të mëparshme të akumuluara (34%) si edhe do të ulin kostot (32%) fokus shkurtimi i vëndeve të punës ose ulja e prodhimit. Marrja e kredisë në bankë konsiderohet si opsioni i tretë.
18. Pavarësisht nga madhësia ose sektori, shumica e kompanive vlerësojnë se ndikimi COVID19 do të zgjasë deri në 1 vit

19. Për sa i përket vlerësimit të masave mbështetëse të qeverisë, kompanitë vlerësojnë se shtyrja e pagesave të kredive do të ketë ndikimin më pozitiv; ndërkohë nga biznesi vlerësohet se mbështetja financiare për punonjësit do të ketë një ndikim të madh pozitiv.
20. COVID 19 stimuloi ndërgjegjësimin mbi efikasitetin e përdorimit të shërbimeve online dhe investimet në teknologji. Kështu, 75% e kompanive deklarojnë se i kanë përdorur shërbimet online (kryesisht Shërbimet, Turizmi dhe Industria); ndërkohë qe shumica e tyre konfirmojnë që do të vazhdojnë të përdorin përsëri shërbimet online. Kjo është një tendencë që tek të gjithë sektorët. Nga përgjigjet e bizneseve rezulton se 27% kanë filluar për herë të parë shitjen online e cila është një kanal shumë efektiv dhe i suksesshëm në kohën e globalizimit dhe mundëson shitjen pa kontakte të drejtëpërdrejta ndërmjet shitësit dhe bleresit. Ndërsa 25% do të bëjnë ndyshime në mënyrën e të bërit biznesit, 22% do të bëjnë ndryshime organizative, 13% do të bëjnë ndryshime në teknologjinë prodhuese, 7% kanë mendurar për futje të produkteve të reja por ka edhe 4% prej tyre që e kanë shfrytëzuar për krijimin e mundësive të reja për biznes. Në të ardhmen, vlerësohet një analizë e mëtejshme në lidhje me llojet e shërbimeve online që janë përdorur më shumë nga biznesi.

# Rekomandime

Duke u bazuar në rezultet e gjeneruara nga raporti hulumtues dhe rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, rekomandojmë për Komunën e Vushtrrisë:

Masat përfshijnë:

1. Pezullimi apo falja e disa taksave komunale deri në vitin 2024
    a) *Taksa për shfrytëzim të hapësirave publike,*
    b) *Taksa per Taksista,*
    c) *Pagesa për qerdhe publike,*
    d) *Pagesa për familjet me asistencë sociale për mbeturina dhe taksa tjera komunale.*
2. Të shtyhen pagesat e taksava lokale përtej afateve ligjore të lejuara;
3. Pagesa e tatimit  në pronë të bëhet me këste pa ndëshkime dhe me zbritje deri në fund të vitit 2024;
4. Tu likuidojnë faturat brenda 30 ditëve për punët e kontraktuara nga komuna;
5. Dezinfektimi i ambienteve të jashtme të bizneseve pa pagesë;
6. Ndihma sociale për të larguarit nga puna në nivel lokal;
7. Promovim të turizmit të të gjitha llojeve. PR për thithjen e turistëve nga vende të ndryshme.
8. Rekomandohet që të analizohen kapacitetiet e tokave që mund te shfrytëzohen për bujqësi. Të kërkohet ndihmë financiare apo kredi nga partnerët strategjike, për të mbështetur programet dhe paketa investive dhe të cilat mund të ndihmojnë në ruajtjen e vendeve të punës në këto sektore, të japin një shtytje aktiviteteve ekonomike me të cilën do të mund të rikthehen në funksion, si dhe, të zvogëlojnë pasojat të cilat kjo krize është duke i' u imponuar;
9. Krijimin e një fondi investiv përkatës i cili do të krijohej nga mjetet të destinuara për investime kapitale (infrastrukturë/rrugë) me ndryshim destinimi në subvencione për mbështetje të bizneseve.
10. Krijimin e një skeme për aftësimin profesional do të duhej të ishte prioritet, si dhe një pjesë e fondit të orientohej në përafrimin e aftësive të fuqisë punëtore me nevojat e ndërmarrjeve në sektorin e prodhimit dhe bujqësisë.
11. Programe edukative për NVM-të që kanë të bëjnë me kalimin në sektor të tjerë gjatë pandemisë dhe pas pandemisë,
12. Trajnimi i konsumatorëve për blerje online, për të rritur besimin në biznesin elektronik;

# Shtojca 1.

## Rekomandime të ekipit të ekspertëve M-Holding për hartimin e buxhetit të KK Vushtrri për vitin 2021

- Zhvillimi ekonomik lokal të trajtohet veqmas nga bujqësia;
- Të transferohet dhe trajnohet stafi kompetent në zhvillim ekonomik lokal;
- Kategoria e të hyrave "THV" të destinohet vlerë më e madhe si subvencione dhe transfere;
- Të hyrat vetanake të komunës së Vushtrrisë duhet të rriten gradualisht duke filluar në vitin 2021, pasi që në 2020 kanë shënuar një rënje të lehtë;
- Komuna të transferoj më shumë staf në departamentet për mbledhje të të hyrave vetanake;
- Të trajnoj stafin komunal kompetent për mbledhjen e të hyrave vetanake duke u bazuar në qasje bashkëpunuese me biznese;
- Të hartoj politika për përkrahjen e bizneseve të cilat ndikojnë/ndërlidhen edhe në rritje të të hyrave;
- Shpenzimet komunale për zhvillim ekonomik në vitet e ardhshme duhet të rriten;
- Fondi për mbështetje financiare të bizneseve të trajtohet veqanërisht nga fondi për bujqësi;
- Fondi për mbështetje financiare të bizneseve, kategoria "subvencionet dhe transferet" të rritet së paku për 100%;
- Evaluimi i rregulloreve komunale për mbështetje financiare në harmoni me SZHEL të Komunës së Vushtrrisë;
- Hartimi i rregulloreve komunale për mbështetje finaciare dhe shërbime të veqanta të bizneseve të Komunës së Vushtrrisë;
- Hartimi i rregulloreve për mbështetje finaciare dhe shërbime të veqanta për të vetpunësuar dhe prodhues;
- Mbështetja financiare për biznese të trajtohet në bashkëpunim me agjensione dhe fonde të mundëshme me qëllim të vlerës së shtuar të mbështeëtjes finaciare;
- Në vitet e ardhëshme duhet të tentohet që kategoria "subvencine dhe transfere" dhe "mallrat dhe shërbimet" të rritet, në disfavor të kategorisë së pagave, në mënyrë që të destinohen për mbështetje financiare dhe shërbime (dhe furnizime) në favor të bizneseve dhe krijimit të vendeve të punës;
- Të hyrat vetanake të realizuara nga bizneset rekomandohet që të i kthehen së paku dyfish bizneseve, në form të përkrahjes dhe investimeve që ata i përcaktojnë;
- Të organizohet komuniteti i biznesit në mënyrë që ata të jenë pjesë e vendimmarrjes dhe planifikimit të buxhetit;
- Në kuadër të fondit për mbështetje financiare të bizneseve të destinohet 30% e tyre për krijimin e vendeve të reja të punës përmes vetëpunësimit;
- Të hartoj forma të stimulimit/motivimit të tatimpaguesve të rregullt me qëllim të rritjes më të lartë të inkasimit vullnetar;
- Të hartoj politika për burime të reja të të hyrave vetanake;

Këto rekomandime janë dërguar me dt. 18 shtator 2020, tek Zyrtarët kompetent në KK Vushtrri.